



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

RAPORTI I GJELBËR 2025



Raporti i Gjelbër 2025

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

20 Dhjetor, 2025

Fjala hyrëse

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kënaqësinë të prezantojë Raportin e Gjelbër për vitin 2025, një dokument themelor që pasqyron në mënyrë të strukturuar zhvillimet në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, të dhënat statistikore dhe sfidat kryesore të sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2024.

Raporti i Gjelbër, i hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, tashmë për më shumë se 13 vite përfaqëson një burim të besueshëm dhe referues të informacionit, duke kontribuar në analizën objektive të trendeve, performancës dhe potencialit të sektorit bujqësor në vend.


Ministria dëshmon përkushtimin e saj ndaj zhvillimit të bujqësisë, përmes hartimit dhe zbatimit të legjislacionit në harmoni me rregulloret dhe standardet e Komisionit Evropian, përmes dokumenteve strategjike dhe programeve mbështetëse që vitet e fundit kanë shënuar nivele rekord të investimeve dhe përfitimeve për fermerët, si dhe përmes prezentimit të masave të reja përkrahëse.

Ky raport është rezultat i një pune të koordinuar dhe të përkushtuar të të gjitha Departamenteve dhe Agjencive të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe i bashkëpunimit të ngushtë me agjencitë dhe institucionet tjera qeveritare. Përmes këtij raporti synojmë të ofrojmë një pasqyrë të thukët dhe të besueshme të gjendjes së sektorit bujqësor në Kosovë, duke shërbyer si bazë solide për informata për palë të treta ndërsa për strukturat institucionale shërben për hartimin dhe orientimin e politikave dhe masave strategjike drejt një zhvillimi të qëndrueshëm, konkurrues dhe gjithëpërfshirës.

Vlen të theksohet se Raporti i Gjelbër mbetet i vetmi raport i këtij lloji që publikohet në nivel rajonal, ndërsa vitet e fundit ka filluar të shërbejë edhe si model referues për përgatitjen e raporteve të ngjashme nga vendet e rajonit. Ky fakt përbën një përgjegjësi shtesë institucionale për ne, për të avancuar vazhdimisht cilësinë, thellësinë analitike dhe përmbajtjen e tij.

Duke qenë se Raporti i Gjelbër pasqyron në mënyrë gjithëpërfshirëse arritjet e Ministrisë dhe të sektorit të bujqësisë në vend, ai shërben njëkohësisht si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e progresit, identifikimin e sfidave dhe orientimin e politikave të ardhshme. Ministria mbetet e angazhuar në përmirësimin e kushteve për fermerët, në forcimin e sigurisë ushqimore, në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendor, në promovimin e inovacionit dhe digjitalizimit, si dhe në përdorimin e qëndrueshëm dhe efikas të burimeve natyrore, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të mirëqenies së popullsisë dhe garantimit të një zhvillimi agroushqimor e rural afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

Imri Demelezi



Ministër në detyrë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Hyrje

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përgatitur Raportin e Gjellbër për vitin 2025, në përputhje me planin e punës dhe në zbatim të Nenit 36 të ligjit për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural.

Si një instrument që pasqyron gjendjen e sektorit të bujqësisë në vendin tonë, Raporti i Gjellbër edhe në këtë edicion, i cili është i 13-ti me radhë, paraqet të dhëna të detajuara për vitin 2024, për mjedisin e përgjithshëm ekonomik, prodhimin bujqësor dhe përdorimin e tij, pylltarinë, tregtinë, sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, si dhe politikat bujqësore, përfshirë dy programet mbështetëse: Programin e Pagesave Direkte/subvencioneve dhe Programin e Zhvillimit Rural/grantet investive. Po ashtu, në pjesën e shtojcave paraqiten të dhëna lidhur me legjislacionin përkatës.

Në këtë Raport të dhënat sa i përket sipërfaqeve të kultivuara, prodhimit bimor dhe blegtorisë (kapitulli 2) në nivel vendi janë bazuar në rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Kjo anketë realizohet në një mostër prej 8,000 ekonomive bujqësore të përzgjedhura bazuar në të dhënat e Regjistrimit të fundit të bujqësisë (2014). Në kapitulli 6 të dhënat për sipërfaqet dhe blegtorinë janë nga të dhënat e Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, përkatësisht të dhënat e implementimit të Programit të Pagesave Direkte.

Këtë vit, raporti është zgjeruar duke përfshirë të dhënat për popullsinë në zonat rurale pas publikimit të të dhënave të regjistrimit të popullsisë, të dhënat për nivelin e pagave në gjithë sektorët dhe specifikisht në sektorin e bujqësisë, përdorimin e plehrave dhe pesticideve si dhe tek pjesa e tregtisë është përfshirë edhe paraqitja e të dhënave të plehrave dhe pesticideve.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, si hartues i këtij raporti, i përbërë nga Delvina Hana Bakija, Hakile Xhaferi, Adelina Maksuti, Shkëlqim Duraku, Granit Zymeri dhe Albana Zeqiri, vazhdon të mbetet i përkushtuar për prodhimin e një raporti të detajuar dhe të besueshëm, si burimi kryesor i statistikave bujqësore në vend. Kontributi dhe bashkëpunimi i gjitha njësive dhe Agjencive të MBPZhR-së, e po ashtu edhe Agjencive dhe institucioneve tjera qeveritare, të cilët ofrojnë informacione për secilën fushë të raportit, ka qenë dhe vazhdon të mbetet thelbësore për një raport sa më përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës, i cili ofrohet në shërbim jo vetëm të sektorit të bujqësisë por edhe më gjerë.

Shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë lexuesit dhe përdoruesit e Raportit të Gjellbër, të cilët me sugjerimet e tyre të vlefshme ndihmojnë në përmirësimin e këtij publikimi dhe mbesim të përkushtuar si gjithmonë që Raporti i Gjellbër të pasurohet çdo vit e më shumë.

Adelina Maksuti



U.D. Drejtore

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave.....	6
Lista e figurave.....	9
Lista e shkurtesave	11
1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	13
1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik	15
1.2 Popullsia në zonat rurale	17
1.3 Punësimi	19
1.4 Niveli i pagave	21
1.5 Llogaritë ekonomike në bujqësi	23
1.5.1 Prodhimet bujqësore	23
1.5.2 Të ardhurat sipërmarrëse	26
1.5.3 Inputet në bujqësi	27
1.5.4 Përdorimi i plehrave dhe pesticideve	29
1.6 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore	30
1.6.1 Çmimet e inputeve bujqësore	30
1.6.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore	33
Çmimet në fermë të prodhimeve bujqësore	33
Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	34
Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	36
Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së.....	38
1.7 Privatizimi i tokave bujqësore	39
2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij	42
2.1 Përdorimi i tokës bujqësore.....	42
2.2 Prodhimtaria bimore.....	44
2.2.1 Drithërat.....	44
2.2.2 Perimet.....	45
2.2.3 Pemët.....	51
2.2.4 Vreshtat dhe verërat.....	55
Vreshtat	55
Verërat	59
Analizat fiziko - kimike të verës.....	60
2.2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra.....	61
2.2.6 Kulturat industriale.....	63
2.2.7 Livadhe dhe kullosa	63
2.2.8 Bujqësia organike.....	64
2.3 Ujitja e tokës bujqësore	65
2.4 Blegtoaria.....	68
2.4.1 Gjedhet.....	68
2.4.2 Dhentë dhe dhitë	70
2.4.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës.....	70
2.4.4 Shpezëtaria	72
2.4.5 Bletaria	73
2.4.6 Peshkataria dhe Akuakultura	73

3	Pylltaria	75
4	Tregtia.....	90
4.1	Tregtia e përgjithshme	90
4.2	Tregtia e produkteve bujqësore	90
4.2.1	Tregtia sipas grupeve të shteteve	92
	Tregtia me vendet e CEFTA-s.....	92
	Tregtia me vendet e BE-së.....	94
	Tregtia me vendet e tjera.....	96
4.2.2	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24).....	97
	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	97
	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24).....	98
4.2.3	Tregtia e plehrave dhe pesticideve.....	100
5	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	102
5.1	Emetimi i gazrave serrë	107
6	Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	110
6.1	Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve	110
6.2	Pagesat direkte/ subvencionet	113
6.2.1	Pagesat direkte për kulturat bujqësore dhe verë.....	121
6.2.2	Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht.....	125
6.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi.....	128
	Mbështetja e fidanëve.....	128
	Mbështetja për naftë	129
	Mbështetja për pleh	129
6.3	Agro kreditë dhe fondi garantues	129
6.3.1	Agro Kreditë.....	129
6.3.2	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FKGK.....	133
6.4	Sigurimet në fushën e bujqësisë.....	135
	Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor.....	136
6.5	Projektet e zhvillimit rural – grantet investive	136
6.6	Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve	139
	Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor.....	139
	Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	142
7	Shtojcat.....	143
7.1	Të dhënat të tjera	143
7.2	Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural	146
7.2.1	Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2024.....	146
7.3	Personat përgjegjës për Raportin e Gjellbër, 2025	148

Lista e tabelave

Tabela 1:	Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale, në '000 €	14
Tabela 2:	Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve	17
Tabela 3:	Popullsia sipas vendbanimit urban-rural, gjinisë dhe grup-moshës	19
Tabela 4:	Pagat bruto dhe neto 2020-2024, në €.....	22
Tabela 5:	Sipërfaqja e plehëruar, sasia e plehut organik të përdorur dhe shpenzimet, 2020-2024	29
Tabela 6:	Sipërfaqja e plehëruar, sasia e plehut mineral të përdorur dhe shpenzimet, 2020-2024	30
Tabela 7:	Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar, trajtuar me pesticide dhe shpenzimet, 2020-2024	30
Tabela 8:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2020-2024, (2020=100)	32
Tabela 9:	Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2020-2024	32
Tabela 10:	Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg	34
Tabela 11:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg	35
Tabela 12:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg.....	36
Tabela 13:	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg	37
Tabela 14:	Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg	38
Tabela 15:	Çmimet e disa prodhimeve bujqësore në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2024, €/kg.....	39
Tabela 16:	Shitjet e tokave bujqësore sipas regjioneve, 2005-2024	40
Tabela 17:	Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2024.....	41
Tabela 18:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha	42
Tabela 19:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2020-2024	44
Tabela 20:	Bilancet e furnizimit për grurë dhe misër, 2024	45
Tabela 21:	Sipërfaqja me perime, 2020 - 2024.....	46
Tabela 22:	Prodhimi i perimeve, 2020 - 2024.....	47
Tabela 23:	Rendimenti i perimeve, 2020 - 2024.....	48
Tabela 24:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korres së parë	49
Tabela 25:	Bilanci i furnizimit për patate, spec, fasule, kungull dhe kungull misiri dhe qepë (2024)	50
Tabela 26:	Bilanci i furnizimit për shalqi, lakër, domate, trangull dhe pjepër (2024).....	51
Tabela 27:	Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2020 - 2024	52
Tabela 28:	Rendimenti i pemëve, 2020 - 2024	53
Tabela 29:	Bilanci i furnizimit për mollë, kumbull, mjedër, arrë dhe dardhë (2024)	54
Tabela 30:	Bilanci i furnizimit për lajthi, vishnje, dredhëz, qershi dhe rrush tryeze (2024)	55
Tabela 31:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2020 - 2024.....	56
Tabela 32:	Varietetet e rrushit të tryezës, 2024	57
Tabela 33:	Varietetet e rrushit të verës, 2024	58
Tabela 34:	Prodhimi i verës 2020-2024, '000 litra	59
Tabela 35:	Prodhimi i verës sipas kompanive, 2024	60
Tabela 36:	Analizat fiziko - kimike të verës për periudhën 2020 - 2024.....	61
Tabela 37:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave foragjere, 2020-2024.....	62
Tabela 38:	Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave industriale, 2020-2024.....	63
Tabela 39:	Sipërfaqja me livadhe, kullosa, tokë e përbashkët dhe prodhimi nga livadhet, 2020- 2024	63
Tabela 40:	Prodhimtaria organike, 2018 - 2024.....	64

Tabela 41:	Sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar në sip. e tokave bujqësore dhe format e ujitjes në Kosovë, 2024	66
Tabela 42:	Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2024	67
Tabela 43:	Fondi dhe struktura e gjedheve, 2020-2024.....	68
Tabela 44:	Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2020-2024.....	69
Tabela 45:	Bilanci i furnizimit për qumështin e lopës dhe produktet e qumështit, 2020-2024	69
Tabela 46:	Numri i dhenëve, 2020-2024.....	70
Tabela 47:	Numri i dhive, 2020-2024	70
Tabela 48:	Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2020-2024	71
Tabela 49:	Numri i kafshëve të tjera të fermës, 2020-2024	71
Tabela 50:	Numri i shpezëve 2020-2024, në '000	72
Tabela 51:	Prodhimtaria e vezëve, 2020-2024, në '000 copë.....	72
Tabela 52:	Numri i koshereve të bletëve, 2020-2024	73
Tabela 53:	Prodhimi i mjaltit në tonë, 2020-2024.....	73
Tabela 54:	Numri i lejeve të peshkimit dhe sasia e peshkut, 2022-2024.....	74
Tabela 55:	VGJP e themeluara	77
Tabela 56:	Dhënia në menaxhim e VGJP.....	77
Tabela 57:	Planet menaxhuese afatgjata për periudhën 2024-2034.....	78
Tabela 58:	Planet vjetore për vitin e gjetisë, 2024-2025	79
Tabela 59:	Planifikimi për hartimin e PM.....	81
Tabela 60:	Plan i prerjeve në pyjet shtetërore	82
Tabela 61:	Realizimi i planit të prerjeve në pyjet shtetërore.....	83
Tabela 62:	Plani i kultivimit dhe shfrytëzimi i pyjeve private	84
Tabela 63:	Të dhënat e aktiviteteve në pyje private.....	84
Tabela 64:	Punët tekniko-profesionale	84
Tabela 65:	Shërbimet mbështetëse teknike	85
Tabela 66:	Numri i kallëzimeve kundërvajtje dhe penale	86
Tabela 67:	Lënda drunore	86
Tabela 68:	Të dhënat për zjarret në pyje, 2024.....	87
Tabela 69:	Prodhimi i fidanëve.....	87
Tabela 70:	Plani i pyllëzimeve	88
Tabela 71:	Plani i të hyrave	88
Tabela 72:	Plani i shpenzimeve	89
Tabela 73:	Të hyrat në buxhet 2024.....	89
Tabela 74:	Eksporti-Importi i përgjithshëm, në '000 €	90
Tabela 75:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €	90
Tabela 76:	Eksporti, Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2024 në '000 €	92
Tabela 77:	Eksporti- Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 €	93
Tabela 78:	Eksporti - Importi i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në '000 €.....	94
Tabela 79:	Eksporti - Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së, në '000 €.....	95
Tabela 80:	Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 €	96
Tabela 81:	Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 €.....	96

Tabela 82:	Eksporti dhe importi nga Vendet e tjera, në '000 €	97
Tabela 83:	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24), 2020-2024	98
Tabela 84:	Importi i produkteve bujqësore 2020-2024, në '000 €	99
Tabela 85:	Importi i plehrave, 2020-2024	100
Tabela 86:	Importi i pesticideve, 2020-2024	101
Tabela 87:	Numri përgjithshëm vjetor i inspektimeve dhe mostrave, 2024	103
Tabela 88:	Numri i planifikuar i kontrolleve zyrtare, 2024	103
Tabela 89:	Numri i mostrave të dërguara në LUV	103
Tabela 90:	Asgjësimi i produkteve nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm	104
Tabela 91:	Numri vjetor i inspektimeve dhe mostrave të marra nga IVB, sipas tremujorëve	104
Tabela 92:	Numri dhe aktivitetet inspektuese nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm	105
Tabela 93:	Numri dhe lloji i inspektimeve të kryera nga Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm	106
Tabela 94:	Tabela e kalsifikimit të qumështit sipas ngarkesës mikrobiale, 2024	107
Tabela 95:	Pagesat direkte për njësi, PPD 2024	112
Tabela 96:	Pagesat direkte 2020-2024, në €	114
Tabela 97:	Numri i njësive të subvencionuara, 2020-2024	115
Tabela 98:	Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2024, në €	117
Tabela 99:	Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2024, në €	118
Tabela 100:	Numri i aplikuesve, përfituesve dhe të refuzuarve si dhe shuma e pagesave direkte sipas komunave, në 2024	119
Tabela 101:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2020-2024	122
Tabela 102:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2020-2024	125
Tabela 103:	Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2024	128
Tabela 104:	Agro kreditë 2020 – 2024	131
Tabela 105:	Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2024	134
Tabela 106:	Buxheti i paraparë i PZhR, 2024	136
Tabela 107:	Projektet e miratuara PZhR, 2024	137
Tabela 108:	PZhR i miratuar sipas komunave për vitin 2024	139
Tabela 109:	Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative (QIKK)	141
Tabela 110:	Aktivitetet nga Projekti “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të SHK	141
Tabela 111:	Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural	142
Tabela 112:	Eksporti i bimëve mjekuese aromatike dhe produkteve pyjore jo drusore, vlera në €	143
Tabela 113:	Eksporti i bimëve mjekuese aromatike dhe produkteve pyjore jo drusore, Sasia në kg	144
Tabela 114:	Përdorimi i plehrave minerale sipas grupit të kulturave bujqësore	145
Tabela 115:	Përdorimi i plehrave organike sipas grupit të kulturave bujqësore	145
Tabela 116:	Numri i vizitorëve (vëndor dhe të jashtëm) sipas regjioneve, 2015 – 2024	145

Lista e figurave

Figura 1:	Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor, 2008-2024	16
Figura 2:	Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve, 1921-2024.....	18
Figura 3:	Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve.....	18
Figura 4:	Numri i banorëve sipas vendbanimeve dhe popullsia sipas moshës së punës	19
Figura 5:	Indikatorët kryesorë të tregut të punës, 2020-2024	20
Figura 6:	Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve në (%), moshë 15 e më shumë.....	21
Figura 7:	Mesatarja vjetore e pagës bruto 2020-2024, në €.....	22
Figura 8:	Mesatarja vjetore e pagës neto 2020-2024, në €.....	23
Figura 9:	Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2020-2024	24
Figura 10:	Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2024.....	24
Figura 11:	Shitja e mishit sipas llojeve të kafshëve dhe produktet e tjera blegtorale, 2024	25
Figura 12:	Prodhimet bimore në mil. €, 2020-2024	25
Figura 13:	Blegtoria në mil. €, 2020-2024.....	26
Figura 14:	Produktet blegtorale në mil. €, 2020-2024.....	26
Figura 15:	Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2020-2024	27
Figura 16:	Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2020-2024.....	27
Figura 17:	Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2024	28
Figura 18:	Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2024.....	28
Figura 19:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2020-2024, (2020=100).....	31
Figura 20:	Sipërfaqja në ha dhe çmimi mesatar i shitjes së një ha tokë bujqësore	40
Figura 21:	Tokë e punueshme - ara dhe livadhe e kullosa	43
Figura 22:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2024	43
Figura 23:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, '000 €	91
Figura 24:	Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin dhe importin e përgjithshëm	91
Figura 25:	Eksporti dhe importi sipas grupeve të shteteve 2024	92
Figura 26:	Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin dhe importin bujqësor.....	93
Figura 27:	Eksporti dhe importi sipas vendeve të CEFTA-s, 2024	94
Figura 28:	Pjesëmarrja e BE-së në eksportin dhe importin bujqësor	95
Figura 29:	Eksporti dhe importi me Vendet e tjera, 2024.....	97
Figura 30:	Emetimet e GHG nga Sekt. i Bujqësisë dhe Përdorimit të Tokës Gg CO2 eq. 2021-2023.....	109
Figura 31:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2024.....	113
Figura 32:	Pagesat direkte 2020-2024, në 1000 €.....	113
Figura 33:	Pagesat direkte sipas sektorëve 2024, në mil. €	115
Figura 34:	Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2024	116
Figura 35:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2024.....	116
Figura 36:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2024	116
Figura 37:	Numri i përfituesve, shuma e paguar dhe shuma mesatare për përfitues sipas komunave, në 2024.....	120
Figura 38:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2024	124
Figura 39:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2024	124
Figura 40:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2024	127

Figura 41:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2024	128
Figura 42:	Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000)	131
Figura 43:	Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €	132
Figura 44:	Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €	132
Figura 45:	Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %	133
Figura 46:	Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara nga FKGK, %	135
Figura 47:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve si dhe përfituesit sipas gjinisë, 2024.....	138

Lista e shkurtesave

AEB	Anketa e Ekonomive Bujqësore
AFK	Agjencia për Financim në Kosovë
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AZhb	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BMA	Bimë Mjekësore Aromatike
BPB	Banka Private për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendrore
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
DMKE	Drejtoria për Menaxhimin me Kafshë të Egra
DP	Departamenti i Pylltarisë
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
DShtKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike
EFSA	Autoriteti Europian i Sigurisë Ushqimore
FAO	Organizata për Bujqësi dhe Ushqimi
FCMS	Sistemi i Kontrollit dhe Gjurmëshmërisë së Ushqimit
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Gg	Giga gram
GHG	Emetimi i gazrave serrë
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GLV	Grupe Lokale të Veprimit
GS	Gazra Serrë
IADK	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare
IFP	Institucione Financiare Partnere
IMF	Institucionet Mikro Financiare
IP	Instituti i Pylltarisë
IVB	Inspektorati Veterinar i Brendshëm
KEP	Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës
KGMAMF	Kosovo Grameen Mission Arcobaleno Microcredit Fund
KRK	Kreditimi Rural i Kosovës
LIMS	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Laboratorit
LUV	Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë
LLEB	Llogarit Ekonomike për Bujqësi
MBPZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NIF	Numri Identifikues i Fermës
NLB	NLB Banka
OBSH	Organizata Botërore për Shëndetësi
OE	Operator Ekonomik
OIE	Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve
PBD	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

PM	Plane Menaxhuese
PMA	Planet Menaxhuese Afatgjata
PPD	Programi i Pagesave Direkte
PPJD	Produkte pyjore jo drusore
PPSE	Swiss Contact Projekt
PSSKKBZhR	Plani Strategjik i Stategjisë Kombëtare të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
PVM	Planet Vjetore Menaxhuese
PZhR	Programi i Zhvillimit Rural
QIKK	Qendrat Informative Këshilluese Komunale
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
RBKO	Raiffeisen Bank
SBSH	Sipërfaqja Bujqësore e Shfrytëzuar
SCPE	Sistemi i Pagesave dhe Certifikatave Elektronike
SKKBZhR	Strategjia Kombëtare e Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHK	Shërbimi Këshillimor
TEB	Banka Ekonomike Turke
UA	Udhëzim Administrativë
UNFCCC	Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VGJKRV	Vendgjuetia me rëndësi të veçant
VGjP	Vendgjuetitë e përbashkëta
WVI	KosInvest World Vision

1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

Viti 2024 karakterizohet nga zhvillime të rëndësishme në sektorin bujqësor, financues dhe demografik të Republikës së Kosovës. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka zbatuar dy programe kyçe mbështetëse me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së fermerëve.

Bujqësia mbetet një nga shtyllat themelore të ekonomisë së vendit, me një pjesëmarrje prej 7.3% në Bruto Prodhimin Vendor. Në vitin 2008 pjesëmarrja e bujqësisë në BPV ishte 11.3%, ndërsa në vitin 2024 kjo pjesëmarrja ishte 7.3%, që paraqet një ulje prej rreth 4 pikë përqindje. Kjo tregon një zhvendosje graduale të ekonomisë drejt sektorëve jo-bujqësorë (shërbimet, teknologjia, ndërtimi, etj.) Viti 2018 ka vlerën më të ulët (6.5%), që mund të lidhet me ndryshime të kushteve klimatike ose ndryshime strukturore në ekonomi. Pas 2018-ës, periudha e fundit (2020–2024), paraqet stabilitet të qëndrueshëm me rreth 7%, që tregon konsolidim dhe nivel të qëndrueshëm si kontribues në BPV.

MBPZhR, në përballje me efektet e ndryshimeve klimatike dhe transformimeve socio-ekonomike, ka përshtatur politikat e saj përmes shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve, të orientuara drejt rritjes së produktivitetit dhe fuqizimit të fermerëve për të konkurruar në treg. Për realizimin e këtyre objektivave, MBPZhR ka zbatuar dy programe kryesore vjetore: Programin për Pagesa Direkte – Subvencione dhe Programin për Zhvillim Rural – Grante Investive.

Në vitin 2024, përmes Programit të Pagesave Direkte janë mbështetur 28 kategori bujqësore dhe blegtorale, me një buxhet të shpenzuar prej 66.5 mil. €. Numri i aplikuesve ishte 32,561, nga të cilët 31,190 janë përfitues. Në të njëjtën kohë, në kuadër të Programit të Zhvillimit Rural (PZhR) për vitin 2024, janë përkrahur masat e parapara me një buxhet të planifikuar prej 19.6 mil. €. Numri i përfituesve ishte 464, me vlerë të miratuar të projekteve prej 14.4 mil. € si mbështetje publike, krahasuar me 22.7 mil. € të shumës së përgjithshme të projekteve të miratuara.

Eksporti i produkteve bujqësore për kapitujt doganorë 01–24, në vitin 2024, arriti në 170.8 mil. €, duke përfaqësuar një rritje prej 22.8 mil. € ose 15.4%. Importi i produkteve bujqësore arriti në 1.39 mld. €, duke pasqyruar një rritje prej 108.4 mil. € ose 8.4%, krahasuar me vitin 2023.

Numri i kredive të dhëna për sektorin e bujqësisë që nga viti 2020 deri në vitin 2024 është rreth 99 mijë kredi me një shumë totale prej 537.5 mil. €. Pra, për këto 5 vite, janë disbursuar mesatarisht rreth 1,646 kredi çdo muaj, përkatësisht me një shumë mesatare mujore prej 8.96 mil. €.

Shfrytëzimi i tokës së punueshme gjatë vitit 2024, mbizotërohet nga livadhet dhe kullosat me 216,534 ha, apo me pjesëmarrje prej 52%, toka e punueshme – ara me 188,795 ha apo 43%, plantacionet e pemëve me sipërfaqe prej 10,408 ha (2%), perimet, kopshtet dhe fidanishtet me

pjesëmarrje prej 2%, ndërsa plantacionet e vreshtave paraqiten me sipërfaqe prej 3,406 ha, dhe pjesëmarrje prej 1%.

Ndërkohë, prodhimi bujqësor shënoi vlerë të konsiderueshme prej 1.014 mld. € (627 mil. € prodhimi bimor dhe 387 mil. € prodhimi blegtoral).

Tabela 1: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale, në '000 €

Aktiviteti	2020	2021	2022	2023	2024
A Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	498,526	550,948	657,626	698,945	759,221
B Industria nxjerrëse	134,574	148,345	137,493	157,196	167,634
C Industria përpunuese	904,149	1,025,892	1,136,998	1,250,580	1,306,469
D Furnizimi me energji elektrike, me gaz	264,917	288,349	338,570	306,464	326,501
E Furnizimi me ujë	43,089	45,905	49,219	53,970	58,274
F Ndërtimtaria	519,420	675,879	761,288	782,072	811,822
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	867,439	1,084,213	1,278,434	1,414,471	1,475,366
H Transporti dhe magazinimi	262,999	341,917	395,463	431,010	459,766
I Hotelet dhe restorantet	110,855	163,847	188,105	207,174	221,743
J Informimi dhe komunikimi	134,577	150,124	178,262	198,044	207,603
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	277,337	294,751	348,642	416,894	438,957
L Afarizmi me pasuri të patundshme	493,438	512,555	544,622	572,145	581,184
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	107,358	113,918	121,612	132,039	137,036
N Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	49,589	54,486	58,984	63,962	66,125
O Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	444,284	436,988	448,001	496,510	529,526
P Edukimi	257,380	270,776	274,076	311,545	330,039
Q Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	180,459	184,884	184,744	215,996	231,030
R Art, zbavitje dhe rekreacion	13,228	14,228	14,361	17,835	18,868
S Shërbime tjera	26,905	27,760	28,472	29,865	30,873
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	-	-	-	-	-
BVSH me çmime bazë	5,590,522	6,385,766	7,144,972	7,756,719	8,158,040
Tatimet në produkte	1,278,134	1,654,901	1,856,280	2,071,982	2,297,620
Subvencionet në produkte	-97,055	-82,791	-105,525	-148,632	-105,287
Bruto Produkti Vendor	6,771,601	7,957,876	8,895,728	9,680,068	10,350,373

Burimi: ASK- Bruto Produkti Vendor 2008-2024

Sektori bujqësor përballet me sfida të shumta, duke përfshirë nevojën për modernizim teknologjik, qasjen e kufizuar në tregje të reja dhe ndikimin në rritje të ndryshimeve klimatike. Zhvillimet socio-ekonomike në zonat rurale paraqesin vështirësi, por edhe potencial për rritje.

Kur flasim për mjedisin e përgjithshëm ekonomik dhe demografik në vitin 2024, del se popullsia e regjistruar në Republikën e Kosovës ishte 1.6 milion banorë, duke shënuar një rënie prej 10% krahasuar me regjistrimin e fundit të vitit 2011, por rritje pothuajse për 4 herë krahasuar me vitin 1921. Dendësia më e ulët e popullsisë ishte në vitin 1921 me 40.2

banorë/km², ndërsa më e larta në vitin 2011 me 163.2 banorë/km². Në vitin 2024, dendësia shënoi ulje prej 9.9% krahasuar me vitin 2011.

Sektori i turizmit është sektori në rritje në ekonominë e Republikës së Kosovës. Duke krahasuar periudhën 2015–2024, numri i vizitorëve është rritur pothuajse 5 herë. Turizmi dhe bujqësia janë sektorë të ndërlidhur, që kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe zonave rurale. Turizmi krijon kërkesë për produkte ushqimore lokale, ndërsa bujqësia siguron furnizimin për këtë kërkesë, duke stimuluar prodhimin e frutave, perimeve, mishit, qumështit, verërave dhe produkteve të tjera bujqësore. Ky bashkëveprim gjeneron mundësi shtesë për rritjen e prodhimit vendor dhe eksportit të produkteve autentike.

1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik

Ekonomia e Eurozonës shënoi rritje prej 0.9% në vitin 2024, pas një ngecje prej vetëm 0.4% në vitin 2023. Ky përmirësim u mbështet kryesisht nga konsumi privat, i ndikuar pozitivisht nga rritja e të ardhurave reale, ngadalësimi i inflacionit dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve. Nga ana tjetër, investimet mbetën të dobëta për shkak të kostove të larta të financimit dhe rritjes së pasigurisë ekonomike. Po ashtu, konkurrueshmëria e ulët ndikoi negativisht në eksporte dhe sektorin industrial, duke bërë që rritja të udhëhiqet kryesisht nga sektori i shërbimeve. Tregu i punës pati zhvillime pozitive: papunësia ra në 6.4%, ndërsa punësimi u rrit me 0.4%, duke sinjalizuar një stabilizim pas rritjes së fortë në vitet e kaluara.

Ballkani Perëndimor shënoi rritje mesatare prej 3.4% në 2024 (nga 3.7% në 2023). Rritja më e lartë ishte në Kosovë (4.4%), dhe më e ulëta në Bosnje dhe Hercegovinë (2.5%). Rritja u mbështet nga ulja e inflacionit dhe rritja e kreditimit, që nxitën konsumin dhe investimet. Konsumi mbetet shtytës kryesor, për shkak të pagave më të larta, shpenzimeve publike dhe përmirësimit në tregun e punës. Kërkesa e jashtme mbetet e dobët për shkak të ngadalësimit ekonomik të partnerëve evropianë.

Inflacioni mesatar në rajon u ul në 3.2% në 2024 (nga 7.7% në 2023), me nivelin më të lartë në Serbi (4.8%), dhe më të ulët në Kosovë (1.6%). Ngadalësimi i inflacionit pritet të vijojë falë përmirësimeve në furnizim dhe stabilizim të çmimeve të energjisë. Kreditimi në rajon u rrit, veçanërisht në Kosovë (18.3%), Mal të Zi (13.3%) dhe Shqipëri (12.8%). Kreditë jo-performuese shënuar rënie në të gjitha vendet, megjithëse Mali i Zi dhe Shqipëria mbeten me nivelet më të larta, ndërsa Kosova ka nivelin më të ulët.

Çmimet në Kosovë patën rënie gjatë vitit 2024, falë zbutjes së presioneve të inflacionit nga jashtë, stabilizimit të ofertës dhe rënies së çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Inflacioni u ul në 1.6% nga 4.9% në 2023, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të karburanteve dhe ushqimit në tregun botëror.

Kategoria kryesore që kontribuoi në inflacion ishte ushqimi dhe pijet joalkoolike (0.8 pikë përqindje) me rënie të çmimeve të bulmetit dhe perimeve, por rritje në çmimet e kafesë, çajit dhe kakaos për shkak të kushteve klimatike. Eksporti i mallrave arriti 941.5 mil. €, me rritje


prej 9.1%, kryesisht për shkak të rritjes së eksportit të metaleve bazë (22.6%), plastikës dhe gomës (2.9%), si dhe artikujve ushqimorë (13.9%). Ballkani Perëndimor është partneri kryesor eksportues (45.4%), me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore, ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 33.1%, me Gjermaninë si destinacion kryesor. Eksportet shtrihen në 148 shtete.

Importi arriti në 6.37 mld. €, me një rritje prej 7.6%, të nxitura nga kërkesa e brendshme. Më të importuara ishin produktet minerale, makineritë dhe ushqimet. Mallrat e ndërmjetme përbëjnë pjesën më të madhe (45.1%), ndërsa mallrat kapitale shënuan rritjen më të lartë (17.2%). Importet vijnë kryesisht nga BE (44.7%), Turqia (14.4%), rajoni (13.4%) dhe Kina (11.9%).

Remitancat arritën në 1.35 mld. € (13.1% e PBB-së), me një rritje më të ngadaltë prej 1.4%, të ndikuar nga pasiguria ekonomike dhe inflacioni në vendet pritëse të diasporës. Gjermania dhe Zvicra mbeten burimet kryesore (56.2%). Remitancat përmes kanaleve formale u rritën me 2.0%, ndërsa ato informale mbetën në të njëjtin nivel.

Edhe pse sektori mund të punësojë shumë njerëz, kontributi i tij në BPV mbetet relativisht i vogël. Në bazë të të dhënave që merren nga ASK, ekonomia po zhvendoset nga bujqësia drejt sektorëve më produktivë, por bujqësia mbetet një komponent i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i BPV-së.

Figura 1: Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor, 2008-2024



Burimi: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2008 – 2024

BPV me çmime aktuale në vitin 2024 ishte 10.35 mld. €. Rritja reale në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ishte 4.57%, ndërsa BPV për kokë banori për vitin 2024 ishte 6,459 €.

Rritje reale për vitin 2024 kishte në këto aktivitete ekonomike: Furnizimi me energji elektrike, me gaz 6.1%, Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi 5.2%, Hotelet dhe restorantet 5.0%, Industria nxjerrëse 4.6%, Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 3.8%, Ndërtimtaria 3.8%, Furnizimi me ujë 3.5%, Administrimi publik dhe i mbrojtjes dhe sigurimi i detyrueshëm social

3.1%, Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike 3.1%, Shërbime tjera 3.0%, Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave 2.8%, Transporti dhe magazinimi 2.6%, Informimi dhe komunikimi 2.6%, Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale 2.5%, Aktivitetet administrative dhe mbështetëse 1.6%, Art, zbavitje dhe rekreacion 1.5%, Afarizmi me pasuri të patundshme 1.3%, Edukimi 1.2% dhe Industria përpunuese 0.6%. Ndërsa rënie nuk ka pasur në asnjërën nga kategoritë.

1.2 Popullsia në zonat rurale

Që nga viti 1921, kur popullsia numëronte 439,010 banorë, nga kjo periudhë paraqitet një rritje e vazhdueshme deri në vitin 2011, kur arriti në 1.8 milion banorë. Në vitin 2024, popullsia e regjistruar ishte 1.6 milion banorë, duke shënuar një rënie prej 10% krahasuar me vitin 2011. Krahasuar me vitin 1921, popullsia në vitin 2024 pothuajse u rrit për 4 herë.

Tabela 2: Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve


Viti i Regjistrimit	Popullsia gjithsej	Numri i banorëve për km ²	Ekonomitë familjare	Persona në një ekonomi familjare
1921	439,010	40.2	84,889	5.2
1931	552,064	50.6	108,761	5.1
1948	733,034	67.2	115,283	6.4
1953	815,908	74.8	127,004	6.4
1961	963,988	88.4	152,598	6.3
1971	1,243,693	114	188,107	6.6
1981	1,584,440	145.3	228,884	6.9
*2011	1,780,021	163.2	297,090	5.9
*2024	1,602,515	147.0	366,595	4.4

Burimi: ASK - Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, të dhënat demografike.¹

Dendësia më e ulët e popullsisë për kilometër katror është regjistruar në vitin 1921, me 40.2 banorë për km², ndërsa dendësia më e lartë e popullsisë ishte në vitin 2011, me 163.2 banorë për km².

¹ Të dhënat për sipërfaqen e Republikës së Kosovës (2024) janë marrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (Prill 2017); 2011 - Numri i popullsisë bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2011, përfshirë Vlerësimin e Popullsisë për katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut; 2011- Numri i ekonomive familjare bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2011; 2024- Numri i popullsisë bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2024, përfshirë Vlerësimin e Popullsisë për katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovica e Veriut; 2024-Numri i ekonomive familjare bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2024.

Figura 2: Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve, 1921-2024




Burimi: ASK - Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, të dhënat demografike.

Sa i përket numrit të ekonomive familjare, vërehet se në regjistrimin e vitit 2024 u regjistruan 366,595 ekonomi familjare, një rritje prej 23.4% krahasuar me vitin 2011, dhe një rritje më shumë se 4 herë krahasuar me vitin 1921.

Lidhur me numrin e personave në ekonomi familjare, viti 2024 regjistroi numrin më të ulët, me vetëm 4.4 persona për ekonomi familjare. Numri më i lartë ka qenë në vitin 1981, me mesatare prej 6.9 persona për ekonomi familjare.

Figura 3: Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve



Burimi: ASK - Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, të dhënat demografike.

Numri i përgjithshëm i banorëve të regjistruar në vitin 2024 ishte 1,585,566. Prej tyre, 789,939 banorë (49.8%) jetonin në zonat rurale, ndërsa 795,627 banorë (50.2%) në zonat urbane, duke përfaqësuar përkatësisht gjysmën e popullsisë së Republikës së Kosovës.

Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) në vitin 2024 ishte gjithsej 1,063,687 banorë. Nga këta, 531,384 ishin meshkuj dhe 532,303 ishin femra.


Tabela 3: Popullsia sipas vendbanimit urban-rural, gjinisë dhe grup-moshës

Lloji i vendbanimit	Popullsia							Popullsia në moshë pune 15-64			65+
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Foshnje 0 vjeç	Fëmijë 1-6	Fëmijë 7-14	Të rinjtë 15-27	Gjithsej	Meshkuj	Femra	
Kosovë	1,585,566	795,552	790,014	20,467	133,224	194,313	325,742	1,063,687	531,384	532,303	173,875
Urban	795,627	395,240	400,387	10,467	67,684	95,802	158,387	534,828	263,772	271,056	86,846
Rural	789,939	400,312	389,627	10,000	65,540	98,511	167,355	528,859	267,612	261,247	87,029

Burimi: ASK - Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, të dhënat demografike.

Numri i popullsisë aktive në moshë pune në vitin 2024 ishte 1,063,687 banorë. Prej tyre, 534,828 banorë jetonin në zonat urbane, ndërsa 528,859 banorë jetonin në zonat rurale.

Figura 4: Numri i banorëve sipas vendbanimeve dhe popullsia sipas moshës së punës



Burimi: ASK - Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2024, të dhënat demografike.

1.3 Punësimi


Kosova ka një popullsi të re, me rritje të pritshme të popullsisë në moshë pune në dekadën e ardhshme. Kur flasim për aktivitetin ekonomik dhe pjesëmarrja në tregun e punës, nga popullsia në moshë pune, një pjesë e konsiderueshme prej 56.8% rezulton të jetë ekonomikisht joaktive. Kjo do të thotë se këta individë nuk janë të punësuar dhe as nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punës gjatë katër javëve të fundit, ose nuk janë në gjendje të fillojnë punë brenda dy javëve të ardhshme.

Nga ana tjetër, 43.2% e popullsisë në moshë pune janë ekonomikisht aktiv, që përkthehet në 464,567 persona. Shkalla e punësimit në Kosovë është 38.6%, me rreth 414,493 persona të punësuar.

Megjithatë, ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tregun e punës, që shfaqin sfida të veçanta për femrat. Shkalla e punësimit të femrat është shumë më e ulët, vetëm 21.2%, ndërsa të meshkujt arrin në 55.9%.

Tek të rinjtë, shkalla e punësimit në vitin 2024 ishte 19.4%, që është më e larta për periudhën 2020-2024. Shkalla më e lartë e papunësisë ishte në vitin 2020 me 49.1%, ndërsa më e ulëta në vitin 2023 me 17.3%. Në vitin 2024, papunësia tek të rinjtë (mosha 15-24) ishte 19.5%.


Figura 5: Indikatorët kryesorë të tregut të punës, 2020-2024



Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '20, '21, '22, '23, '24

Femrat janë të punësuar kryesisht në sektorë të tillë si tregtia, arsimi dhe shëndetësia, të cilët përbëjnë 53.4% të vendeve të punës për femrat. Në anën tjetër, meshkujt janë më të përqendruar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit, ku punësohen 47.2% e meshkujve. Si aktivitet ekonomik sektori i bujqësisë merr pjesë me vetëm 2.8%. Pjesëmarrje të madhe ka tregtia me shumicë dhe pakicë 19.5%, Ndërtimtaria 12.6% dhe prodhimi me 10%.

Figura 6: Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve në (%), moshë 15 e më shumë



Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '24

Pjesa dërrmuese e personave të punësuar raportojnë se punojnë me orar të plotë, konkretisht 93.1% e tyre e kanë punën kryesore me orar të plotë.

1.4 Niveli i pagave

Të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë tregojnë një rritje të qëndrueshme të pagave mesatare vjetore, si në nivelin e përgjithshëm të ekonomisë, ashtu edhe në sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkatarisë.

Paga minimale në Kosovë ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë vitit 2024, duke reflektuar përpjekjet për rritjen e sigurisë ekonomike të punëtorëve. Deri në muajin shtator, paga minimale ishte e ndarë sipas grup moshave, ku punëtorët deri në moshën 35 vjeçare paguheshin minimalisht 130 € në muaj apo 1,560 € në vit, ndërsa ata mbi 35 vjeç, 170 € në muaj apo 2,040 € në vit.

Paga minimale për punëtorët e moshës deri në 35 vjeç përfaqësonte vetëm rreth një të pestën e pagës mesatare vjetore bruto, ndërsa për ata mbi moshën 35 vjeç raporti ishte rreth një e katërta. Në aspektin e pagës neto ky raport ishte rreth një e katërta tek punëtorët e moshës deri në 35 vjeç, dhe rreth një e treta për ata mbi moshën 35 vjeç. Ky raport thekson nivelin e ulët të pagës minimale krahasuar me të ardhurat mesatare.

Megjithatë, nga 1 tetori 2024, u vendos paga minimale e unifikuar prej 350 € bruto, e cila përfaqëson rreth 54.8% të pagës mesatare bruto dhe 63.4% të pagës mesatare neto të vitit 2024. Ky ndryshim shënon një përmirësim të dukshëm të pagës minimale në raport me pagat mesatare, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies së punëtorëve dhe në përafrimin e saj me nivelin real të kostos së jetesës.

Tabela 4: Pagat bruto dhe neto 2020-2024, në €

Pagat mesatare vjetore bruto dhe neto	2020	2021	2022	2023	2024
Mesatarja vjetore e pagës neto (të gjithë sektorët)	4,992	5,184	5,352	6,072	6,624
Mesatarja vjetore e pagës bruto (të gjithë sektorët)	5,592	5,808	6,252	6,840	7,668
Mesatarja vjetore e pagës neto (Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari)	2,724	3,204	3,588	3,732	4,296
Mesatarja vjetore e pagës bruto (Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari)	2,988	3,528	4,212	4,152	5,004


Burimi: Niveli i pagave në Kosovë '20, '21, '22, '23, 24

Pagat bruto në të gjithë sektorët kanë shënuar rritje të vazhdueshme gjatë pesë viteve të fundit. Nga 5,592 € në vitin 2020, ato arrijnë në 7,668 € në vitin 2024, duke shënuar kështu një rritje prej 37.1% brenda 5 viteve. Kjo tregon një trend pozitiv që mund të lidhet me rritjen ekonomike, ndryshimet në politikat e pagave dhe rritjen e kostos së jetesës.

Pagat në sektorin e bujqësisë, megjithëse dukshëm më të ulëta krahasuar me mesataren e përgjithshme, kanë pasur gjithashtu rritje të konsiderueshme me dallim vetëm në vitin 2023 që kishte një rënie shumë të vogël krahasuar me vitin 2022. Paga bruto për këtë sektor është rritur nga 2,988 € në vitin 2020 në 5,004 € në vitin 2024, duke shënuar kështu një rritje prej 67.5% brenda periudhës 5 vjeçare.

Rritja më e madhe e pagave në sektorin e bujqësisë (përkatesisht 30.3 pikë përqindje), krahasuar me rritjen që ishte në të gjithë sektorët në periudhën 5 vjeçare ishte si rezultat i mungesës dhe rritjes së kostos së fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë.


Figura 7: Mesatarja vjetore e pagës bruto 2020-2024, në €



Burimi: Niveli i pagave në Kosovë '20, '21, '22, '23, 24, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në aspektin e pagave neto, tendenca ndjek po të njëjtin ritëm si pagat bruto, rritje graduale nga viti në vit. Paga neto mesatare e përgjithshme rritet nga 4,992 € në 2020, në 6,624 € në 2024, përkatesisht për 32.7%, duke reflektuar përmirësim të përgjithshëm të të ardhurave reale të punëtorëve, ndërsa paga neto në sektorin e bujqësisë është rritur nga 2,724 € në vitin 2020, në 4,296 € në vitin 2024, përkatesish për 57.7%.

Figura 8: Mesatarja vjetore e pagës neto 2020-2024, në €



Burimi: Niveli i pagave në Kosovë '20, '21, '22, '23, 24, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.5 Llogaritë ekonomike në bujqësi

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi (LLEB), synojnë të ofrojnë një pasqyrë të detajuar të aktivitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë për një vit kalendarik, këto llogari pasqyrojnë vlerën e produkteve dhe shërbimeve bujqësore që janë prodhuar nga njësitë bujqësore dhe janë të shitura ose ruajtura në stoqet e fermës apo edhe të përdorura për përdorim të mëtejshëm.


Qëllimi kryesor i LLEB është të ofroj të dhëna të besueshme dhe të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të sektorit të bujqësisë, të cilat shërbejnë edhe për vlerësimin e politikave dhe ndikimin e tyre. LLEB mundësojnë llogaritjen e treguesve kryesor ekonomik, përfshirë të ardhurat e fermës kostot operative dhe fitimet neto të cilat janë mëse të nevojshme për vlerësimin e plotë të gjendjes së sektorit.

1.5.1 Prodhimet bujqësore

Prodhimet bimore dhe blegtorale gjatë vitit 2024, paraqiten në vlerë prej 627 mil. € prodhimet bimore, ndërsa 387 mil. € prodhimet blegtorale.

Nëse analizohet 5 vjeçari i fundit për prodhimet bimore dhe blegtorale, vërejmë se vlerat kanë ndryshuar nga viti në vit. Sa i përket prodhimeve bimore në periudhën 2020-2024, kanë shënuar trend të rritjes së vazhdueshme përpos vitit 2023 që shënoi ulje, mirëpo në vitin 2024 kjo vlerë e prodhimeve bimore u rrit për 8.5%, ndërsa prodhimet blegtorale për periudhën 2020-2024, përpos një ulje të vogël që shënoj në vitin 2021, më pas u shoqërua çdo vit me rritje e gjithashtu edhe viti 2024, shënoj rritje për 2.9% krahasuar me vitin 2023. Këto rritje rezultojnë si rezultat i rritjes së vlerës së produkteve bimore dhe blegtorale.


Figura 9: Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €², 2020-2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Sa i përket pjesëmarrjes së kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, të dhënat për vitin 2024, tregojnë se kategoria e perimeve dhe prodhimeve të kopshtit merr pjesë me (28.8%), drithërat (21.8%), pemët dhe bimët foragjere me nga 21% secila, patatet (6.8%), pasuar me kategoritë tjera si prodhimet tjera bimore (0.5%) dhe bimët industriale (0.1%).

Figura 10: Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2024




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Të dhënat për vitin 2024 për shitjen e mishit sipas llojit të kafshëve, tregojnë se në totalin e përgjithshëm të kësaj kategorie gjedhet marrin pjesë me 39.4%, delet dhe dhitë 18.8%, shpezët 15.5%, derrat 14.4%, dhe kafshët tjera 11.9%.

Të dhënat për shitjen e produkteve tjera blegtorale për vitin 2024, sikurse edhe vitin e kaluar prinë kategoria e qumështit 78.3%, pasuar nga vezët me 21.7%, dhe produktet tjera marrin pjesë me 0.1%.

² Vlera me çmime aktuale. Ndryshimet eventuale në vlera tek llogaritë ekonomike krahasuar me Raportet e Gjellbëra të viteve paraprake janë për shkak të ndërrimit të vitit bazik në ASK nga 2015=100 në 2020=100.


Figura 11: Shitja e mishit sipas llojeve të kafshëve dhe produktet e tjera blegtorale, 2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Për periudhën kohore 2020-2024, prodhimet bimore sipas kategorive kanë shënuar kryesisht rritje me luhatje të kohë pas kohëshme. Për dallim nga viti 2023, në vitin 2024, vërehet se ka pas ndryshime tek disa kategori, si perimet dhe prodhimet e kopshtit të cilat kanë shënuar rritje për 30%, prodhimet tjera bimore përfshirë prodhimet industriale 13%, bimët foragjere 10% dhe drithërat 7%, ndërsa është shënuar rënie tek patatet 20% si dhe pemët 2%.


Figura 12: Prodhimet bimore në mil. €, 2020-2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Prodhimet blegtorale për periudhën 2020-2024, bazuar në vlerat me çmime aktuale, kanë shënuar ndryshime nga viti në vit, nga gjithë kjo seri kohore viti 2021, karakterizohet me një rënie të dukshme në pothuajse të gjitha kategoritë, pasuar me rritje në të gjitha vitet pasuese. Në raport me vitin 2023, gjatë vitit 2024 të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje duke filluar nga kafshët tjera që shënoi rritje për 21%, derrat 18%, delet dhe dhitë 13% dhe gjedhet 4%, ndërsa ulje është shënuar tek kategoria e shpezëve për 6%.


Figura 13: Blegtoria në mil. €, 2020-2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Gjatë periudhës 2020-2024, produktet blegtorale kanë shënuar rritje në vazhdimësi përpos disa luhatjeve të vogla varësisht kategorive, dallimet e dukshme vërehen tek viti 2020 dhe 2021, të cilat më pas në vitet në vijim janë pasqyruar me rritje. Vlera e qumështit në vitin 2024 shënoi 135.2 mil. €, njëherit edhe më e larta në të gjitha kategoritë gjatë periudhës kohore 2020-2024, kategoria e vezëve shënoi zvogëlim në raport me dy vitet paraprake 2022 dhe 2023, ndërsa kategoria e produkteve tjera blegtorale nuk kishte ndonjë ndryshim gjatë kësaj periudhe.

Figura 14: Produktet blegtorale në mil. €, 2020-2024




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.5.2 Të ardhurat sipërmarrëse

Të ardhurat sipërmarrëse për periudhën 2020-2024, të cilat përfshijnë prodhimin e industrisë bujqësore, konsumin e ndërmjetëm dhe vlerën e shtuar bruto, tregojnë se në vitin 2024 vlera e tyre është rritur në raport me 4 vitet paraprake.

Gjatë vitit 2024, vlerat sipas kategorive shënuan ndryshime pozitive ku vlera e prodhimeve të industrisë bujqësore u rrit për 7%, konsumit të ndërmjetëm për 2%, si dhe vlera e shtuar bruto me çmimet bazë për 9%.


Figura 15: Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2020-2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Të hyrat e agreguara në bujqësi për vitin 2024, paraqiten me vlerën më të lartë në të gjitha kategoritë për gjatë periudhës kohore 2020-2024. Gjatë vitit 2024, vlera e shtuar bruto me çmime bazë llogaritet 716 mil. € apo 9% më e lartë, vlera e shtuar neto me çmime bazë shënoi 566 mil. €, si dhe të ardhurat sipërmarrëse 552 mil. € apo me rritje me nga 10% secila.

Figura 16: Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2020-2024




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2023; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.5.3 Inputet në bujqësi

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi për vitin 2024, na tregojnë se struktura e konsumit të ndërmjetëm bujqësor në krahasim me vitin e kaluar nuk ka pasur shumë ndryshime, pothuajse gjitha kategoritë qëndrojnë në raport të njëjtë me vitin 2023, përpos kategorisë së ushqimit të kafshëve që ka shënuar një rritje për 2 pikë % dhe shpenzimet veterinere një ulje të lehtë për 1 pikë %.

Sa i përket strukturës së konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2024, referuar të dhënave me çmime aktuale, kategoria me pjesëmarrje më të madhe në këtë strukturë paraqitet kategoria e ushqimit të kafshëve me 48%, pasuar nga kategoria e plehrave dhe përmirësuesit e tokës me 15%, mallrat dhe shërbimet tjera me 9%, dhe pjesa tjetër e shpërndarë sipas grupeve të tjera.


Figura 17: Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Inputet në bujqësi për vitin 2024, sipas të dhënave të LLEB me çmime aktuale kanë pjesëmarrje si në vijim: Konsumi i ndërmjetëm 68.5%, konsumi i kapitalit fiks 28.8%, kompensimi i punëtorëve 1.3%, qiraja dhe shpenzimet tjera për shfrytëzimin e patundshmërisë dhe ndërtesave me nga 1%, si dhe interesi i papaguar ka pjesëmarrje 0.4%.

Figura 18: Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2024



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2024, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.5.4 Përdorimi i plehrave dhe pesticideve

Sipërfaqja e tokës së plehëruar me pleh organik ka pësuar një rritje të lehtë përgjatë periudhës, duke shënuar rritje nga 62,844 ha në vitin 2020, në 63,970 hektarë në vitin 2024, që përbën një rritje prej rreth 1.8%. Kjo tregon stabilitet dhe një zgjerim të moderuar të sipërfaqeve të plehëruara me pleh organik.

Gjithsej sasia e plehut të përdorur ka pësuar një rënie prej 2.4% gjatë periudhës, duke u ulur nga 908,650 tonë në vitin 2020, në 887,240 tonë në vitin 2024. Duke qenë se sipërfaqja e plehëruar është rritur, kjo ka ndikuar që sasia e plehut të përdorur për hektar të zvogëlohet për 4.1%, nga 14.5 t/ha në 2020 në 13.9 t/ha në 2024.

Ndërsa shpenzimet për plehërim janë rritur ndjeshëm, nga 2.2 mil. € në vitin 2020, në 4.4 mil. € në vitin 2024, që përbën një rritje prej rreth 95.2%. Shikuar ndryshimet nga viti në vit, në vitin 2021 shpenzimet për pleh organik u rritën për 64.3%, pasuar me rritje edhe në vitin 2022 për 26.5%, dhe pastaj kishte ulje për 4.0% në vitin 2023 dhe 2.2% në vitin 2022. Rritjet në vitin 2021 dhe 2022 ishin për shkak të rritjes së çmimeve të plehut.

Tabela 5: Sipërfaqja e plehëruar, sasia e plehut organik të përdorur dhe shpenzimet, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024
Sipërfaqja e tokës së plehëruar (ha)	62,844	63,454	63,700	63,940	63,970
Gjithsej sasia e përdorur (t)	908,650	895,309	876,309	900,201	887,240
Sasia e përdorur (t/ha)	14.50	14.10	13.80	14.10	13.90
Shpenzimet (€)	2,240,731	3,681,879	4,657,714	4,471,405	4,373,554

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Gjatë periudhës 2020-2024, sipërfaqja e tokës së plehëruar me pleh mineral ka shënuar një rritje të qëndrueshme, duke kaluar nga 172,220 ha në vitin 2020, në 174,264 ha në vitin 2024, që përbën një rritje prej rreth 1.2%. Në vitin 2024, sipërfaqja është rritur në 174,264 ha, nga 174,161 ha në vitin 2023, që përfaqëson një rritje modeste prej 0.1%, duke treguar një stabilitet të lartë në tokat e plehëruara.

Sa i përket sasive të plehut mineral të përdorur, në vitin 2024 kishte rritje prej 1.5% në raport me vitin 2023. Nga llojet e plehut të përdorur, NPK ka shënuar rritje të vogël prej 0.9%, NAG 2.8%, URE 1.3% dhe plehurat e tjera 10%, duke treguar një përdorim më intensiv të disa llojeve të plehrave në vitin e fundit.

Në të njëjtën kohë, shpenzimet për plehërim janë ulur pak, nga 52.0 mil. € në 2023, në 50.8 mil. € në 2024, që përfaqëson një ulje prej 2.2%. Kjo ulje, në krahasim me rritjen e vogël të sasive të përdorura, tregon një ulje të çmimeve të disa llojeve të plehrave.

Tabela 6: Sipërfaqja e plehëruar, sasia e plehut mineral të përdorur dhe shpenzimet, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024
Sipërfaqja e tokës së plehëruar (ha)	172,220	173,665	173,911	174,161	174,264
Shpenzimet (€)	31,681,826	37,984,104	50,486,530	52,001,126	50,842,568
NPK (kg)	42,447,365	41,393,005	42,066,802	42,600,121	42,977,542
NAG (kg)	8,674,749	8,936,617	9,082,117	9,207,643	9,463,040
URE (kg)	25,628,236	26,053,605	26,327,504	26,561,919	26,913,321
Të tjera (kg)	2,306,229	2,592,958	2,711,121	2,512,598	2,762,961
Gjithsej sasia (kg)	79,056,578	78,976,185	80,187,544	80,882,281	82,116,863

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Gjatë periudhës 2020–2024, sipërfaqja e tokës bujqësore të shfrytëzuar e cila është trajtuar me pesticide ka shënuar luhatje të vogla, duke u rritur nga 122,090 ha në vitin 2020, në 122,571 ha në vitin 2024, që përbën një rritje prej rreth 0.4% përgjatë pesë viteve.

Analiza e dy viteve të fundit tregon se sipërfaqja është zvogëluar nga 122,752 ha në vitin 2023, në 122,571 ha në vitin 2024, që përfaqëson një rënie modeste prej 0.1%. Ky tregues tregon se ndryshimi në sipërfaqet e trajtuara me pesticide ka qenë shumë i kufizuar në vitet e fundit.

Ndërkohë, shpenzimet për përdorimin e pesticideve kanë pasur një rritje të vazhdueshme gjatë periudhës '20-'24. Ato janë rritur nga 8.6 mil. € në vitin 2020, në 9.8 mil. € në vitin 2024, që korrespondon me një rritje totale prej rreth 14.6%. Fokusuar në dy vitet e fundit, shpenzimet janë rritur për 7%. Kjo është kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të pesticideve.

Tabela 7: Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar, trajtuar me pesticide dhe shpenzimet, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024
Sipërfaqja (ha)	122,090	122,138	122,501	122,752	122,571
Shpenzimet (€)	8,550,647	8,004,182	8,639,697	9,158,079	9,802,440

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

1.6 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore

1.6.1 Çmimet e inputeve bujqësore

Indekset e çmimeve të inputeve bujqësore matin ndryshimet e çmimeve në kostot aktuale të prodhimit brenda ekonomisë. Përkatësisht, një indeks i çmimeve të inputeve matë ndryshimet në koston e shportës së blerjeve që hyjnë si inpute në procesin e prodhimit, por këtu nuk hyjnë inputet primare si toka, puna dhe kapitali.

Tabela e mëposhtme e indeksit vjetor të çmimeve të inputeve bujqësore përfshinë të dhëna për indeksin e çmimeve në Kosovë për periudhën 2020-2024. Çmimet e inputeve bujqësore janë mbledhur nga ASK në barnatore bujqësore, barnatore veterinerë, nga kompanitë, tregjet dhe

vendet tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit nga ASK.


Produktet që përbëjnë bazën e indeksit të çmimeve të inputeve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (konsumi i ndërmjetëm), si dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (formimi i kapitalit).

Nga të gjitha kategoritë e paraqitura në tabelën në vijim, kategoria me më së shumti rritje të çmimit në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 është ajo e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe pesticideve për 13.6%, pasuar nga shpenzimet veterinerë me rritje 4.1%. Gjithashtu rritje është shënuar edhe tek lëndë të përbëra ushqimi me 4.5% që hyjnë në kuadër të kategorisë lëndë ushqimi për kafshë, pasuar nga energjia elektrike (3.0%), mirëmbajtja e ndërtesave (2.1%) dhe mirëmbajtja e materialeve me një përqindje shumë të vogël të rritjes.

Rënie të çmimit ka pasur tek disa kategori të inputeve, mirëpo rënie më e theksuar ishte tek kategoria plehërat dhe përmirësuesit e tokës (21.1%) dhe lëndë për ushqim kafshësh (7%), pasuar nga kategori të tjera me rënie më të ulët.

Indeksi vjetor i inputeve në vitin 2024 ka shënuar rënie për 7.6% për Input 1, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, ndërsa indeksi për Input 2 kishte rritje për 1.2%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin 2023, në vitin 2024 ka rënë për 3.6%.

Figura 19: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2020-2024, (2020=100)



Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2020-2024 (2020=100), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela 8: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2020-2024, (2020=100)

Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)	100	112.7	148.1	137.6	127.1	-7.6
Farërat dhe materiali mbëltues	100	101.7	109.2	105.2	103.0	-2.1
Energji; lubrifikant	100	113.7	147.9	139.9	135.7	-3.0
- Energjia elektrike	100	100.7	103.3	119.5	123.1	3.0
- Lëndë djegëse	100	119.2	167.4	148.6	140.8	-5.2
- Lubrifikant	100	111.0	126.4	133.6	135.0	1.0
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	100	133.2	235.4	200.2	158.0	-21.1
- Plehrat e thjeshtë	100	137.0	247.2	198.3	152.2	-23.2
- Plehrat e përbëra	100	130.1	225.8	201.8	162.9	-19.3
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	100	102.7	116.1	125.2	142.2	13.6
Shpenzimet veterinare	100	104.0	107.6	112.4	117.0	4.1
Lëndë për ushqim kafshësh	100	111.5	144.3	129.5	120.4	-7.0
- Lëndë të thjeshta ushqimi	100	111.9	147.2	128.5	116.7	-9.2
- Lëndë të përbëra ushqimi	100	108.9	128.0	135.2	141.3	4.5
Mirëmbajtja e materialeve	100	100.1	104.4	106.2	106.3	0.1
Mirëmbajtja e ndërtesave	100	103.3	111.3	118.3	120.8	2.1
Mallrat dhe shërbimet tjera	100	104.4	106.2	107.3	106.8	-0.5
Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)	100	113.8	138.7	153.9	155.8	1.2
Traktor	100	125.7	162.6	184.7	183.9	-0.4
Tjera	100	103.2	117.4	126.5	130.8	3.4
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)	100	113.2	144.0	144.8	139.6	-3.6

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2020-2024 (2020=100), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhëna lidhur me çmimet vjetore të energjisë elektrike dhe naftës për periudhën 2020-2024. Çmimi i energjisë elektrike, në vitin 2024 është rritur për 1.4% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa çmimi i naftës ka rënë për 5.8%.

Tabela 9: Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2020-2024

Energjia dhe Lubrifikantët	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	5.6	5.7	5.8	6.9	7.0	1.4
Nafta - çmimi për 100 litra	92.6	110.2	159.1	139.0	131.0	-5.8

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2020-2024 (2020=100), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

1.6.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore

Bujqësia është një nga sektorët më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike, politike dhe demografike, duke përfshirë kushtet më të papritura atmosferike, sfidat e tjera që lidhen me popullsinë dhe mundësitë ekonomike. Ministria e Bujqësisë siguron mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët dhe prodhuesit e vegjël me grante dhe subvencione, për të rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor.

Prodhimi vendor bujqësor nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e konsumit të popullsisë, pavarësisht mbështetjes së vazhdueshme. Për këtë arsye, kemi një import të lartë të produkteve bujqësore për të plotësuar këtë boshllëk, me ç'rast thellohet bilanci tregtar negativ.

Për të mbledhur dhe analizuar çmimet e produkteve bujqësore, MBPZhR ka angazhuar një operator ekonomik, të dhënat mblidhen nga shtatë rajone dhe prezantohen si mesatare vjetore në nivel vendi. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për të hartuar analiza, programe dhe strategji me synim të përmirësimit të gjendjes në sektorin e bujqësisë.

Në vazhdim janë paraqitur çmimet e disa prodhimeve bujqësore në nivel të fermës, çmimet e importit si dhe vlera për njësi të produkteve të importuara për periudhën 2020–2024.

Çmimet në fermë të prodhimeve bujqësore

Duke analizuar të dhënat nga tabela e dhënë (çmimet në fermë për vitet 2023 dhe 2024), vërehet se vërtet ka pasur një paqëndrueshmëri të lartë të çmimeve të prodhimeve bujqësore. Këto lëvizje janë paraqitur si rritje të konsiderueshme të: molla, kungulli, dardha, kumbulla, spinaqi dhe kungull misiri, ashtu edhe ulje të theksuar të: shalqiri, pulë ferme, domatja dhe mëze dhe mëshqerra.

Tabela 10: Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg

Prodhime	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 (%)
Grurë	0.19	0.20	0.29	0.20	0.21	7
Misër	0.25	0.28	0.32	0.19	0.25	32
Domate	0.33	0.52	0.66	0.69	0.67	-3
Fasule	2.31	2.38	2.49	3.50	3.53	1
Kungull	0.17	0.16	0.25	0.30	0.75	150
Kungull misiri	0.22	0.29	0.39	0.35	0.59	69
Lakër	0.23	0.31	0.36	0.45	0.52	15
Patate	0.28	0.42	0.49	0.48	0.29	-39
Qepë	0.37	0.41	0.48	0.46	0.52	12
Shalqi	0.18	0.21	0.21	0.30	0.19	-37
Spec	0.54	0.62	0.78	0.70	1.02	46
Spinaq	0.76	1.16	0.86	0.70	1.22	74
Trangull	0.31	0.54	0.67	0.45	0.61	36
Arrë	2.06	2.13	2.57	3.50	3.97	13
Dardhë	0.72	0.91	0.89	0.80	1.53	91
Dredhëz	1.16	1.22	1.19	1.30	1.60	23
Kumbull	0.71	0.81	0.78	0.60	1.09	82
Mjedër	1.73	3.50	3.12	1.30	2.10	62
Mollë	0.31	0.44	0.43	0.37	0.95	155
Rrush tryeze	0.63	0.53	0.69	0.78	0.90	15
Mëzet dhe Mëshqerra	2.21	2.53	2.71	3.10	3.02	-2
Pulë ferme	1.72	1.89	3.12	2.90	1.98	-32
Qumësht	0.23	0.31	0.34	0.42	0.62	48
Vezë*	2.26	2.12	2.54	2.08	2.55	23
Mjaltë	13.60	11.50	14.54	14.30	17.60	-1.7

Burimi: DAESB – MBPZhR; * njësia 30 copë;

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore janë prezantuar përmes çmimeve vjetore të tregut me shumicë dhe pakicë për vitet 2020-2024.³

Bazuar në çmimet vjetore të tregut me shumicë të cilat janë të paraqitura në tabelën vijuese për disa prodhime bujqësore, vërejmë se gjatë vitit 2024 ka pasur lëvizje të çmimeve krahasuar me vitin 2022, rritje më të madhe të çmimeve kanë shënuar: spinaqi, kungulli, kumbulla, molla dhe mjaltë, ndërsa prodhimet që kanë shënuar rënie në çmim janë: pulë ferme, gruri, trangulli dhe domatja.

³ Në vitin 2023 nuk është bërë mbledhje e të dhënave në mungesë të kontratës me OE që kryen mbledhjen e çmimeve.

Tabela 11: Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg

Prodhime	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2022 (%)
Grurë	0.33	0.31	0.36	-	0.23	-36
Misër	0.53	0.39	0.37	-	0.31	-16
Domate	0.65	0.78	1.17	-	0.92	-21
Fasule	2.44	2.50	2.84	-	4.40	55
Kungull	0.31	0.27	0.53	-	1.05	98
Kungull misiri	0.38	0.46	0.69	-	0.73	6
Lakër	0.39	0.47	0.55	-	0.69	25
Patate	0.39	0.40	0.51	-	0.51	0
Qepë	0.54	0.48	0.62	-	0.59	-5
Shalqi	0.37	0.24	0.25	-	0.21	-16
Spec	0.97	0.94	1.27	-	1.28	1
Spinaq	0.95	0.94	1.00	-	2.31	131
Trangull	0.57	0.75	0.91	-	0.71	-22
Arrë	2.38	2.71	3.05	-	5.18	70
Dardhë	1.20	1.32	1.37	-	1.68	23
Dredhëz	1.82	1.67	1.75	-	1.65	-6
Kumbull	0.69	1.09	0.91	-	1.54	69
Mjedër	2.07	4.00	3.72	-	4.24	14
Mollë	0.64	0.73	0.58	-	1.11	91
Rrush tryeze	0.99	1.02	1.41	-	1.95	38
Mëzet dhe Mëshqerra	2.93	2.65	2.89	-	3.02	4
Pulë ferme	1.91	2.08	3.78	-	1.98	-48
Qumësht	0.29	0.42	0.59	-	0.67	14
Vezë*	2.36	2.29	3.15	-	2.75	-13
Mjaltë	7.22	10.51	11.34	-	19.08	68

Burimi: DAESB – MBPZhR; * njësia 30 copë;

Bazuar në të dhënat e tregut me pakicë për vitin 2024, ka pasur luhatje të konsiderueshme në çmimet e produkteve bujqësore, me një rënie të ndjeshme të çmimeve për: pulë ferme, drithëra (si gruri dhe misri), vezë dhe trangull ndërsa molla, spinaqi, arra, fasulja e kungulli kanë regjistruar një rritje të çmimeve.

Është e rëndësishme të theksohet se ndryshimet specifike të çmimeve mund të ndryshojnë ndjeshëm sipas vendit, rajonit dhe kohës brenda vitit 2024.

Tabela 12: Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg

Prodhime	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2022 (%)
Grurë	0.38	0.36	0.42	-	0.26	-38
Misër	0.62	0.46	0.42	-	0.35	-17
Domate	0.77	0.94	1.26	-	1.16	-8
Fasule	2.60	2.67	3.01	-	4.23	41
Kungull	0.42	0.34	0.61	-	0.85	39
Kungull misiri	0.45	0.51	0.75	-	0.72	-4
Lakër	0.47	0.55	0.55	-	0.68	24
Patate	0.48	0.49	0.60	-	0.61	2
Qepë	0.64	0.57	0.71	-	0.79	11
Shalqi	0.45	0.28	0.28	-	0.25	-11
Spec	1.08	1.08	1.38	-	1.47	7
Spinaq	1.07	1.08	1.08	-	1.83	69
Trangull	0.65	0.86	1.06	-	0.83	-22
Arrë	2.56	2.96	3.22	-	4.80	49
Dardhë	1.35	1.45	1.48	-	1.96	32
Dredhëz	1.97	1.87	1.93	-	1.89	-2
Kumbull	0.79	1.48	1.08	-	1.26	17
Mjedër	2.26	4.25	3.93	-	4.67	19
Mollë	0.74	0.84	0.69	-	1.17	70
Rrush tryeze	1.09	1.20	1.52	-	1.81	19
Mëzet dhe Mëshqerra	3.02	2.49	3.05	-	3.34	10
Pulë ferme	2.13	2.38	4.51	-	2.29	-49
Qumësht	0.48	0.49	0.60	-	0.76	27
Vezë*	2.61	2.57	3.61	-	3.01	-17
Mjaltë	7.50	10.77	11.42	-	12.70	11

Burimi: DAESB – MBPZhR; * njësia 30 copë;

Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore

Në dinamikën e tregut bujqësor në Kosovë, gjatë periudhave jashtë sezonit të prodhimit vendor, produktet e importuara mbizotërojnë me çmime më të larta për shkak të kostove të transportit, doganës dhe nevojës së tregut. Për disa produkte, pavarësisht kostove shtesë të importit, çmimi i shitjes me shumicë (ose çmimi në fermë) i produktit vendor mund të jetë më i lartë se çmimi i produktit të importuar, si shkak i efikasitetit të ulët në prodhimin vendor, kostove më të larta të inputeve, mungesës së subvencioneve apo mbështetjes shtetërore sesa konkurrentët rajonal, si dhe avantazhit ku prodhuesit e huaj prodhojnë në sasi shumë më të mëdha, duke ulur kostot për njësi, etj. Kjo diskrepancë çmimesh përbën sfidë për fermerët tanë kur produkti i tyre hyn në treg dhe duhet të konkurrojë me mallrat e importuara që janë më të lira.

Në tabelën vijuese janë të paraqitura çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, ku çmimet të cilat kanë pësuar rënie në raport me vitin paraprak janë: shalqiri, gruri, misri, domatja,

fasulja, speci, trangulli, ndërsa rritje më të dukshme në çmim kanë shënuar: kungulli i misiri, kungulli, spinaqi dhe qepa.

Tabela 13: Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg

Prodhime	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2022 (%)
Grurë	0.38	0.36	0.35	-	0.23	-34
Misër	0.45	0.43	0.32	-	0.27	-17
Domate	1.19	0.97	1.36	-	0.98	-28
Fasule	2.01	2.36	2.77	-	1.99	-28
Kungull	0.28	0.31	0.41	-	0.81	98
Kungull misiri	0.46	0.43	0.52	-	1.07	106
Lakër	0.64	0.52	0.44	-	0.33	-24
Patate	0.84	0.56	0.70	-	0.50	-29
Qepë	0.61	0.55	0.58	-	1.03	77
Shalqi	0.85	0.79	0.89	-	0.44	-50
Spec	1.50	1.23	1.86	-	1.31	-30
Spinaq	1.19	1.21	0.78	-	1.47	88
Trangull	1.21	1.00	1.12	-	0.76	-32
Arrë	2.06	2.42	2.67	-	3.28	23
Dardhë	1.47	1.48	1.36	-	1.27	-7
Dredhëz	2.94	2.63	2.30	-	1.90	-17
Kumbull	2.34	2.19	1.56	-	1.34	-14
Mjedër	-	-	-	-	-	-
Mollë	0.82	0.77	0.72	-	0.77	7
Rrush tryeze	1.97	2.78	2.48	-	1.88	-24
Mëzet dhe Mëshqerra	2.87	2.98	2.75	-	2.38	-14
Pulë ferme	2.21	2.72	-	-	-	-
Qumësht	-	-	-	-	-	-
Vezë*	2.15	2.21	3.31	-	2.56	-23
Mjaltë	8.60	7.54	11.39	-	10.29	-10

Burimi: DAESB – MBPZhR; * njësia 30 copë;

Shkaqet në ngritjen e çmimeve të importit vijnë kryesisht nga inflacioni global, çmimet e energjisë, konflikti Rusi-Ukrainë dhe ndryshimet klimatike. Në tabelën e paraqitur për vlerën për njësi të importit të prodhimeve bujqësore, rritje të theksuar kishte: dredhëza, molla, dardha, qepa, fasulja, ndërsa rënie të lehtë shohim te: shalqiri, gruri, kumbulla etj.

Tabela 14: Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg

Prodhimi	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 (%)
Grurë	0.19	0.22	0.33	0.25	0.21	-15
Misër	0.16	0.22	0.29	0.20	0.19	-6
Domate	0.35	0.35	0.52	0.72	0.67	-7
Fasule	0.93	0.86	0.87	0.96	1.13	18
Kungull dhe Kungull misiri	0.52	0.56	0.55	0.68	0.71	5
Lakër	0.16	0.22	0.23	0.31	0.36	17
Patate	0.20	0.23	0.29	0.44	0.42	-5
Qepë	0.47	0.47	0.32	0.97	1.16	20
Shalqi	0.15	0.15	0.18	0.33	0.26	-21
Spec	0.46	0.42	0.54	0.85	0.89	5
Spinaq	0.50	0.57	0.69	0.91	0.84	-8
Trangull	0.29	0.38	0.44	0.56	0.54	-4
Arrë	1.52	1.45	1.59	1.69	1.68	0
Dardhë	0.67	0.62	0.51	0.68	0.81	20
Dredhëz	0.69	0.93	0.85	1.00	1.42	42
Kumbull	0.31	0.39	0.43	0.92	0.83	-9
Mjedër	2.21	3.55	0.85	1.17	1.24	6
Mollë	0.32	0.30	0.32	0.42	0.54	30
Rrush tryeze	0.46	0.46	0.51	1.00	1.12	12
Mëzet dhe Mëshqerra	1.32	1.37	1.86	2.15	2.30	7
Pulë ferme	1.99	1.99	2.39	2.52	2.43	-3
Qumësht	0.55	0.55	0.69	0.73	0.73	-1
Vezë*	1.11	1.35	1.50	1.89	2.13	12
Mjaltë	4.98	5.06	6.05	6.12	6.36	4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR; * njësia 30 copë;

Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së

Krahasimin e çmimeve të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, mund ta shohim në tabelën vijuese, ku janë të paraqitura çmimet e prodhimeve bujqësore për disa kultura siç janë: gruri, misri, lakra, patatja, molla, vezët dhe mjalti.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të themi se Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me vendet e BE-së sidomos te: mjaltja, molla dhe misri, ndërsa më të ulët te: vezët dhe patatja.

Tabela 15: Çmimet e disa prodhimeve bujqësore në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2024, €/kg

Shtetet	Grurë	Misër	Lakër	Patate	Mollë	Vezë*	Mjaltë
Bullgaria	0.19	0.18	0.29	0.34	0.35	11.44	3.57
Çekia	0.19	0.18	0.34	0.32	0.70	10.51	-
Greqia	0.23	0.26	0.53	0.69	0.82	25.61	6.63
Hungaria	0.18	0.18	0.36	0.37	0.46	10.29	2.26
Austria	0.18	0.20	-	0.35	0.95	19.77	11.90
Rumania	0.18	0.17	0.68	0.51	0.68	13.27	4.89
Kosova	0.21	0.25	0.52	0.29	0.95	10.50	17.60

Burimi: Eurostat; DAESB - MBPZhR, *njësia për 100 copë

Kosova si treg i vogël me prodhim të ulët vendor është shumë e varur nga importi, e si rezultat edhe çmimet diktohen nga kjo. Ndryshimet e çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe rajonal ndikojnë direkt në çmimet e vendit. Çmimet mbeten të larta në raport me standardin e jetesës.

1.7 Privatizimi i tokave bujqësore

Procesi i transformimit të pronës ka një rëndësi kyçe për zhvillimin ekonomik të vendit, duke synuar jo vetëm transformimin e pronës shoqërore, por edhe rritjen e investimeve, dhe fuqizimin e sektorit privat dhe publik. Agjencia Kosovare e Privatizimit ka punuar në vazhdimësi për të siguruar që proceset të zhvillohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, duke funksionuar si organ i pavarur publik, ka vazhduar misionin e saj në privatizimin e tokave dhe pronave shoqërore edhe gjatë vitit 2024.

Ky proces udhëhiqet nga korniza ligjore që siguron që funksionet dhe përgjegjësitë e saj të kryhen në mënyrë autonome. Të dhënat e paraqitura përkufizojnë nivelet e ndryshme të privatizimit nëpër regjionet e Kosovës dhe nënvizojnë rolin e vazhdueshëm të AKP-ës në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit.

Gjatë vitit të kaluar, janë ndërmarrë një sërë iniciativash për të përshpejtuar dhe optimizuar procesin e transformimit të pronës, duke përmirësuar procedurat administrative dhe duke rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e aseteve. Po ashtu, janë zhvilluar mekanizma më efikas të monitorimit dhe vlerësimit, të cilët kanë ndihmuar identifikimin e sfidave dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim. Gjatë vitit 2024 ka vazhduar procesi i shitjes së aseteve dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, ku shfaqen tendenca për privatizimin e tokës bujqësore me ç'rast u shënuar një rritje minimale në krahasim me vitet e mëparshme.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore e privatizuar është 30,829 ha, dhe shpërndarja në nivel të regjioneve nga viti 2005 deri në vitin 2024 është si më poshtë:

Tabela 16: Shitjet e tokave bujqësore sipas regjioneve, 2005-2024

Regjioni	Sipërfaqja në ari	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqet e shitura (%)	Çmimi mesatar i shitjes €/ari	Çmimi mesatar i shitjes €/ha	Vlera totale e shitjeve €	Vlera e shitjes (%)
Prishtina	285,382	2,854	9.3	256	25,612	73,092,963	44.9
Peja	1,168,880	11,689	37.9	25	2,530	29,575,869	18.2
Prizren	667,271	6,673	21.6	48	4,829	32,222,298	19.8
Gjilan	326,397	3,264	10.6	55	5,543	18,092,961	11.1
Mitrovica	634,954	6,350	20.6	16	1,560	9,907,430	6.1
Gjithsej	3,082,884	30,829	100	52.8	€ 5,284	162,891,521	100


Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Gjithsej vlera e shitjeve nga privatizimi i tokave bujqësore përmes procedurave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në periudhën 2005-2024 ishte 162,891,521 €.

Çmimi më i lartë mesatar i shitjes së një hektari të tokës bujqësore ishte në regjionin e Prishtinës 25,612 €, ndërsa regjionet tjera paraqiten me çmimin e shitjes së një hektari tokë shumë më të ulët. Rrjedhimisht edhe në vlerën totale të shitjeve, regjioni i Prishtinës ka qenë prijësi që kishte vlerë 73,092,963 €, vijuar nga regjionet tjera që kishin vlerë shumë më të ulët. Pjesëmarrje më të madhe në gjithsej totalin e shitjes së tokave bujqësore apo të privatizuara ka pasur në regjionin e Pejës 37.9%, më pas qëndron Prizreni 21.6%, Mitrovica 20.6%, Gjilani 10.6% dhe Prishtina me 9.3%.

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave të tokave të privatizuara në vitin 2024, vërehet se kishte një rritje shumë të vogël krahasuar me vitin 2023.

Figura 20: Sipërfaqja në ha dhe çmimi mesatar i shitjes së një ha tokë bujqësore



Burimi: AKP

Numri i shitjeve të tokave bujqësore nga viti 2005 deri në vitin 2024 ishte 1,007 (përfshirë vitin 2015 dhe 2016 ku nuk ka pasur shitje), sipërfaqja e tokës bujqësore e privatizuar është 30,829 hektar. Përqindja e shitjeve në ha ishte më e madhe në vitin 2009 me 22% të shitjeve, vijuar nga viti 2007 me 18% dhe viti 2006 me 17%, që paraqet 57% të shitjeve për këto 3 vite.

Tabela 17: Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2024

Viti	Numri i shitjeve	Sipërfaqet/ari	Sipërfaqet/ha	Shitjet/€	Çmimi/€ari	Çmimi/€ha	(%) shitjeve në ha
2005	4	143,638	1,436	2,330,300	16.2	1,622	5
2006	20	537,170	5,372	10,976,727	20.4	2,043	17
2007	28	544,032	5,440	9,058,458	16.7	1,665	18
2008	12	219,813	2,198	7,054,321	32.1	3,209	7
2009	45	678,960	6,790	27,310,237	40.2	4,022	22
2010	24	231,804	2,318	6,565,458	28.3	2,832	8
2011	37	163,975	1,640	19,321,796	117.8	11,783	5
2012	43	153,885	1,539	6,109,522	39.7	3,970	5
2013	53	79,436	794	5,518,674	69.5	6,947	3
2014	49	139,613	1,396	5,502,417	39.4	3,941	5
2017	51	19,944	200	4,996,121	250.5	25,043	1
2018	84	40,529	405	12,326,987	304.2	30,414	1
2019	221	68,873	689	27,450,020	398.6	39,858	2
2020	193	59,211	592	14,089,201	238.0	23,795	2
2021	96	1,379	14	1,442,497	1,046.4	104,529	0
2022	2	23	0	21,280	913.3	106,400	0
2023	28	293	3	613,666	2,092.3	204,555	0
2024	17	309	3	2,203,840	7,143.7	710,916	0
Gjithsej	1,007	3,082,884	30,830	162,891,521	12,807	1,287,547	100

Burimi: AKP

2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

2.1 Përdorimi i tokës bujqësore

Përdorimi i tokës bujqësore mbetet relativisht i njëjtë me vitet e kaluara, me një tkurrje të lehtë prej 0.11% gjatë vitit 2024, në krahasim me vitin paraprak, ku ndryshimi më i madh në përqindje ishte te kategoria “Kopshte” me rënie prej 14.1%, kurse si sipërfaqe në hektar rënie më të madhe kishte kategoria “Livadhe dhe kullosa” me 445 ha. Ndërsa, rritje si përqindje më të lartë kishte kategoria “Fidanishte” prej 7.7%, mirëpo nëse e marrim si rritjen më të madhe të sipërfaqeve në hektar, kategoria “Tokë e punueshme – ara” kishte rritjen më të lartë, prej 360 ha.

Në vitin 2024 kishte 40.7% më shumë numër të banesave të ndërtuara, në raport me regjistrimin e vitit 2011.⁴ Ndryshimet demografike dhe trendet e viteve të fundit të zhvillimit të sektorit të ndërtimit, kanë ndikuar shumë edhe te tokat bujqësore, ku sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore u është ndërruar destinimi në atë ndërtimore.

Tabela 18: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %	Pjesëmarrja në 2024 (%)
Tokë e punueshme – ara	188,372	188,375	188,405	188,435	188,795	0.19	44.93
-Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	8,435	8,491	8,584	8,487	8,216	-3.19	
-Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	547	562	583	685	698	1.94	
Kopshte	1,133	1,089	1,080	1,062	913	-14.09	0.22
Plantacione të pemëve	10,029	10,144	10,377	10,618	10,408	-1.97	2.48
Plantacione të vreshtave	3,437	3,471	3,472	3,432	3,406	-0.79	0.81
Fidanishte	137	140	150	161	173	7.69	0.04
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	217,102	217,107	216,998	216,980	216,534	-0.21	51.53
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	420,210	420,327	420,482	420,688	420,229	-0.11	100


Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)⁵

Sipërfaqja e shfrytëzuar me tokë bujqësore mbizotërohet nga livadhet dhe kullosat, si dhe nga tokë e punueshme – ara, që përbëjnë 96.5% të gjithë tokës së shfrytëzuar bujqësore. Të gjitha kategoritë e tjera: kopshte, plantacione të pemëve, vreshta, si dhe fidanishte marrë së bashku, përfaqësohen me 3.5%. Sipërfaqja e tokave të punueshme – ara, kishte vazhdimisht një rritje të lehtë ndër vite, kurse livadhet dhe kullosat kishin rënie të lehtë.

⁴ ASK, Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (2024)

⁵ Statistikat e prezantuara në këtë tabelë paraqiten në bazë të grupimit si në AEB të ASK-së dhe ka ndryshime me të dhënat e prezantuara në nënkapitujt 2.2.2 dhe 2.2.3 për arsye të ndryshimit në grupim (p.sh dredhëza në këtë tabelë (nënkaptulli 2.1) sipas grupimit të ASK-së është e kategorizuar në perime ndërsa tek nënkaptulli 2.2.3 është e paraqitur tek pemët).


Figura 21: Tokë e punueshme - ara dhe livadhe e kullosa



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Shfrytëzimi i tokës së punueshme gjatë vitit 2024, sipas kategorive mbetet i mbizotëruar nga livadhet dhe kullosat me 216,534 ha, apo me pjesëmarrje në totalin prej 52%. Toka e punueshme - ara me 188,795 ha apo 43% të pjesëmarrjes, ndërsa plantacione e pemëve pjesëmarrje kishin 10,408 ha (2%), ku për shkak të dëmtuesve të ndryshëm kishte një rënie të sipërfaqeve prej 210 ha. Perimet, kopshtet dhe fidanishtet kishin pjesëmarrje prej 2%, ndërsa plantacionet e vreshtave pavarësisht një rënie të lehtë, prapë pjesëmarrjen e kishin 1%.

Figura 22: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2024



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore 2024, punuar nga DAESB-MBPZhR; *janë zbritur perimet nga gjithsej sipërfaqja e tokës së punueshme - ara

2.2 Prodhimtaria bimore

2.2.1 Drithërat

Sipërfaqja e kultivuar me drithëra prej 125,274 ha në vitin 2024, përbën 30% të gjithsej sipërfaqeve të shfrytëzuara të tokës bujqësore, kulturat që zënë sipërfaqet më të mëdha të drithërave janë: gruri me 64%, me një rritje të lehtë prej 39 ha, misri kishte pjesëmarrje 32%, ku kishte rritje të sipërfaqeve prej 804 ha, apo 2% më të lartë se në vitin paraprak dhe ishte kultura që së bashku me grurin kishin rritje të sipërfaqeve. Kurse kulturat tjera të drithërave: elb dhe elb birre, thekër, tërshërë dhe drithërat tjera kokërr zënë 4%, tek e gjithë sipërfaqja e kultivuar me drithëra, këto kultura shënuan rënie të sipërfaqeve të mbjella.

Përveç kulturës së thekrës, rritje të prodhimit kishte tek të gjitha kulturat e drithërave pavarësisht që te disa kishte zvogëlim të sipërfaqeve të mbjella. Rritja e sipërfaqes së drithërave prej 594 ha, apo 0.5% në vitin 2024, dhe rritja e rendimentit tek të gjitha kulturat e drithërave, rezultojë me rritje të prodhimit prej 58,626 tonë, apo 12.3% më i lartë se në vitin paraprak.

Tabela 19: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2020-2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Drithëra	124,714	124,477	124,618	124,681	125,274	0.5
Grurë	80,473	79,970	79,984	80,025	80,064	0.0
Misër	39,684	39,710	39,797	39,844	40,648	2.0
Elb dhe elb birre	1,982	2,060	2,067	2,017	1,843	-8.6
Thekër	425	555	567	574	518	-9.8
Tërshërë	2,009	2,030	2,045	2,061	2,058	-0.2
Drithëra të tjera kokërr	141	153	158	160	144	-9.8
Prodhimi	t					
Drithëra	529,112	504,371	518,724	477,149	535,775	12.3
Grurë	341,819	322,018	330,913	303,496	344,274	13.4
Misër	175,180	170,393	175,226	161,667	178,850	10.6
Elb dhe elb birre	5,764	5,610	5,882	5,487	5,597	2.0
Thekër	1,153	1,409	1,492	1,462	1,377	-5.8
Tërshërë	4,769	4,500	4,715	4,554	5,184	13.8
Drithëra të tjera kokërr	427	441	496	483	493	2.1
Rendimenti	t/ha					
Grurë	4.25	4.03	4.14	3.79	4.30	13.4
Misër	4.41	4.29	4.40	4.06	4.40	8.4
Elb dhe elb birre	2.91	2.72	2.85	2.72	3.04	11.6
Thekër	2.71	2.54	2.63	2.55	2.66	4.4
Tërshërë	2.37	2.22	2.31	2.21	2.52	14.0
Drithëra të tjera kokërr	3.03	2.89	3.14	3.02	3.41	13.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Në vitin 2024, gruri mbetet kultura dominuese në prodhimin e drithërave në Kosovë, duke zënë 63.9% të sipërfaqes totale të mbjellë me drithëra ose 80,064 ha. Me një rendiment mesatar

prej 4.16 t/ha, prodhimi vendor i grurit, pas humbjeve, arriti në 333,088 tonë, duke siguruar 75% të nevojave për përdorim vendor. Përdorimi kryesor i grurit është për konsum njerëzor, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohet në ushqimin e kafshëve dhe përdorime tjera. Vlera e prodhimit vendor ishte 69.9 mil. €, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ në vlerë prej 27.7 mil. €. Konsumi mesatar për kokë banori për grurë, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje gruri⁶ ishte 193 kg.

Misri, i cili kryesisht përdoret si ushqim për kafshë, në vitin 2024 zuri 32.4% të sipërfaqes së mbjellë me drithëra, me 40,648 ha. Rendimenti mesatar prej 4.34 t/ha mundësoi një prodhim vendor (pas humbjeve) prej 176,291 tonë, që mbulon 76% të nevojave vendore. Pavarësisht këtij niveli prodhimi, importet vazhdojnë të jenë të nevojshme, duke rezultuar në një bilanc tregtar negativ prej 3.6 mil. €. Vlera e prodhimit vendor të misrit ishte 44.1 mil. €, ndërsa konsumi mesatar për kokë banori për misër, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje misri⁷ ishte 15 kg.

Tabela 20: Bilancet e furnizimit për grurë dhe misër, 2024

	Njësia	Grurë	Misër
Sipërfaqja	ha	80,064	40,648
Pjesëmarrja në gjithsej sip. me drithëra	%	63.9	32.4
Rendimenti	t/ha	4.16	4.34
Prodhimi (pas humbjeve)	t	333,088	176,291
Importi	t (p.e)	118,163	55,156
Furnizimi	t	451,251	231,447
Eksporti	t (p.e)	7,906	132
Përdorimi vendor	t	443,345	231,316
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	75	76
Konsumi për kokë banori	kg	193	15
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.21	0.25
Vlera e prodhimit	mil. €	69.9	44.1
Bilanci tregtar	mil. €	-27.7	-3.6

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2024; ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR

Sqarim: p.e - nënkupton ekuivalentët e produktit, d.m.th çdo produkt me përmbajtje gruri/misri të konvertuar në grurë/misër; Importi dhe Eksporti përfshinë sasisë e grurit/misrit si dhe të gjitha produkteve tjera të fazës së parë të përpunimit e që përmbajnë grurë/misër e të cilat përmes koeficientëve të konvertimit janë të konvertuara në grurë/misër.

2.2.2 Perimet

Në vitin 2024, në vendin tonë, janë kultivuar gjithsej 18,821 ha sipërfaqe me perime. Në këtë sipërfaqe përfshihen sipërfaqet në fushë të hapur, serra dhe kopshte.

Nëse analizojmë sipërfaqet me perime për periudhën 2020-2024, shihet një tendencë e luhatjes së sipërfaqeve ndër vite, duke u shoqëruar çdo vit me rritje deri në vitin 2023, dhe viti 2024 me

⁶ Produktet e fazës së parë të përpunimit.

⁷ Produktet e fazës së parë të përpunimit.

një rënie të lehtë të sipërfaqeve të kultivuara me perimeve. Referuar raportit me vitin 2023, vërehet se në përgjithësi ka pasur një zvogëlim të sipërfaqeve të mbjella me kultura perimore, për 4%.

Kulturat të cilat dominonin sipërfaqet me perime janë: patatja (3,806 ha), speci (3,109 ha), kungulli (2,472 ha), fasulja (2,817 ha), qepa (1,364 ha), shalqiri (1,290 ha), lakra (880 ha), kungulli i misirit (824 ha), domatja (752 ha), pjepri (297 ha), trangulli (273 ha), hudhra (255 ha), spinaqi (157 ha), karota (131 ha) dhe kulturat tjera perimore të cilat ndajnë një sipërfaqe më të vogël nën 100 ha, krahasuar me kulturat e cekura më lartë.

Bazuar në krahasimin e të dhënave mes viteve 2023 dhe 2024, për kulturat perimore, vërehet se ka pasur rënie dhe ngritje shumë të lehtë mes kulturave, kryesisht është shënuar zvogëlim i sipërfaqeve tek gjitha kulturat, ndërsa rritje paraqitet vetëm tek kultura e sallatës.

Tabela 21: Sipërfaqja me perime, 2020 - 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Perime	19,243	19,399	19,571	19,602	18,821	-4.0
Patate	3,771	3,854	3,884	3,918	3,806	-2.8
Domate	815	800	805	793	752	-5.1
Patëllxhan i zi	7	8	9	14	12	-16.8
Spec	3,134	3,146	3,154	3,178	3,109	-2.2
Kungull	2,577	2,612	2,628	2,621	2,472	-5.7
Kungull misiri	913	918	926	853	824	-3.5
Trangull	313	305	315	307	279	-8.9
Shalqi	1,303	1,309	1,316	1,307	1,290	-1.3
Pjepër	318	321	329	312	297	-4.9
Lakër	918	923	937	946	880	-7.0
Lulelakër	50	52	57	62	56	-9.3
Spinaq	150	154	162	174	157	-9.6
Sallatë	79	82	84	89	91	2.4
Panxhar i kuq	7	7	9	10	8	-17.6
Rrepkë (rilkë)	5	5	4	6	2	-67.1
Majdanoz	11	12	14	14	12	-10.3
Presh (purri)	76	78	80	89	77	-13.3
Qepë	1,367	1,369	1,376	1,392	1,364	-2.0
Hudhër	264	263	270	274	255	-6.6
Fasule	2,904	2,914	2,941	2,956	2,817	-4.7
Bizele	68	69	68	71	65	-9.1
Bishtajoret tjera	43	46	44	51	47	-7.6
Karota	126	129	132	140	131	-6.6
Perime tjera	22	23	26	28	18	-38.3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20,'21,'22,'23,'24)

Gjatë vitit 2024, gjithsej prodhimi i perimeve ka arritur sasinë prej 276,660 tonë, për sipërfaqen prej 18,821 ha të mbjellë me perime, krahasuar me vitin 2023, prodhimi i përgjithshëm i perimeve shënon rënie për 3.9%.

Gjatë analizimit të kulturave perimore, vërehet se rënie më e konsiderueshme është shënuar tek kultura e rrepkës (rilkë) prej 67.9%, pasuar nga patëllxhani i zi me 17.9%, majdanozi me 17.2%, preshi (purri) 15.7% si dhe spinaqi 15%, ndërsa tek perimet e tjera është shënuar rënie 42%. Sa i përket rritjes së sasisë së prodhimit në raport me vitin 2023, kryesojnë kulturat: si fasulja me 10% dhe bizelja me 7.6%.

Tabela 22: Prodhimi i perimeve, 2020 – 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Prodhimi	t					
Perime	290,555	282,734	295,802	287,819	276,660	-3.9
Patate	74,508	73,984	75,500	75,639	74,678	-1.3
Domate	20,242	19,163	20,206	19,695	18,663	-5.2
Patëllxhan i zi	137	144	174	246	202	-17.9
Spec	53,889	52,381	55,353	53,751	52,134	-3.0
Kungull	22,535	22,326	22,551	21,826	21,200	-2.9
Kungull misiri	21,712	20,896	21,975	19,815	18,595	-6.2
Trangull	9,055	8,480	8,973	8,652	7,791	-10.0
Shalqi	26,324	25,971	27,490	25,623	24,966	-2.6
Pjepër	4,335	4,103	4,467	4,027	3,766	-6.5
Lakër	24,850	24,123	25,546	25,498	22,957	-10.0
Lulelakër	905	885	954	1,013	903	-10.9
Spinaq	1,452	1,408	1,557	1,560	1,326	-15.0
Sallatë	677	635	708	701	722	3.0
Panxhar i kuq	56	51	67	66	68	2.8
Rrepkë (rilkë)	49	45	50	55	18	-67.9
Majdanoz	123	130	151	136	112	-17.2
Presh (purri)	1,425	1,398	1,465	1,585	1,336	-15.7
Qepë	18,859	17,792	19,190	19,012	18,123	-4.7
Hudhër	1,588	1,471	1,594	1,463	1,315	-10.1
Fasule	5,708	5,349	5,597	5,176	5,694	10.0
Bizele	152	138	154	146	158	7.6
Bishtajoret tjera	126	116	116	133	133	-0.6
Karota	1,694	1,585	1,770	1,810	1,691	-6.6
Perime tjera	155	162	194	190	110	-42.0

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20/'21/'22/'23/'24)

Nga analizimi i mësipërm i sipërfaqeve dhe prodhimit të perimeve për vitin 2024, situata e njëjtë është reflektuar me ndryshim edhe tek rendimenti i perimeve për vitin 2024.

Të dhënat e rendimentit në tabelën e mëposhtme, tregojnë për rënie dhe rritje tek disa kultura perimore, krahasuar me vitin 2023. Kulturat të cilat dominojnë me rritje janë panxhari i kuq

me 24.8%, bizelja me 18.3%, fasulja me 15.4%, bishtajoret tjera me 7.5%, kungulli me 3%, patatja me 1.6% dhe sallata me 0.5%, ndërsa, gjitha kulturat tjera perimore kanë shënuar rënie.

Tabela 23: Rendimenti i perimeve, 2020 – 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Rendimenti	t/ha					
Patate	19.8	19.2	19.4	19.3	19.6	1.6
Domate	24.8	24.0	25.1	24.8	24.8	-0.2
Patëllxhan i zi	18.4	17.3	19.6	17.7	17.4	-1.3
Spec	17.2	16.6	17.6	16.9	16.8	-0.9
Kungull	8.7	8.5	8.6	8.3	8.6	3.0
Kungull misiri	23.8	22.8	23.7	23.2	22.6	-2.8
Trangull	28.9	27.8	28.5	28.2	27.9	-1.1
Shalqi	20.2	19.8	20.9	19.6	19.4	-1.3
Pjepër	13.6	12.8	13.6	12.9	12.7	-1.7
Lakër	27.1	26.1	27.3	27.0	26.1	-3.2
Lulelakër	18.0	17.0	16.8	16.3	16.0	-1.7
Spinaq	9.7	9.2	9.6	9.0	8.5	-6.0
Sallatë	8.6	7.8	8.4	7.9	7.9	0.5
Panxhar i kuq	8.0	7.1	7.7	6.9	8.6	24.8
Rrepkë (rilkë)	10.1	9.1	11.3	9.9	9.7	-2.3
Majdanoz	11.0	10.6	10.7	10.0	9.3	-7.8
Presh (purri)	18.8	18.0	18.4	17.9	17.4	-2.8
Qepë	13.8	13.0	13.9	13.7	13.3	-2.7
Hudhër	6.0	5.6	5.9	5.3	5.1	-3.7
Fasule	2.0	1.8	1.9	1.8	2.0	15.4
Bizele	2.2	2.0	2.3	2.1	2.4	18.3
Bishtajoret tjera	2.9	2.5	2.7	2.6	2.8	7.5
Karota	13.5	12.3	13.4	12.9	12.9	0.0
Perime tjera	7.1	7.0	7.5	6.7	6.3	-6.0

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20,'21,'22,'23,'24)

Duke iu referuar sipërfaqeve me kultura të dyta pas korries së parë për vitin 2024, vihet re se ka pasur rritje në sipërfaqe për 19%, nga gjithsej 300 ha sa ishin në vitin 2023, në vitin 2024, kjo sipërfaqe e përgjithshme shënon 357 ha.

Krahasuar me vitin 2023, gjatë vitit 2024, rritje ka shënuar kultura e sallatës me 40%, qepa 33.4%, spinaqi 24.7% dhe lakra 7.3%, ndërsa kulturat tjera me 33.2%, kanë shënuar rritje të sipërfaqeve.

Prodhimi shënoi rritje për 17.8%, krahasuar me vitin 2023 dhe reflektohet nga rritja në sipërfaqe dhe po ashtu edhe në rendiment.

Tabela 24: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korrjes së parë

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Perime	281	285	303	300	357	19.0
Lakër	88	91	98	123	132	7.3
Spinaq	145	142	150	130	162	24.7
Sallatë	6	6	6	5	7	40.0
Qepë	28	32	34	30	40	33.4
Të tjera	14	15	15	12	16	33.2
Prodhimi	t					
Perime	3,008	2,992	3,421	3,759	4,428	17.8
Lakër	2,106	2,090	2,349	2,902	3,210	10.6
Spinaq	466	426	556	456	614	34.6
Sallatë	18	17	20	15	25	64.9
Qepë	187	208	242	182	293	61.6
Të tjera	231	251	254	204	285	39.8
Rendimenti	t/ha					
Lakër	21.5	23.8	24.7	23.9	23.1	3.1
Spinaq	2.3	4.1	3.8	3.2	3.0	7.9
Sallatë	8.7	6.7	3.5	3.0	2.9	17.8
Qepë	2.7	8.3	7.0	6.7	6.6	21.1
Të tjera	9.7	15.2	17.9	16.5	16.4	4.9

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20,'21,'22,'23,'24)

Bilancet e furnizimit për perimet për vitin 2024, mbulojnë 10 kulturat perimore të cilat njihen si ndër më të kultivuarat për nga sipërfaqet këtë vit e të cilat janë: patatja, speci, fasulja, kungulli dhe kungulli i misirit, qepa, shalqiri, lakra, domatja, trangulli dhe pjepri, dhe bashkë edhe me kulturat tjera përbëjnë gjithsej 18,821 ha të kultivuara me perime.

Referuar analizës të secilës kulturë të përfshirë në bilance vërehet se vendi ynë ka arritur të shumtën e rasteve të përmbush nevojat për konsum me mbi 50%. Faktor i rëndësishëm ndër shumë të tjerë që kanë ndikuar në këta indikator është mbështetja ofruar sektorit të perimtarisë për vite me radhë, përmes Programit të Pagesave Direkte dhe Programit të Zhvillimit Rural.

Nëse i referohemi secilës kulturë, atëherë mund të themi se kultura perimtare e cila për vite me radhë në Kosovë është ndër më të kultivuarat është kultura e patates, që njëherësh zë sipërfaqen më të madhe prej 3,806 ha, duke kontribuar me 20% në sipërfaqen totale të mbjellë me perime. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë në plotësimin e nevojave të popullsisë për kulturën e patates shënon 96%, ndërsa konsumi për kokë banori me këtë kulturë është 49 kg në vit.

Kultura e specit, është në mesin e kulturave me sipërfaqen më të madhe të kultivuar prej 3,109 ha, dhe që ka shkallë të lartë të vetëmjaftueshmërisë në plotësimin e nevojave për konsum prej 83%, ndërsa sasia e eksportit shënon 1,633 tonë dhe sasia e importit 12,057 tonë, mirëpo gjithsesi arrihet që të plotësohen nevojat e popullsisë për konsum në nivel të kënaqshëm. Sa i përket konsumit për kokë banori, kultura e specit paraqitet me gjithsej 39 kg në vit.

Kultura e fasules është në mesin e kulturave e cila zë 15% të gjithsej sipërfaqeve me perime, në sipërfaqe prej 2,817 ha. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë, në plotësimin e nevojave për konsum arrin 53%, ndërsa konsumi vjetor për kokë banori shënon 7 kg në vit.

Kultura e kungullit dhe kungullit të misirit, të cilat së bashku përbëjnë 3,295 ha dhe marrin pjesë 18% në sipërfaqen e përgjithshme me perime, janë ndër kulturat e vetme të cilat i përmbushin nevojat për përdorim vendor me 100%.

Kultura e qepës u kultivua në sipërfaqe prej 1,364 ha, apo 7% në totalin e sipërfaqes së përgjithshme me perime. Përqindja e plotësimit të nevojave vendore për konsum ose shkalla e vetëmjaftueshmërisë të kulturës së qepës ishte 77%, u eksportua në sasi prej 493 tonë, ndërsa sasia e importit shënoi 5,849 tonë. Konsumi për kokë banori shënoi 15 kg në vit.

Tabela 25: Bilanci i furnizimit për patate, spec, fasule, kungull dhe kungull misiri dhe qepë (2024)

	Njësia	Patate	Spec	Fasule	Kungull dhe kungull misiri ⁸	Qepë
Sipërfaqja	ha	3,806	3,109	2,817	3,295	1,364
Pjesëmarrja në gjithsej sip. me perime	%	20	17	15	18	7
Rendimenti	t/ha	20	17	2	12	13
Prodhimi	t	74,678	52,134	5,694	39,795	18,123
Importi	t	10,690	12,057	5,075	73	5,849
Furnizimi	t	85,369	64,191	10,769	39,869	23,973
Eksporti	t	7,501	1,633	99	147	493
Përdorimi vendor	t	77,868	62,557	10,670	39,721	23,480
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	96	83	53	100	77
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.29	1.02	3.53	0.42	0.52
Vlera e prodhimit	mil. €	22	53	20	17	9
Bilanci tregtar	mil. €	-3.2	-8.9	-5.8	0	-2.7
Konsumi për kokë banori	kg	49	39	7	25	15

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2024; ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR

Kultura e shalqirit, është kultura e cila zë 7% të gjithsej sipërfaqeve të kultivuara me perime, ndërsa konsumi për kokë banori shënon 27 kg/vit. Njëkohësisht arrin që të plotësojë 58% të nevojave për konsum të përgjithshëm të popullsisë, ku sasia e eksportit shënon 119 tonë dhe ajo e importit 18,351 tonë.

Kultura e lakrës shënon 880 ha në gjithsej sipërfaqet e mbjella me perime. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo e plotësimit të nevojave vendore për konsum shënon 98%. Ndërsa konsumi për kokë banori shënon 15 kg në vit.

Kultura e domates, është kultivuar në sipërfaqe prej 752 ha dhe shkallën e mbulueshmërisë për plotësim të nevojave vendore për konsum e ka 58%. Sasia e eksportit llogaritet 2,904 tonë, ndërsa ajo e importit 16,506 tonë. Konsumi për kokë banori shënon 20 kg në vit.

⁸ Tek kungulli dhe kungulli i misirit 25 kg përfshinë jo vetëm konsumin njerëzor por edhe përdorime tjera.

Kultura e trangullit, ka pjesëmarrje prej 279 ha në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me perime. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo përqindja e plotësimit të nevojave vendore për konsum të trangullit me prodhim vendor është 60%, ndërsa konsumi për kokë banori shënon 8 kg në vit.

Kultura e pjeprit, është e kultivuar në pjesëmarrje prej 2% në gjithsej sipërfaqen me perime. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë llogaritet 83% që plotëson nevojat vendore për konsum. Konsumi për kokë banori shënon 3 kg në vit.

Tabela 26: Bilanci i furnizimit për shalqi, lakër, domate, trangull dhe pjepër (2024)

	Njësia	Shalqi	Lakër	Domate	Trangull	Pjepër
Sipërfaqja	ha	1,290	880	752	279	297
Pjesëmarrja në gjithsej sip. me perime	%	7	5	4	1	2
Rendimenti	t/ha	19	26	25	28	13
Prodhimi	t	24,966	22,957	18,663	7,791	3,766
Importi	t	18,351	3,957	16,506	6,050	784
Furnizimi	t	43,317	26,914	35,169	13,841	4,550
Eksporti	t	119	3,369	2,904	775	0.04
Përdorimi vendor	t	43,198	23,545	32,265	13,066	4,550
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	58	98	58	60	83
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.19	0.52	0.67	0.61	1.09
Vlera e prodhimit	mil. €	5	12	13	5	4
Bilanci tregtar	mil. €	-4.8	-0.5	-9.6	-2.7	-0.5
Konsumi për kokë banori	kg	27	15	20	8	3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2024; ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR

2.2.3 Pemët

Për gjatë vitit 2024, në vendin tonë janë mbjellë gjithsej 10,622 ha sipërfaqe me pemë, apo 2.3% më pak se sa në vitin 2023. Duke analizuar periudhën 2020-2024, çdo vit sipërfaqet e mbjella me pemë janë rritur, mirëpo viti 2024 shënon sipërfaqen më të ulët në raport me vitin paraprak.

Në analizën e kulturave pemëtare për vitin 2024, vërejmë se gjitha kulturat kanë shënuar ulje të sipërfaqeve në raport me vitin 2023, përveç lajthis që shënon një ngritje të kënaqshme me 12.7% dhe arrës me 2%. Ndërsa, kulturat të cilat kishin sipërfaqe më të mëdha gjatë vitit 2024 janë: molla 3,068 ha, kumbulla 2,201 ha, arra 1,770 ha dhe mjedra 1,428 ha, pasuar nga kulturat tjera pemëtare të cilat kishin sipërfaqe nën 1,000 ha.

Sa i përket prodhimit të pemëve për vitin 2024, sasia e përgjithshme shënoi 66,215 tonë dhe në raport me vitin 2023, paraqet zvogëlim për 8.8%. Kur analizojmë prodhimin sipas kulturave vërejmë se përveç lajthisë (8.1%) që ka shënuar rritje, të gjitha kulturat tjera pemëtare kanë shënuar zvogëlim të prodhimit në raport me vitin 2023.

Në vitin 2024, kulturat pemëtare me prodhimin më të lartë ishin kulturat të cilat kanë epërsi në sasi prodhimi si: molla (36,499 tonë), kumbulla (10,718 tonë), dardha (5,101 tonë), mjedra

(4,867 tonë) dhe arra (3,030 tonë), pasuar nga kultura tjera me sasi më të ulët prodhimi nën 3,000 tonë.

Tabela 27: Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2020 – 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Pemët	10,265	10,382	10,619	10,867	10,622	-2.3
Molla	3,068	3,083	3,091	3,108	3,068	-1.3
Dardha	614	618	629	641	633	-1.2
Ftoni	91	93	95	102	99	-2.9
Mushmolla	51	53	54	58	56	-3.5
Kumbulla	2,201	2,210	2,214	2,225	2,201	-1.1
Kajsia	22	24	24	27	25	-7.5
Pjeshka	48	51	53	55	52	-5.4
Qershia	108	110	112	124	122	-1.6
Vishnja	233	240	242	250	245	-2.0
Arra	1,295	1,352	1,540	1,735	1,770	2.0
Lajthia	390	391	393	394	444	12.7
Dredhëza	236	238	242	249	214	-14.3
Mjedra	1,661	1,665	1,668	1,616	1,428	-11.7
Manaferra	31	32	33	37	35	-4.8
Boronica	86	93	98	108	107	-0.4
Aronia	98	98	99	104	89	-14.1
Pemë tjera	32	30	32	34	32	-5.9
Prodhimi	t					
Pemët	72,265	67,533	75,713	72,578	66,215	-8.8
Molla	38,049	37,381	40,028	39,791	36,499	-8.3
Dardha	5,586	4,953	5,649	5,370	5,101	-5.0
Ftoni	1,264	1,266	1,329	1,319	1,206	-8.6
Mushmolla	219	213	243	236	214	-9.3
Kumbulla	13,147	11,247	13,284	11,558	10,718	-7.3
Kajsia	94	94	113	112	97	-13.4
Pjeshka	288	262	320	305	269	-11.8
Qershia	538	485	561	578	528	-8.7
Vishnja	740	705	779	738	671	-9.1
Arra	2,591	2,108	3,100	3,250	3,030	-6.8
Lajthia	116	101	170	148	160	8.1
Dredhëza	1,487	1,439	1,686	1,615	1,304	-19.2
Mjedra	6,659	5,840	6,740	5,827	4,867	-16.5
Manaferra	233	223	251	262	245	-6.3
Boronica	464	469	596	628	598	-4.8
Aronia	692	656	728	714	594	-16.8
Pemë tjera	97	90	135	127	112	-11.8

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20,'21,'22,'23,'24)

Rendimenti i pemëve për vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, shënoi ulje tek të gjitha kulturat pemëtare si pasojë e kushteve jo të favorshme klimatike të cilat janë shoqëruar në

vendin tonë, gjë që ka shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe zvogëlim në rendimentin e kulturave pemëtare.

Tabela 28: Rendimenti i pemëve, 2020 - 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Rendimenti	t/ha					
Molla	11.3	12.4	12.1	13.0	12.8	-7.1
Dardha	8.4	9.1	8.0	9.0	8.4	-3.9
Ftoni	14.2	13.9	13.6	14.0	13.0	-5.8
Mushmolla	4.4	4.3	4.0	4.5	4.1	-6.1
Kumbulla	6.1	6.0	5.1	6.0	5.2	-6.3
Kajsia	4.6	4.2	4.0	4.6	4.2	-6.3
Pjeshka	7.0	6.0	5.2	6.1	5.5	-6.8
Qershia	5.5	5.0	4.4	5.0	4.7	-7.2
Vishnja	3.3	3.2	2.9	3.2	2.9	-7.2
Arra	2.3	2.0	1.6	2.0	1.9	-8.6
Lajthia	0.3	0.3	0.3	0.4	0.4	-4.1
Dredhëza	7.1	6.3	6.0	7.0	6.5	-5.8
Mjedra	4.4	4.0	3.5	4.0	3.6	-5.4
Manaferra	7.9	7.5	6.9	7.5	7.1	-1.5
Boronica	5.5	5.4	5.0	6.1	5.8	-4.4
Aronia	7.5	7.1	6.7	7.3	6.9	-3.1
Pemë tjera	3.2	3.0	3.0	4.2	3.7	-6.3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20,'21,'22,'23,'24)

Bilancet e furnizimit për kulturat pemëtare, përfshijnë kulturat si molla, kumbulla, mjedra, arra, dardha, lajthia, vishnja, dredhëza dhe qershia, të cilat zënë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të kultivuara me pemë me një total të përgjithshëm prej 10,622 ha për vitin 2024. Gjithashtu në kuadër të bilanceve për pemë është i përfshirë edhe bilanci për rrush tryeze.

Nga analiza e përgjithshme e të dhënave të bilanceve, rezulton se vendi ynë plotëson mbi 50% të nevojave vendore për konsum në shumicën e kulturave pemëtare, ndërsa pjesa tjetër sigurohet përmes importit. Sikurse kulturat perimtare edhe kulturat pemëtare mbështeten vazhdimisht nga dy programet mbështetëse të MBPZhR-së, gjë që ndikon edhe në përmirësim të gjendjes në kuadër të sektorit.

Molla është kultura e cila mbulon sipërfaqen më të madhe në totalin e përgjithshëm të sipërfaqeve me pemë, dhe shënon 3,068 ha. Plotësimi i nevojave vendore për konsum me mollë është 75%, ndërsa sasia e importit shënon 12,033 tonë dhe ajo e eksportit 39 tonë. Konsumi i mollës për kokë banori në vitin 2024 ishte 31 kg në vit.

Kultura e kumbullës, është kulturë e cila zë 21% të gjithë sipërfaqes së kultivuar me pemë, dhe plotësimi i nevojave për konsum me prodhim vendor është 98%, pra kjo kulturë pemëtare

importohet shumë pak dhe po ashtu sasia e eksportit është e ulët. Konsumi për kokë banori shënon 7 kg/vit.

Kultura e mjedrës, është kulturë pemëtare e cila plotëson tërësisht nevojat për konsum të popullsisë në Kosovë dhe gjithashtu edhe eksportohet në sasi prej 1,261 tonë, duke vazhduar të rezultojë edhe me bilanc tregtar pozitiv për vite me radhë. Konsumi i mjedrës për kokë banori llogaritet 2 kg në vit, dhe gjithashtu plotëson nevojat për konsum.

Arra, është një kulturë e cila ka sipërfaqe prej 1,770 ha në totalin e sipërfaqes me pemë. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë apo plotësimi i nevojave për konsum vendor është i kënaqshëm dhe arrin 90%, ndërsa konsumi për kokë banori llogaritet 2 kg në vit.

Kultura e dardhës shënon sipërfaqe prej 633 ha, mbulimi i nevojave për konsum llogaritet 63%, pjesa tjetër u importua në sasi prej 2,986 tonë, ndërsa eksporti shënoj sasi shumë të vogël. Konsumi për kokë banori ishte rreth 5 kg në vit.

Tabela 29: Bilanci i furnizimit për mollë, kumbull, mjedër, arrë dhe dardhë (2024)

	Njësia	Molla	Kumbulla	Mjedra	Arra	Dardha
Sipërfaqja	ha	3,068	2,201	1,428	1,770	633
Pjesëmarrja në gjithsej sip. me pemë	%	29	21	13	17	6
Rendimenti	t/ha	11.9	5	3	2	8
Prodhimi	t	36,499	10,718	4,867	3,030	5,101
Importi	t	12,033	277	242	331	2,968
Furnizimi	t	48,532	10,995	5,109	3,362	8,069
Eksporti	t	39	10	1,261	1	1
Përdorimi vendor	t	48,494	10,985	3,848	3,361	8,068
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	75	98	126	90	63
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.95	1.15	2.10	3.97	1.53
Vlera e prodhimit	mil. €	35	12.3	10	12	8
Bilanci tregtar	mil. €	-6.3	-0.3	3.0	-1.2	-2.4
Konsumi për kokë banori	kg	31	7	2	2	5

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2024; ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR

Kultura e lajthisë, zë sipërfaqe prej 444 ha, në gjithsej sipërfaqen me pemë. Plotësimi i nevojave vendore për konsum të lajthisë është i kënaqshëm dhe paraqitet me 90%, ndërsa konsumi për kokë banori llogaritet 0.1 kg në vit.

Kultura e vishnjës, përbën 245 ha sipërfaqe me pemë, gjithashtu plotëson nevojat për konsum vendor me 85%. Konsumi për kokë banori për kulturën e vishnjës, llogaritet 0.5 kg për vit.

Kultura e dredhëzës shënon gjithsej sipërfaqe prej 214 ha në totalin e sipërfaqes së mbjellë me pemë, plotëson nevojat për konsum me 80% dhe pjesa tjetër importohet. Konsumi për kokë banori shënon 1 kg në vit.

Qershia, shënon gjithsej 122 ha në sipërfaqen e përgjithshme me pemë. Kjo kulturë arrin të plotësoj nevojat për konsum me 72%. Konsumi për kokë banori llogaritet 0.5 kg në vit.

Rrushi i tryezës, shënon sipërfaqe prej 967 ha, dhe arrihen të plotësohen nevojat e konsumit vendor me 75%. Sasia e importit shënoi 2,111 tonë, ndërsa ajo e eksportit 40 tonë. Konsumi për kokë banori me rrush tryeze llogaritet 5 kg në vit.

Tabela 30: Bilanci i furnizimit për lajthi, vishnja, dredhëz, qershia dhe rrush tryeze (2024)

	Njësia	Lajthia	Vishnja	Dredhëza	Qershia	Rrush tryeze
Sipërfaqja	ha	444	245	214	122	967
Pjesëmarrja në gjithsej sip. me pemë	%	4	2	2	1	28
Rendimenti	t/ha	0.4	3	6	4	6
Prodhimi	t	160	671	1,304	528	6,162
Importi	t	18	156	1,679	244	2,111
Furnizimi	t	177	827	2,984	771	8,273
Eksporti	t	0	39	1,345	37	40
Përdorimi vendor	t	177	788	1,639	734	8,232
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	90	85	80	72	75
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	3.71	2.99	2.20	3.05	0.75
Vlera e prodhimit	mil. €	1	2.0	3	2	5
Bilanci tregtar	mil. €	-0.1	-0.2	-0.2	-0.3	-2.3
Konsumi për kokë banori	kg	0.1	0.5	1	0.5	5

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2024; ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR

2.2.4 Vreshtat dhe verërat

Vreshtat

Gjatë vitit 2024, sipërfaqet e vreshtave shënojnë 3,406 ha, nga 3,432 ha sa ishin në vitin 2023 dhe vërehet që ka pasur një rënie prej 0.8%. Sipërfaqet me rrush tryeze janë rritur për 0.6%, ndërsa ato me rrush për verë janë zvogëluar për 1.3%. Prodhimi shënon gjithsej 21,163 tonë dhe ka pasur rritje të lartë prej 118%, por shihet se është rezultat i kënaqshëm edhe në rendiment me rritje për 119.8%. Këto ndryshime pozitive gjatë vitit 2024, shihen se janë shumë të favorshme në krahasim me vitin 2023, këto rezultate janë arritur për shkak të kushtet klimatike të favorshme, gjë që ka reflektuar edhe me rendimet të lartë tek vreshtat.

Tabela 31: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2020 – 2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Vreshta	3,437	3,471	3,472	3,432	3,406	-0.8
Rrush tryeze	911	938	951	961	967	0.6
Rrush për verë	2,526	2,533	2,521	2,471	2,438	-1.3
Prodhimtaria	t					
Vreshta	26,330	26,527	23,506	9,706	21,163	118.0
Rrush tryeze	6,281	7,435	7,045	3,399	6,162	81.3
Rrush për verë	20,049	19,091	16,461	6,307	15,002	137.9
Rendimenti	t/ha					
Vreshta	7.7	7.6	6.8	2.8	6.2	119.8
Rrush tryeze	6.9	7.9	7.4	3.5	6.4	80.1
Rrush për verë	7.9	7.5	6.5	2.6	6.2	141.1

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Të dhënat për sipërfaqet me rrush tryeze ndër vite tregojnë një rritje të lehtë gjatë vitit 2024, po ashtu edhe prodhimi në vitin 2024 ka qenë më i kënaqshëm se sa në vitin paraprak. Nëse krahasojmë varietetet e rrushit të tryezës për vitin 2024, duke përfshirë sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e tyre, themi se gjithsej sipërfaqja e kultivuar me rrush tryeze ishte 967 ha, apo 6 ha më shumë se në vitin 2023, një rritje shumë e ulët, ndërsa si rezultat i kushteve klimatike të cilat kanë prekur këtë sektor për vitin 2024, dhe prodhimi ka shënuar një ngritje për 81.3% në vitin 2024, ku nga 3,399 tonë sa ishte në vitin 2023, ka ngritje të prodhimit në 6,162 tonë.

Në vitin 2024, vazhdojnë të dominojnë disa varietete të cilat ishin të njëjta edhe në vitet paraprake. Varietete dominuese janë: Muskat Hamburg me 281 ha, pasuar nga Muskat Italian me 201 ha, Afuz Ali me 118 ha, Kardinal me 98 ha dhe varieteti Viktoria me 92 ha. Varietetet tjera kultivohen në sipërfaqe më të vogël nën 90 ha dhe përbëjnë 176 ha të gjithsej sipërfaqes së kultivuar me rrush tryeze për vitin 2024.

Tabela 32: Varietetet e rrushit të tryezës, 2024

Varietetet	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti (t/ha)	Sipërfaqja në %
Muskat Hamburg	281.0	1,597.6	5.7	29.1
Muskat Italian	201.0	1,259.1	6.3	20.8
Afuz Ali	118.5	592.1	5.0	12.3
Kardinal	98.1	674.0	6.9	10.1
Viktoria	92.0	744.7	8.1	9.5
Moldavkë	48.1	397.5	8.3	5.0
Michele Palieri	33.4	323.1	9.7	3.5
Black Magic	14.5	76.0	5.2	1.5
Demir Kapi	11.4	75.8	6.6	1.2
Ribier	9.1	59.2	6.5	0.9
Antigona	8.1	57.9	7.2	0.8
Rrush tryeze eksperimental	7.9	20.0	2.5	0.8
Crimson Seedless	9.8	44.4	4.5	1.0
Red Globe	6.4	44.4	6.9	0.7
Regina	4.7	10.1	2.1	0.5
Prima	9.8	68.7	7.1	1.0
E hershmja e Rahovecit	2.5	33.4	13.5	0.3
Mbretëresha	1.9	24.5	13.2	0.2
Muskat Korrikut	1.6	7.3	4.5	0.2
Aromera	1.5	7.2	4.9	0.2
Katarina	1.2	13.7	11.8	0.1
Platinia	1.0	6.6	6.9	0.1
Izabella	0.6	4.5	7.8	0.1
Strashenski	1.3	8.1	6.5	0.1
Angela	0.6	4.2	6.5	0.1
Esther	1.2	7.5	6.5	0.1
Gjithsej	967.1	6,161.6	6.4	100

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sipërfaqet me rrush vere ishin gjithsej 2,438 ha gjatë vitit 2024, nga e cila sipërfaqe ajo e kultivuar me varietete të rrushit për prodhimin e verës së kuqe ishte 1,564 ha, ndërsa ajo e kultivuar me varietete për prodhimin e verës së bardhë ishte 875 ha.

Në pjesën më të madhe të sipërfaqes të dedikuar për verën e kuqe, varieteti Vranç, vazhdon të jetë lider me 476 ha, pasuar nga varieteti Prokupë me 330 ha, varieteti Game me 220 ha, Burgundez i Zi me 140 ha, si dhe varietete tjera me sipërfaqe nën 100 ha, që përbëjnë gjithsej 396 ha.

Në lidhje me varietetet e rrushit të verës së bardhë, pjesa më e madhe është e kultivuar me varietetin Smederevkë me sipërfaqe 363 ha, i pasuar nga Rizlingu Italian me sipërfaqe 229 ha dhe varieteti Shardone me 103 ha, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes prej 179 ha është e kultivuar me varietete tjera nën 100 ha.

Tabela 33: Varietetet e rrushit të verës, 2024

Varietete për verë të kuqe	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti t/ha	Sipërfaqja në %
Vranç	476.1	3,472.4	7.3	30.44
Prokupë	330.4	1,945.0	5.9	21.13
Game	220.3	991.4	4.5	14.09
Burgundez i kuq (Pino Noir)	140.5	817.2	5.8	8.98
Zhametë	88.1	429.5	4.9	5.64
Kabernet Sauvignon	79.6	480.2	6.0	5.09
Merlot	61.3	248.9	4.1	3.92
Syrah	43.7	290.8	6.7	2.79
Frankovkë	26.7	72.7	2.7	1.70
Kabernet Frank	24.1	21.8	0.9	1.54
Game me ngjyrë	17.2	111.2	6.5	1.10
Pllodvin (Rrush i kuq)	16.5	75.3	4.6	1.06
Pinot Grigo (përhimët)	6.5	53.9	8.3	0.41
Petit Verdo	4.4	31.0	7.0	0.28
Carmenere	7.1	44.4	6.2	0.46
Cabernet Volos	3.3	11.2	3.4	0.21
Kalmet	6.9	45.1	6.5	0.44
Kartoshia	0.9	4.2	4.5	0.06
Malbec	0.4	1.6	3.5	0.03
Sheshi i zi	0.8	5.2	6.6	0.05
Sangjovezo	0.8	3.5	4.7	0.05
Marselane	0.6	4.2	6.9	0.04
Viogner	7.6	46.0	6.0	0.49
Gjithsej varietete për verë të kuqe	1,563.7	9,206.7	5.9	100
Varietete për verë të bardhë	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (t)	Rendimenti t/ha	Sipërfaqja në %
Smederevkë	362.9	2,526.1	7.0	41.50
R. Italian	229.6	1,542.3	6.7	26.25
Shardone	102.9	737.9	7.2	11.76
R. Rajne	59.9	356.7	6.0	6.85
Prokup i bardhë (Zhuplanka)	26.5	139.5	5.3	3.03
Burgundez i Bardhë	24.7	136.8	5.5	2.83
Melnik	11.5	29.9	2.6	1.31
Rrakacitel	11.2	55.4	5.0	1.28
Traminer	8.1	39.7	4.9	0.92
Sovinjon	10.0	70.1	7.0	1.14
Zhillavka	3.6	29.3	8.1	0.41
Sorelis	2.2	9.3	4.2	0.25
Fleurtai	1.9	8.5	4.6	0.21
Semillon	6.2	41.2	6.6	0.71
Nebibolo	0.9	5.2	6.1	0.10
Malvazia	1.1	2.2	2.0	0.12
Viogner	7.4	43.5	5.9	0.84
Solaris	1.6	8.6	5.4	0.18
Broner	0.2	1.1	5.2	0.02
Muskat i bardhë	2.4	11.7	4.8	0.28
Gjithsej varietete për verë të bardhë	874.7	5,795.0	6.6	100
Gjithsej rrush i verës	2,438.4	15,001.7	6.2	

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Verërat

Prodhimi i verës në vitin 2024, është rritur më shumë se tri herë, duke përfshirë këtu verën e bardhë, të kuqe dhe roze që llogariten gjithsej 8,207 mijë litra nga 2,493 mijë litra, sa ishte totali në vitin 2023. Këto rezultate për sektorin, kanë ardhur si rezultat i kushteve të favorshme klimatike për sektorin e verërave dhe vreshtave. Krahasuar me vitin 2023, prodhimi i verës roze ka shënuar rritje shumë të lartë por që në krahasim me mesataren e 4 viteve të fundit, rritja është 28%. Edhe prodhimi i verës së kuqe dhe të bardhë në vitin 2024 shënoj rritje shumë të madhe, krahasuar me vitin 2023 që u karakterizua me kushte jo të favorshme klimatike, por që krahasuar me mesataren e 4 viteve paraprake, prodhimi i verës së kuqe është rritur për 28% dhe prodhimi i verës së bardhë për 13%.

Periodha 2020-2024 ka treguar një variabilitet të vazhdueshëm në prodhimin e verës, vërejmë se ka pasur luhajtje të vazhdueshme. Viti 2020, cilësohet si viti me prodhimtarinë më të lartë për këtë periudhë, duke përfshirë verën e kuqe dhe të bardhë pa verën roze, ndërsa vitin 2023 kishte prodhimtarinë më të ulët në të gjitha llojet e verërave.

Tabela 34: Prodhimi i verës 2020-2024, '000 litra

Prodhimi	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Verë e bardhë	5,100	4,744	4,643	1,720	4,583	166
Verë e kuqe	4,295	3,001	3,140	771	3,574	364
Verë roze	35	40	79	2	50	2,396
Gjithsej verë	9,429	7,785	7,862	2,493	8,207	229

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Të dhënat e prodhimit të verës të paraqitura në vijim sipas kompanive tregojnë se nga gjithsej 39 kompani për vitin 2024, liderët në prodhim janë: “Stone Castle Vineyards & Winery”, pasuar nga “Sunny Hills”, “Biopak”, “Illyrian Winery”, “Bodrumi i vjetër”, “Besa Winery”, “Suhareka Verari”, si dhe kompani të tjera me sasi prodhimi më të ulët se 1,000 hl.

Nëse i krahasojmë sasi të prodhimit sipas llojit të verës, atëherë kompanitë të cilat janë në epërsi me prodhim për verë të bardhë janë: “Stone Castle Vineyards & Winery”, “Biopak”, “Sunny Hills”, “Illyrian Winery”, “Bodrumi i vjetër”, “Besa winery”, “Suhareka Verari”, “Kosova Wine”, NTP “Muja”, pasuar nga kompani të tjera me sasi më të ulët prodhimi se 500 hl. Kompanitë të cilat prijnë me prodhim për verë të kuqe janë: “Stone Castle Vineyards & Winery”, “Sunny Hills”, “Bodrumi i vjetër”, “Biopak” “Illyrian Winery”, “Besa Winery”, NTP “Muja”, “Kosova Wine” dhe “Suhareka Verari” pasuar nga kompani tjera me sasi më të ulët prodhimi se 600 hl. Sa i përket verës rose vetëm 499 hl, janë prodhuar nga kompania “Stone Castle Vineyards&Winery”.

Tabela 35: Prodhimi i verës sipas kompanive, 2024

Kompanitë prodhuese të licencuara		Verë e bardhë/hl	Verë e kuqe/hl	Verë rose/hl	Gjithsej verë/hl	Rush për distilim/hl
1	Stone Castle Vineyards&Winery	19,577	10,888	499	30,964	2,752
2	Besa Winery	2,042	1,605	-	3,647	-
3	Bodrumi i Vjetër	3,084	5,441	-	8,525	-
4	Sunny Hills	5,997	7,289	-	13,286	-
5	NTP “ Muja”	595	1,008	-	1,603	-
6	Biopak	6,460	3,502	-	9,962	-
7	Illyrian Winery	5,137	2,353	-	7,490	-
8	Kosova Wine	729	995	-	1,724	3
9	Suhareka Verari	1,368	735	-	2,103	-
10	Dak	52	101	-	152	6
11	Bodrumi Familjar Sefa	50	50	-	100	-
12	BAHHA	-	117	-	117	16
13	Tradita	-	100	-	100	-
14	Agro ALF	150	275	-	425	5
15	Rahovec	48	107	-	155	10
16	Hoçanska Vina	16	36	-	52	8
17	Çabrati	28	27	-	55	5
18	Dardania Wine	-	13	-	13	2
19	Reho Wine	-	33	-	33	1
20	Astra - Vera	-	90	-	90	-
21	Cana Wine"	16	49	-	65	-
22	Noster Fructus	215	76	-	291	5
23	Agro vita	40	186	-	226	13
24	Wine&Art	-	16	-	16	-
25	Risons	38	-	-	38	-
26	Zana Wine	-	6	-	6	-
27	Samiri H&A	12	90	-	102	7
28	Dardan Hajdaraj	-	44	-	44	-
29	Dualos	-	210	-	210	217
30	Wineplant	81	25	-	106	-
31	Kalaja Dafina	-	21	-	21	-
32	Dea	-	25	-	25	1
33	Vinica Petrovic	50	100	-	150	-
34	Canziba Wine	15	20	-	35	2
35	Hani Wine	10	61	-	70	5
36	Dafina e bardhë	-	5	-	5	-
37	Albana Vuciterna	-	11	-	11	6
38	Igor Vecevic	14	17	-	31	-
39	JV Destilery	-	17	-	17	11
Gjithsej		45,825	35,741	499	82,065	3,076

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Analizat fiziko - kimike të verës

Në laboratorin e enologjisë, janë realizuar gjithsej 898 analiza fiziko – kimike, përgjatë vitit 2024. Këto analiza përfshijnë, 139 mostra për treg të brendshëm, 197 ishin mostra për eksport, 205 për import, 207 për pije të forta alkoolike importi, 38 pije të forta alkoolike eksporti. Po ashtu janë realizuar edhe 112 mostra të cilat janë kryer për nevojat e kompanive. Për vitin 2024 nuk është kërkuar asnjë analizë gjatë përpunimit.

Tabela 36: Analizat fiziko – kimike të verës për periudhën 2020 – 2024

Mostra për/nga	2020	2021	2022	2023	2024
Mostra treg i brendshëm	115	131	139	124	139
Mostra eksport	273	268	246	216	197
Mostra import	4	5	47	18	205
Pije të forta alkoolike import	14	51	42	57	207
Pije të forta alkoolike eksport	-	-	-	-	38
Nevoja të kompanive	35	99	-	157	112
Gjatë përpunimit	-	-	126	-	-
Gjithsej	441	554	600	572	898

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2.2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra

Sipërfaqja e kulturave foragjere dhe drithërave të gjelbëra kishte rënie me 420 ha, apo 1.1%, ku rënie të sipërfaqeve kishin të gjitha kulturat me përjashtim të misrit të gjelbër si kulturë e parë dhe si kulturë e dytë. Rënien më të madhe në përqindje e kishte elbi i gjelbër me 32.3%, kurse si sipërfaqe, rënien më të madhe e kishte kategoria “Përzierje e barit” me 142 ha.

Për dallim nga sipërfaqja e kulturave foragjere dhe drithërave të gjelbëra, prodhimi gjatë vitit 2024 është rritur me 10,245 tonë, apo 4.1% më i lartë se viti paraprak. Rritjen më të lartë në prodhim e kishte misri i gjelbër me 4,431 tonë dhe jonxha me 4,401 tonë. Kurse rënien më të lartë të prodhimit e kishte tërshëra e gjelbër me 567 tonë dhe tërfili me 286 tonë.

Rritja e prodhimit ishte si rezultat i rritjes së rendimentit për hektar, ku të gjitha kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra pa përjashtim, kishin rritje të rendimentit. Rritjen më të lartë të rendimentit si përqindje e kishte elbi i gjelbër me 10.8%, deri te lakra dhe panxhari foragjer që kishin rritje më të ulët prej 2.2% secili.

Tabela 37: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave foragjere, 2020-2024

Kultura	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Kultura foragjere	37,761	37,914	37,887	37,820	37,400	-1.1
Jonxhë	18,329	18,360	18,359	18,336	18,302	-0.2
Tërfil	904	931	938	932	807	-13.3
Përzierje e barit	9,261	9,293	9,316	9,325	9,183	-1.5
Urov	661	615	610	617	590	-4.5
Misër i gjelbër	7,037	7,061	7,080	7,105	7,138	0.5
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	205	210	200	176	210	19.3
Grurë i gjelbër	391	407	415	411	380	-7.4
Tërshërë e gjelbër	788	801	756	709	611	-13.7
Elb i gjelbër	51	57	57	51	35	-32.3
Thekër e gjelbër	27	35	19	18	15	-16.9
Lakër, panxhar foragjer	42	77	73	80	73	-8.9
Foragjere të tjera të gjelbëra (grashinë)	66	67	65	60	56	-6.8
Prodhimi	t					
Kultura foragjere	256,560	249,907	254,387	247,951	258,196	4.1
Jonxhë	85,503	82,330	85,044	82,333	86,734	5.3
Tërfil	3,652	3,551	3,703	3,552	3,266	-8.1
Përzierje e barit	30,584	28,819	29,542	28,269	30,171	6.7
Urov	3,045	2,659	2,710	2,631	2,690	2.2
Misër i gjelbër	120,653	118,937	120,088	118,680	123,111	3.7
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	2,851	2,875	2,807	2,398	3,009	25.5
Grurë i gjelbër	3,044	3,044	3,205	3,111	2,971	-4.5
Tërshërë e gjelbër	5,771	5,635	5,415	5,058	4,491	-11.2
Elb i gjelbër	196	205	205	196	147	-25.0
Thekër e gjelbër	268	316	177	161	138	-14.3
Lakër, panxhar foragjer	723	1,278	1,215	1,320	1,229	-6.9
Foragjere të tjera të gjelbëra (grashinë)	271	258	274	240	239	-0.4
Rendimenti	t/ha					
Jonxhë	4.66	4.48	4.63	4.49	4.74	5.5
Tërfil	4.04	3.82	3.95	3.81	4.04	6.1
Përzierje e barit	3.30	3.10	3.17	3.03	3.29	8.4
Urov	4.61	4.32	4.44	4.26	4.56	7.0
Misër i gjelbër	17.15	16.84	16.96	16.70	17.25	3.2
Misër i gjelbër (kulturë e dytë)	13.90	13.67	14.04	13.62	14.33	5.2
Grurë i gjelbër	7.79	7.47	7.72	7.57	7.81	3.2
Tërshërë e gjelbër	7.32	7.04	7.16	7.14	7.35	2.9
Elb i gjelbër	3.84	3.62	3.62	3.82	4.23	10.8
Thekër e gjelbër	9.95	8.96	9.31	9.03	9.31	3.1
Lakër, panxhar foragjer	17.33	16.55	16.73	16.41	16.77	2.2
Foragjere të tjera të gjelbëra (grashinë)	4.12	3.85	4.20	4.00	4.27	6.9

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

2.2.6 Kulturat industriale

Sipërfaqja me kultura industriale u rrit me 720 ha gjatë vitit 2024, në raport me vitin 2023, apo në përqindje me 74%. Prodhimi i kulturave industriale u rrit me 125%, apo me 1,509 tonë shtesë gjatë vitit 2024. Rritja e prodhimit është reflektim i rritjes së rendimentit të kulturave industriale me 29%, kjo rritje në sasi ishte 364 kg/ha.

Tabela 38: Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave industriale, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Kulturat industriale	1,065	885	887	970	1,690	74.2
Prodhimi	t					
Kulturat industriale	1,348	1,022	1,180	1,205	2,714	125.3
Rendimenti	t/ha					
Kulturat industriale	1.27	1.16	1.33	1.24	1.61	29.3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23,'24)

*ASK nuk publikon të dhënat në nivel të kulturave industriale për shkak të numrit të vogël të vërtetimeve dhe në anketë në kuadër të kulturave industriale përfshihen: luledielli, duhani, soja dhe bimët mjekësore aromatike.

2.2.7 Livadhe dhe kullosa

Gjatë vitit 2024, kishte rënie të sipërfaqeve me livadhe, kullosa dhe tokë të përbashkët me 0.2%. Kategoria “Tokë e përbashkët” kishte rënie në sipërfaqe prej 555 ha, kurse kullosat dhe livadhet kishin rritje të sipërfaqeve me nga 55 ha secila. Prodhimi në vitin 2024, kishte rritje prej 5.8% në raport me vitin 2023, ku si rezultat, rritja e prodhimit në sasi ishte 13,413 tonë shtesë. Rendimenti për vitin 2024 u shtua me 187 kg/ha, apo 5.8% më i lartë se ai i vitit 2023.

Tabela 39: Sipërfaqja me livadhe, kullosa, tokë e përbashkët dhe prodhimi nga livadhet, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Sipërfaqja	ha					
Gjithsej	217,102	217,107	216,998	216,980	216,534	-0.2
Livadhe	70,717	70,723	70,736	70,768	70,822	0.1
Kullosa	5,147	5,152	5,160	5,170	5,226	1.1
Tokë e përbashkët	141,238	141,232	141,102	141,041	140,486	-0.4
Prodhimi	t					
Livadhe	247,921	233,323	240,783	229,475	242,888	5.8
Rendimenti	t/ha					
Livadhe	3.51	3.30	3.40	3.24	3.43	5.8

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23,'24)

2.2.8 Bujqësia organike

Rritja e vetëdijesimit të konsumatorëve dhe shqetësimet agro-mjedisore kanë nxitur zhvillimin global të bujqësisë organike. Qëllimi kryesor i prodhimit organik është mbrojtja e shëndetit të njeriut, natyrës dhe mjedisit.

Duke konfirmuar rolin në zhvillimin e sektorit të bujqësisë organike, përmes mbështetjes së konsiderueshme financiare, miratimit të një numri të madh rregulloresh dhe dokumenteve strategjike, Qeveria e Kosovës dhe MBPZhR e konsiderojnë çdo hap drejt metodave më të qëndrueshme të prodhimit, përfshirë bujqësinë organike, si prioritet të lartë për Republikën e Kosovës.

MBPZhR, përmes përfshirjes së saj aktive, vlerëson mbështetjen e dhënë nga prodhuesit dhe akterët e tjerë që kanë kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e bujqësisë organike dhe shpreh mirënjohje për: Shoqatën ORGANIKA, GIZ, CARITAS-CH, IADK, SWISSCONTACT dhe projektin Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE), SNVP, etj. Andaj, në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të gjelbër të bujqësisë në Kosovë, mbështetja jonë do të jetë e vazhdueshme.

Tabela 40: Prodhimtaria organike, 2018 – 2024

Viti	Sipërfaqet e certifikuara organike të kultivuara (ha)	Grumbullimi i PPJD-ve (ha)
2018	788	373,488
2019	1,036	373,488
2020	1,604	373,488
2021	1,718	373,488
2022	667	373,488
2023	520	373,488
2024	310	373,488

Burimi: DPBT/MBPZhR

Bazuar në UA Nr. 02/2019 për sistemin e kontrollit, autoritetin e kontrollit, trupat e kontrollit dhe rregullat për zbatimin e tyre, trupat e kontrollit janë të obliguara të raportojnë në MBPZhR. Raporti për të dhënat statistikore nga trupat e kontrollit për vitin 2024 tregon se në Kosovë janë të kultivuara gjithsej 310 ha me prodhimtari organike:

- 263 ha të kultivuara me bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) me 14 lloje kulturash (*kamomil, hithër, rigon, mentë, sherebelë, bari i bletës, mullagë e bardhë, mullagë e zezë, livandë, cian, kalendulë, borzilok, aguliqe* etj.);
- 3 ha të kultivuara me kunguj organik (fara *kungulli*);
- 37 ha me drithëra organike (grurë);
- 7 ha me aroni;
- 0.15 ha me qershi;
- Kërpudhat janë kultivuar në 227 vazo;
- Mjaltë i prodhuar në 61 koshere;
- Bio-kompost i prodhuar në 1 njësi;

- Zonat e certifikuara për grumbullimin e PPJD-ve janë 373,488 ha (nga kjo zonë janë grumbulluar rreth 39 lloje bimë mjekësore, fruta të egra, erëza si dhe kërpudha);
- 2,356 tonë të grumbulluara (në materie të thatë) në zonat pyjore organike;
- 12 kompani të certifikuara kanë operuar në biznesin e bimëve mjekësore dhe aromatike me 16 qendra grumbullimi në gjithë territorin e Kosovës, të cilat organizojnë grumbullimin, tharjen dhe përpunimin e PPJD-re.

Eksporti i BMA-ve, si nga kultivimi ashtu edhe nga grumbullimi i PPJD-ve, bëhet si produkt gjysmë i përpunuar. Rreth 95% e gjithë prodhimit eksportohet në Gjermani, Austri, Zvicër, Holandë etj.

Certifikimi dhe kapacitetet inspektuese për bujqësinë organike

Në Kosovë, certifikimi i prodhimeve organike kryhet nga trupat e kontrollit ndërkombëtar, të akredituara nga Komisioni Evropian:

- Q-check P.C XK-BIO-179 – Greqi;
- Organska kontrola.ba XK-BIO-101 – Bosnje dhe Hercegovinë;
- Bio-inspecta.ch XK-BIO-161 – Shqipëri.

Duke iu referuar UA Nr. 02/2019 për sistemin e kontrollit, autoritetin e kontrollit, trupat e kontrollit dhe rregullat për zbatimin e tyre, të gjitha trupat e kontrollit që operojnë në Kosovë kanë njoftuar MBPZhR-në për fillimin e aktiviteteve certifikuese në prodhimtarinë organike.

2.3 Ujitja e tokës bujqësore

Gjatë vitit 2024, raportimet e Drejtorive Komunale të Bujqësisë si dhe nga Ndërmarrjet Publike të Ujitjes, janë raportuar se janë ujitur gjithsej 21,333 ha tokë bujqësore, e që krahasuar me vitin 2023, ku sipërfaqet e ujitjes ishin 18,050 ha, niveli i sipërfaqeve të ujitura ka shënuar rritje për 18%, përfshirë ujitjen formale dhe jo formale si të vetmet burime të cilat aplikohen tek ne.

Nga gjithsej 21,333 ha të ujitur gjatë vitit 2024, përmes ujitjes formale të organizuar përmes Ndërmarrjeve Publike të ujitjes, janë ujitur gjithsej 7,485 ha, ndërsa përmes ujitjes jo formale, ujitjes së pa organizuar dhe ujitjes individuale e cila bëhet nga burime të ndryshme ujore si lumenj, puse, etj., janë ujitur 13,848 ha.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme mbi format dhe sasinë e përgjithshme të ujit të shpenzuar në sipërfaqet e tokave bujqësore gjatë vitit 2024, në vendin tonë tregohet se sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar ishte 119,820,891 m³. Nga ku 50,918,151 m³ ishin realizuar nga ndërmarrjet publike të ujitjes si Ibër Lepenci, Radoniqi – Dukagjini dhe Drini i Bardhë përmes ujitjes formale, ndërsa 68,902,741 m³ ishin realizuar përmes ujitjes joformale.

Tabela 41: Sasia e përgjithshme e ujit të shpenzuar në sip. e tokave bujqësore dhe format e ujitjes në Kosovë, 2024

	Sip. ujitur / ha	Sasia mesatare e ujitjes (m ³ /ha ⁻¹)	Sasia e përgjithshme ujit të shpenzuar (m ³)
Ibër Lepenci	1,753	3,250	5,696,015
Radoniqi - Dukagjini	5,478	8,088	44,310,027
Drini i Bardhë	254	3,589	912,108
Ujitje formale	7,485	6,802	50,918,151
Ujitje jo formale	13,848	4,976	68,902,741
Gjithsej	21,333	5,617	119,820,891

Burimi: DPBT – MBPZhR

Raportimi zyrtar i të dhënave për ujitje për vitin 2024, është siguruar nga Drejtoritë Komunale për Bujqësi dhe nga Ndërmarrjet Publike të Ujitjes nën mbikëqyrjen e Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, gjegjësisht Divizionit të Ujitjes. Raportimi është bërë nga gjithsej 29 komuna, ndërsa mungojnë edhe të dhënat për 9 komuna tjera, si Malisheva, Skenderaj, Klllokoti, Ranilluku, Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Novobërda, Zubin Potoku dhe Zveçani, arsyeja e mos raportimit të disa komunave ishte se ende nuk posedojnë sisteme të menaxhimit të ujitjes.

Nga komunat që kanë raportuar të dhënat, komunat me sipërfaqet më të mëdha nën ujitje për vitin 2024 janë: Rahoveci, Peja, Vitia, Prizreni, Klina, Gjakova, Podujeva, Prizreni dhe Suhareka, pasuar nga komunat tjera me sipërfaqe nën ujitje nën 1,000 ha.

Tabela 42: Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2024

Komuna	Burimi i ujitjes	Kulturat e ujitura	Sip. ujitur / ha
Deçan	Drini i Bardhë	Misër, patate, specia, jonxhë, etj.	26
Gjakovë	Radoniqi& Dukagjin, lumenj	Perime, misër, shalqinj, jonxhë, grurë, livadhe	1,447
Drenas	Ibër-Lepenci	Perime, premë, misër, fasule, jonxhë, parqe, etj.	201
Gjilan	Puset, vetanak dhe lumenj	Drithëra, pemë, perime	457
Dragash	Ujësjiellësi, puse	Pemë të imëta	6
Istog	Drini i Bardhë	Misër, livadhe, patate, pemë, perime	205
Kaçanik	Lumenj, puse, përroska	Misër, pemë, perime, livadhe, etj.	342
Klinë	Drini i Bardhë	Misër, perime, pemë, livadhe	1,550
F.Kosovë	L.Drenica, Sitnica, puse	Misër, jonxhë, perime, pemë, qepë, patate	141
Kamenicë	Lumenj, puse	Drithëra, pemë, perime, drunjë dekorativ	94
Mitrovicë	Ibër-Lepenc	Perime, pemë, fasule, misër	200
Lipjan	Lumenj, puse	Pemë, perime, drithëra, etj.	58
Obiliq	Ibër-Lepenc, lumenj dhe puse	Misër, pemë, perime	697
Rahovec	Radoniqi - Dukagjini dhe puse	Perime, misër, shalqi, etj.	3,019
Pejë	Drini i Bardhë, lumenj	Misër, patate, specia, jonxhë, etj.	3,403
Podujevë	Lumi Llap, puset	Drithëra, pemë, perime	1,269
Prishtinë	Ibër-Lepenc, L.Llap, puse	Drithëra, pemë, perime, bimë mjekuese, etj.	319
Prizren	Radoniqi - Dukagjin dhe puset	Misër, perime, shalqi, foragjere, etj.	1,181
Shtime	Lumenj, puse	Perime, perime, misër, etj.	177
Shtërpçë	Lumenj, puse	Misër, perime, mjedër, etj.	555
Suharekë	Lumenj, puse	Pemë, perime, misër	1,025
Ferizaj	Lumenj, puse	Pemë, perime, misër	457
Viti	Puse	Pemë, perime, misër	2,397
Vushtrri	Ibër-Lepenc, lumenj dhe puse	Patate, lakër, misër, kunguj, pemë, livadhe	824
H.Elezit	Lumenj, puse dhe përroska	Pemë, perime, livadhe	33
Mamushë	Lumenj, puse	Perime, misër, jonxhë	520
Junik	Drini i Bardhë, lumenj dhe puse	Drithëra, pemë, perime, livadhe, etj.	134
Graçanicë	Lumenj, puse	Drithëra, pemë, perime	512
Partesh	Puse	Perime, perime, drithëra	85

Burimi: DPBT – MBPZhR

2.4 Blegtoria

2.4.1 Gjedhet

Fondi i gjedheve përbënë një pjesë shumë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore. Ky fond në vitin 2024 kishte 240,848 krerë, në krahasim me vitin paraprak kishte 6,645 krerë më pak. Nga totali i fondit të gjedheve 31% i përkasin kategorisë “Gjedhe më pak se 1 vjeç”, apo 75,431 krerë, 10% i përkasin kategorisë “Gjedhe 1 deri në 2 vjeç”, apo 24,087 krerë, si dhe kategoria dominuese ishte “Gjedhe 2 e më shumë vjeç” me 141,330 krerë, apo 59% të pjesëmarrjes në fondin e përgjithshëm të gjedheve.

Në vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak, fondi i gjedheve kishte rënie, rënie kishte në të gjitha kategoritë, me përjashtim të kategorisë “Viça meshkuj për qëllime tjera/mbarështimi” që kishte rritje për 120 krerë apo 0.8%. Marrë si përqindje rënie më të lartë kishte kategoria “Mëshqerra të mbarësuar për herë të parë” me 8.7%, kurse rënien më të lartë në bazë të numrit të krerëve e kishte kategoria “Lopë qumështore”, me 3,348 krerë.

Tabela 43: Fondi dhe struktura e gjedheve, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Fondi i gjedheve	261,391	260,528	250,899	247,493	240,848	-2.7
Gjedhe më pak se 1 vjeç	84,146	83,238	78,041	77,315	75,431	-2.4
Viça meshkuj për therje	29,762	32,667	30,874	30,496	29,331	-3.8
Viça femra për therje	15,967	15,666	14,650	14,494	14,049	-3.1
Viça meshkuj për qëllime tjera/mbarështim	15,730	15,380	14,060	14,125	14,245	0.8
Viça femra për qëllime tjera/mbarështim	22,687	19,525	18,457	18,200	17,806	-2.2
Gjedhe 1 deri në 2 vjeç	25,559	26,836	25,146	24,746	24,087	-2.7
Meshkuj	14,080	14,513	13,950	14,099	13,814	-2.0
Mëshqerra për therje	2,663	3,705	3,488	3,286	3,131	-4.7
Mëshqerra të tjera	8,816	8,618	7,708	7,361	7,142	-3.0
Gjedhe 2 e më shumë vjeç	151,686	150,454	147,712	145,432	141,330	-2.8
Meshkuj	7,113	7,451	6,619	6,658	6,514	-2.2
Mëshqerra për therje	1,875	1,810	1,706	1,408	1,370	-2.7
Mëshqerra të mbarësuar për herë të parë	7,045	7,080	6,869	6,428	5,870	-8.7
Lopë qumështore	133,916	132,076	130,493	129,897	126,549	-2.6
Lopë të tjera	1,737	2,037	2,025	1,041	1,027	-1.3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Numri i përgjithshëm i gjedheve në vitin 2024, ishte 240,848 krerë, krahasuar me vitin paraprak kishte rënie për 2.7%. Në vitin 2024, janë therur 113,237 krerë, që ishin 1,691 krerë të therur më pak se viti 2023. Vlera e prodhimit të përgjithshëm të mishit të gjedhit është 65.9 mil. €, për 1.4 mil. €, më e lartë se viti 2023, e kjo kryesisht rezultat i ngritjes së çmimeve, ndërsa vlera e importit është 144.3 mil. €. Shkalla e vetëmjaftueshmërisë është 34.2%, kurse konsumi për kokë banori është 35.7 kg.

Tabela 44: Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2020-2024⁹

	Njësia	2020	2021	2022	2023	2024
Fondi i gjedheve	krerë	261,389	260,528	250,899	247,493	240,848
Lopë qumështore	krerë	133,916	132,076	130,493	129,897	126,549
Totali i therjeve	krerë	116,048	116,204	115,214	114,928	113,237
Totali i prodh. vendor në p.th.	mil. kg p.th.	19.7	19.8	19.7	19.6	19.4
Totali i importeve	mil. kg p.th.	19.8	27.5	35.1	35.1	40.7
Furnizimi në p.th.	mil. kg p.th.	39.6	47.3	54.8	54.7	60.1
Totali i eksporteve	mil. kg p.th.	0.06	0.12	2.38	3.33	3.54
Konsumi	mil. kg p.th.	39.5	47.2	52.4	51.4	56.6
Vlera e prodhimi në p.th.	mil. €	44.3	47.1	57.5	64.5	65.9
Totali i importeve	mil. €	49.4	75.1	114.9	122.4	144.3
Bilanci tregtar	mil. €	-49.2	-74.7	-106.4	-111.1	-130.5
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	49.9	42.0	37.5	38.1	34.2
Konsumi për kokë banori	kg p.th.	22.0	26.6	29.5	28.9	35.7

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR; p.th – peshë e therur

Lopët qumështore edhe për vitin 2024, njëjtë si në vitin 2023, përbëjnë 52.5% të numrit të përgjithshëm të gjedheve. Nga gjithsej sasia e përdorimit vendor, 66% është prodhim vendor dhe pjesa tjetër është mbuluar nga importet. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ me 85.2 mil. €. Konsumi për kokë banori në vitin 2024 ishte 228 kg apo mesatarisht konsumi ditor i qumështit dhe produkteve të qumështit është 0.6 kg në ditë.

Tabela 45: Bilanci i furnizimit për qumështin e lopës dhe produktet e qumështit, 2020-2024¹⁰

	Njësia	2020	2021	2022	2023	2024
Lopë qumështore	krerë	133,916	132,076	130,493	129,897	126,549
Prodhimi i qumështit	t	281,960	278,746	276,058	275,447	268,980
Importi	t (p.e.)	109,976	121,863	128,714	133,579	139,864
Furnizimi	t (p.e.)	391,936	400,610	404,772	409,026	408,844
Eksporti	t (p.e.)	1,075	1,125	1,806	2,025	2,154
Përdorimi vendor	t (p.e.)	390,862	399,485	402,966	407,001	406,690
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	72.1	69.8	68.5	67.7	66.1
Humbjet	t (p.e.)	5,639	5,575	5,521	5,509	5,380
Konsumi për ushqim të viçave në fermë	t (p.e.)	41,448	40,976	40,581	40,491	39,540
Procesimi	t (p.e.)	31,048	32,002	32,426	32,847	33,001
Konsumi njerëzor	t (p.e.)	312,727	320,933	324,438	328,154	328,769
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.33	0.31	0.34	0.42	0.62
Vlera e prodhimit	mil. €	77.5	72.0	78.2	96.4	138.9
Bilanci tregtar	mil. €	-48.3	-55.4	-73.1	-75.6	-85.2
Konsumi për kokë banori	kg (p.e)	191	199	201	203	228

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24); ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZhR; p.e. – ekuivalentët e produktit

⁹ Në këtë tabelë ka vlera që ndryshojnë nga vlerat në raportet e Gjellbëra të kaluara si rezultat i rishikimit të kodeve doganore dhe kefcientëve të konvertimit.

¹⁰ Në këtë tabelë ka vlera që ndryshojnë nga vlerat në raportet e Gjellbëra të kaluara si rezultat i rishikimit të kodeve doganore dhe kefcientëve të konvertimit.

2.4.2 Dhentë dhe dhinë

Fondi i dhenëve në vitin 2024 ishte 209,947 krerë, me një rritje prej 1.4% (2,824 krerë). Rritje kishte tek të gjitha kategoritë e dhenëve, ku rritjen më të lartë e kishte kategoria: “Dele të mbarësuar për herë të parë” me 4.6% (1,095 krerë), dhe kategoria “Desh për riprodhim” me 2.5% (223 krerë). Kategoritë tjera në fondin e dhenëve kanë shënuar rritje nga 0.5% deri në 2%.

Nga fondi i dhenëve pjesa më e madhe përbëhet nga dele të cilat kanë pjellur me 62%, pasuar nga qengja deri në 6 muaj me 16%, delet e mbarësuar për herë të parë përfaqësohen me 12%, qengjat mbi 6 muaj me 6% pjesëmarrje, kurse deshët për riprodhim me 4%.

Tabela 46: Numri i dhenëve, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Fondi i dhenëve	212,131	211,354	204,110	207,123	209,947	1.4
Dele të cilat kanë pjellur (qumështore)	134,289	132,339	128,021	128,695	129,328	0.5
Dele të mbarësuar për herë të parë	24,778	24,327	22,990	24,017	25,112	4.6
Qengja deri në 6 muaj	33,234	33,642	32,830	33,023	33,696	2.0
Qengja mbi 6 muaj	11,277	11,598	11,536	12,627	12,827	1.6
Desh për riprodhim	8,553	9,448	8,733	8,761	8,984	2.5

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Edhe viti 2024, ka vazhduar me trendin e rënies së numrit të përgjithshëm të dhive me 2.6%. Rënia ishte për 715 krerë në fondin e përgjithshëm në raport me vitin e kaluar, ku rënie kishte tek të gjitha kategoritë me përjashtim të kategorisë “Keca deri në 6 muaj”, ku kishte rritje për 0.6%.

Struktura e fondit të dhive dominohet nga dhi të cilat kanë pjellur me 60%, pasur nga dhi të mbarësuar për herë të parë me 14%, kecat deri në 6 muaj dhe ata mbi 6 muaj përfaqësohen me nga 10% secila, ndërsa kategoria cjep për riprodhim merr pjesë me 7% në strukturën e fondit të përgjithshëm të dhive.

Tabela 47: Numri i dhive, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Fondi i dhive	29,557	30,039	29,378	27,912	27,197	-2.6
Dhi të cilat kanë pjellur (qumështore)	17,830	18,008	17,622	16,775	16,192	-3.5
Dhi të mbarësuar për herë të parë	4,077	4,226	4,041	3,828	3,823	-0.1
Keca deri në 6 muaj	2,603	3,078	3,047	2,589	2,605	0.6
Keca mbi 6 muaj	2,740	2,389	2,330	2,640	2,589	-1.9
Cjep për prodhim	2,307	2,338	2,338	2,080	1,988	-4.4

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

2.4.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës

Fondi i derrave në vitin 2024, pas një rënies të vazhdueshme në vitet e fundit shënoi një rritje për 0.9%, në krahasim me vitin paraprak, rritje për 396 krerë. Kjo rritje i atribuohet rritjes së

kategorisë së derrave për majmëri 80-109 kg me 4% (163 krerë), rritjes së kategorisë derra për majmëri me 51-79 kg për 5.2% (162 krerë), rritje kishte edhe te dosat e mbarësuara për herë të parë me 4.4% (122 krerë). Ndërsa rritje të numrit të krerëve kishte edhe te kategoritë: harça për riprodhim me 116 krerë (5.7%), derra për majmëri 110 kg e më shumë me 90 krerë (1.9%), gica nën 20 kg me 57 krerë (0.6%), dosa të tjera me 42 krerë (2.5%), si dhe dosa të pambarësuara me 26 krerë (2.2%). Rënien më të madhe e kishte kategoria derra 20-50 kg me 320 krerë, apo për 4.8% më pak, kurse kategoria tjetër që kishte rënie ishte dosa që kanë pjellë, me 62 krerë rënie (0.8%).

Struktura e fondit të derrave përbëhet nga gicat me peshë nën 20 kg me 23%, pasuar nga dosat që kanë pjellë me 17%, derrat 20-50 kg me 15%, derrat për majmëri nga 110 kg e më shumë me 11%, kategoritë e tjera kishin pjesëmarrje nën 10%, që të gjitha marrë së bashku përfaqësohen me 26%. Sa i përket strukturës së dosave, pjesa më e madhe janë dosa që kanë pjellë me 56%, pasuar nga dosat e mbarësuara për herë të parë 22%, dosat e tjera me 13%, si dhe dosat e pambarësuara me 9%. Pjesëmarrja e harçave për riprodhim në fondin e derrave ishte nën 5%.

Tabela 48: Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Fondi i derrave	45,395	47,384	45,420	43,686	44,082	0.9
Gica nën 20 kg	10,954	10,891	10,424	9,986	10,043	0.6
Derra 20-50 kg	7,207	7,453	7,070	6,717	6,397	-4.8
Derra për majmëri 51-79 kg	3,077	3,501	3,422	3,111	3,273	5.2
Derra për majmëri 80-109 kg	4,531	4,667	4,264	4,096	4,259	4.0
Derra për majmëri 110 kg e më shumë	5,479	5,112	5,004	4,725	4,815	1.9
Dosa që kanë pjellë	6,862	7,605	7,428	7,378	7,316	-0.8
Dosa të mbarësuara për herë të parë	2,324	2,751	2,678	2,743	2,865	4.4
Dosa të pambarësuara	2,660	1,363	1,294	1,209	1,235	2.2
Dosa të tjera	919	1,783	1,639	1,685	1,727	2.5
Harça për riprodhim	1,382	2,258	2,197	2,036	2,152	5.7

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Kategoria e kafshëve të njëthundrakëve (Kuaj, Gomar dhe Mushka), ka përfaqësimin më të ulët të kafshëve shtëpiake të fermës, ku dhe ka vazhduar rënien e përfaqësimit gjatë vitit 2024, rënia në krahasim me vitin 2023 ishte për 2.5%, apo për 36 krerë.

Tabela 49: Numri i kafshëve të tjera të fermës, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Njëthundrakë (Kuaj, Gomarë dhe Mushka)	1,804	1,864	1,469	1,413	1,377	-2.5

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

2.4.4 Shpezëtaria

Numri i shpezëve gjatë vitit 2024, tek të gjitha kategoritë e shpezëve shfaq një rritje prej 1.2%, apo 37 mijë krerë më shumë se viti paraprak. Nga numri i përgjithshëm i shpezëve: 96% janë pula me një rritje prej 1.2% të krerëve, 3% janë biba (qura) me rritje prej 2.1% në raport me vitin e kaluar, si dhe shpezë të tjera (rosa, pata etj.), me përfaqësim prej 1% në të gjitha kategoritë e shpezëve, ku kishte rritje prej 3.7% të krerëve.

Te pulat rritje kishte mbi 34 mijë krerë, ku rritjen më të madhe e kishte kategoria pula për vezë me mbi 19 mijë krerë, pasuar nga zogjtë brojler me mbi 10 mijë krerë, si dhe kategoritë gjela dhe pula të tjera me mbi 4 mijë krerë rritje. Ndërsa, bibat dhe shpezët e tjera përbëjnë 4% të gjithë numrit të shpezëve, ku rritja ishte mbi 3 mijë krerë krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 50: Numri i shpezëve 2020-2024, në '000

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Shpezë	2,782	2,788	2,614	2,997	3,034	1.2
Pula	2,637	2,643	2,482	2,873	2,907	1.2
Zogj, brojler (deri në 3 muaj)	384	346	323	1,001	1,012	1.0
Pula për vezë	1,939	1,996	1,886	1,610	1,629	1.2
Gjela	290	284	257	250	254	1.6
Pula të tjera (mbi 3 muaj)	25	17	16	12	12	4.6
Biba (qura)	75	94	86	82	84	2.1
Zogj bibe (deri në 3 muaj)	14	27	25	24	25	4.4
Biba (qura) për vezë	42	42	39	37	37	0.6
Bibana (qurana)	18	22	20	18	18	1.5
Të tjera (mbi 3 muaj)	1	4	3	3	3	5.0
Shpezë të tjera (rosa, pata etj)	70	52	46	42	44	3.7

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Në vitin 2024, vazhdon të shfaqet një trend rritës i prodhimit të vezëve prej 4.2%, prodhimtari e cila vlerësohet të jetë 386.8 mil. vezë. Në vitin 2024 janë importuar 2.4 milion vezë, ku kishte rënie prej 6.3%, krahasuar me vitin paraprak. Nga importi i përgjithshëm i vezëve, 68% janë importe nga Maqedonia e Veriut, 13% nga Bullgaria, 10% nga Shqipëria, 4% nga Gjermania, si dhe pjesa tjetër prej 5% janë importe nga shtete të tjera Evropiane. Konsumi i vezëve për kokë banori llogaritet të jetë mesatarisht 245 vezë në vit.

Tabela 51: Prodhimtaria e vezëve, 2020-2024, në '000 copë

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Vezë	365,554	423,640	363,031	371,149	386,784	4.2

Burimi: MBPZhR – DAESB

Vitin 2024 e përcjell prodhimin e mishit të pulës me një rënie prej 4.3% (192 tonë), në krahasim me vitin paraprak. Eksporti i mishit të pulës ishte i ulët prej 14 tonë, me vlerë 27 mijë €, nga ku 70% ishte i destinuar në Shqipëri, kurse pjesa tjetër prej 30% ishte eksport në Maqedoninë e

Veriut. Importet e mishit të pulës ishin 38,268 tonë, me vlerë 68.9 mil. €, nga sasia e përgjithshme kishte importe nga vende të ndryshme, nga ku: 32% ishin importe nga Brazili, 15% Polonia, 15% ShBA, 9% Mbretëria e Bashkuar, 5% Sllovenia si dhe 24% ishin import nga vendet tjera. Konsumi mesatar për kokë banori i mishit të pulës në vend në vitin 2024, vlerësohet të jetë 26.8 kg/vit, nga ku shkalla e vetëmjaftueshmërisë ishte 10%.

2.4.5 Bletaria

Në vitin 2024 numri i koshereve të bletëve shënoi rritje për 6.2%, për 13,044 koshere më shumë se viti paraprak. Përmes programit të pagesave direkte, në vitin 2024 janë mbështetur 208,633 koshere (94% e gjithë fondit), nga gjithsej 221,922. Kurse numri i koshereve të mbështetura ishte për 11% më i lartë se në vitin 2023.

Tabela 52: Numri i koshereve të bletëve, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Koshere bletësh	262,541	219,077	196,122	208,878	221,922	6.2

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('20, '21, '22, '23, '24)

Pavarësisht rritjes së mbështetjes dhe numrit të koshereve, prodhimtaria e mjaltit shënoi rënie për 129.6 tonë (6.8%), si pasojë e kushteve të ndryshueshme klimatike dhe dëmtuesve të ndryshëm që ndikuan në rendiment me rënie për 12.3%.

Eksporti i mjaltit ishte në sasi të vogla prej 135 kg, me vlerë mbi 5 mijë €, ku 78% ishte i eksportuar në ShBA dhe 22% në Zvicër. Importi i përgjithshëm i mjaltit ishte 216.5 tonë, me vlerë 1.38 mil. €. Nga gjithsej sasia e importuar, 35% ishte nga Maqedonia e Veriut, 25% nga Turqia, 16% nga Kroacia dhe pjesa tjetër prej 24% ishte import nga shtete të ndryshme. Konsumi vendor rezulton të jetë rreth 1.3 kg për kokë banori, kurse prodhimi vendor plotëson 89% të nevojave për konsum, ndërsa pjesa tjetër plotësohet nga importi.

Tabela 53: Prodhimi i mjaltit në tonë, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023 në %
Mjaltë	788	1,643	1,765	1,905	1,775	-6.8

Burimi: MBPZhR – DAESB ('20,'21); ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('22,'23,'24)

2.4.6 Peshkataria dhe Akuakultura

Peshkataria dhe akuakultura në Kosovë është e rregulluar me Ligjin 02/L-85, ku lejet për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit i lëshon Federata sipas procedurave të përcaktuara nga ministria. Aktivitetin e akuakulturës mund ta zhvillojnë personat fizik apo juridik të regjistruar dhe të licencuar për akuakulturë, si dhe shfrytëzuesit e resurseve ujore nëse një gjë e tillë është planifikuar me program në regionin apo zonën për të cilën e kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit.

Të dhënat tregojnë një rritje të vazhdueshme të numrit të lejeve të peshkimit nga viti 2022 deri në vitin 2024, duke u rritur nga 2,581 në 3,270 leje, ku jep të kuptohet për një interes gjithnjë në rritje për aktivitetin e peshkimit. Megjithatë, sasia e peshkut të kapur të raportuar nuk ndjek të njëjtin trend, pas një niveli prej 10 tonësh në vitin 2022, sasi e peshkut të kapur gjatë vitit 2023, kishte rënie me 22.6% në raport me vitin 2022, kurse viti 2024 kishte ngritje prej 14.9% të sasisë të peshkut të kapur.

Tabela 54: Numri i lejeve të peshkimit dhe sasia e peshkut, 2022-2024

Viti	Numri i lejeve të peshkimit	Sasia e peshkut të kapur të raportuar (ton)
2022	2,581	10.00
2023	2,802	7.74
2024	3,270	9.10

Burimi: MBPZhR – DPBT

3 Pylltaria

Jeta siç e njohim sot nuk do të ekzistonte pa pyjet, pyjet janë pjesë thelbësore e ekosistemit të planetit tonë, prandaj është e domosdoshme t'i mbrojmë ato. Vendi ynë mbështetet në produktet dhe shërbimet që ofrojnë ekosistemet pyjore. Andaj, ne duhet të garantojmë përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve përveç mbrojtjes së tyre, përdorimin e pyjeve në mënyrë dhe me ritëm që ruan biodiversitetin, produktivitetin, aftësinë për rigjenerim, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur rolet përkatëse ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal dhe kombëtar në harmoni me ekosistemet e tjera.

Pyjet e Kosovës përbëjnë një nga burimet natyrore më të rëndësishme, jo vetëm për ruajtjen e biodiversitetit, por edhe për stabilitetin klimatik dhe zhvillimin rural. Ndërsa, me Ligjin për Pyje me Nr. 08/L-137, konsiderohen resurse kombëtare me interes të përgjithshëm. Sipas inventarizimit kombëtar, sipërfaqja pyjore është rreth 481,000 ha, që përfaqëson afërsisht 44.7% të territorit të Kosovës. Një pjesë prej 62% është në pronësi publike, ndërsa 38% në pronësi private. Pyjet e Kosovës janë të ndara në pyje të larta, pyje të ulëta, cungishte dhe pyje me pyllëzim. Pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës e përbëjnë pyjet e ulëta (cungishte) 82%, pasuar nga pyjet e larta (me farëzim natyral) 15%, si dhe pjesën tjetër e përbëjnë cungishte – standarde dhe pyjet me pyllëzim (farëzim artificial).

Spektori pyjor luan një rol vendimtar në tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër, të qëndrueshme dhe në ofrimin e punësimit dhe zhvillimit rural. Spektori pyjor i Kosovës luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit edhe nëpërmjet mbledhjes, grumbullimit, shfrytëzimit të qëndrueshëm të Produkteve Pyjore jo Drunore (PPJD), si frutave pyjore, bimëve mjekuese, kërpudhave, farërave dhe prodhimeve tjera, ku përfshijnë një gamë të gjerë bimësh që kanë vlerë ushqimore, mjekësore, aromatike dhe ekonomike, me kushtin që nuk rrezikohet ripërtëritja dhe nuk u shkaktohen dëme pyjeve, të cilat i kontribuojnë mirëqenies dhe punësimit të komunitetit.

Politikat pyjore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni që përpilon politikat, strategjitë dhe rregulloret për pyjet nëpërmjet Departamentit të Pylltarisë. Politikat pyjore dhe menaxhimi i informatave me pyje sipas ligjit bëhet me Strategji Kombëtare për Pylltari, Inventarizim Kombëtar të Pyjeve, Kadastër të pyjeve dhe tokës pyjore, si dhe Sistem Informativ për Pyjet e Kosovës.

Strategjitë

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Pylltarisë është dokument planifikues afatgjatë strategjik me të cilin përcaktohen drejtimet e zhvillimit të sektorit të pylltarisë në nivel kombëtar. Strategjia është në përputhje me politikat dhe dokumentet strategjike të Republikës së Kosovës dhe të BE-së për pylltari. Në fund të vitit 2021, është miratuar Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030, si dhe Plani i Veprimt për zbatimin e saj.

Synimi kryesor i strategjisë është të ruajë, të zgjerojë dhe të sigurojë menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore të Kosovës, me qëllim që të kontribuojnë në ekonominë kombëtare. Strategjia i ka pesë objektiva:

- Përmirësimi i gjendjes së resurseve pyjore;
- Mbrojtja e resurseve pyjore;
- Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i resurseve pyjore;
- Zhvillimi i kapaciteteve të sektorit të pylltarisë;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i komunikimit.

Legjislacioni

Pyjet e Kosovës përbëjnë një prej resurseve kryesore të vendit, duke luajtur rolin kryesor në ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjes së tokës nga erozioni, ruajtjen e ujërave dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve vendi në vitin 2023, ka miratuar Ligjin për Pyje me Nr. 08/L-137, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore si resurse me interes të përgjithshëm.

Ligji u bazua në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, konservimit të shumëllojshmërisë biologjike, afirmimin e masave paraprake dhe parandaluese për mbrojtjen e pyjeve dhe ruajtjen e mjedisit. Ligji rregullon: planifikimin, mbrojtjen, silvikulturën, shfrytëzimin e produkteve drunore dhe jo drunore, pronësinë, shpronësimin, përgjegjësinë organizative dhe detyrat e institucioneve pyjore, financimin publik, hulumtimet në pylltari, mbikëqyrjen, inspektimin dhe sanksionet.

Gjatë vitit 2024, është miratuar ligji me Nr. 08/L-262, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin Nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative.

Sipas gazetës zyrtare të Kosovës, gjatë vitit 2024, janë nxjerr edhe tri akte nënligjore për pylltari bazuar në ligjin bazë e të cilat janë: Udhëzimi administrativ (MBPZhR) - Nr. 25/2024, për kadastrin e pyjeve dhe tokës pyjore, Udhëzimi administrativ (MBPZhR) - Nr. 08/2024 për ruajtjen e pyjeve, përgjegjësit dhe obligimet e rojës së pyllit, si dhe udhëzimi administrativ (MBPZhR) - Nr. 07/2024 për sistemin informativ për pyjet e Kosovës.

Menaxhimi me kafshë të egra dhe gjuetia

Menaxhimi i kafshëve të egra dhe gjuetisë në Kosovë, është një nga aspektet më të rëndësishme për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemit natyror të vendit. Menaxhimi me kafshë të egra është i rregulluar me ligjin për gjuetinë, ku dhënia në menaxhim e vend gjuetive të përbashkëta dhe menaxhimi i tyre me Plane Menaxhuese është vjetore dhe 10 vjeçare. Themelimi dhe dhënia në menaxhim e vend gjuetive të përbashkëta, është sfidë me të cilat institucionet janë duke u përballuar në vazhdimësi. Shkaktar janë komunat të cilat duhet të ndërmarrin hapa në

themelim dhe procedimin me dhënien e tyre në menaxhim me qira, ku hezitojnë të ndërmarrin angazhime për të përmbyllur dhe përmbushur kompetencat e tyre.

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit për gjueti, është realizuar gjithashtu dhënia e pëlqimeve për miratimin e Planeve Menaxhuese Afatgjata dhe vjetore të vend gjuetive të përbashkëta. Ku gjatë vitit 2024, është arritur të bëhet themelimi i vend gjuetisë “Canis Lupus” në komunën e Shtërpçës.

Tabela 55: VGJP e themeluara

Vend-gjuetia	Statusi	Komuna	Sipërfaqja në ha
Canis Lupus	Miratuar	Shtërpçë	13,053
Sipërfaqja e vend-gjuetive të themeluara			13,053

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Gjatë vitit 2024, në mbështetje të kërkesave që erdhën nga komunat, komisioni për gjueti zhvilloi aktivitetet për dhënien në menaxhim të vend gjuetive. Në aktivitetet që mund të veçohen janë dhënia në menaxhim e 4 vend gjuetive me një sipërfaqe prej 75,616 ha dhe refuzimin e disa kërkesave për dhënie në menaxhim. Refuzimi për miratim të kërkesave të komunave për dhënien në menaxhim të vend gjuetive të përbashkëta, zakonisht ka ndodhur për shkak se komunat nuk kanë arritur që materialin ofertues ta përgatisin në harmoni me legjislacionin për gjueti në fuqi.

Tabela 56: Dhënia në menaxhim e VGJP

Vend-gjuetia	Statusi	Komuna	Sipërfaqja në ha
Prishtina I	Miratim	Prishtinë	18,853
Prishtina II	Miratim	Prishtinë	7,243
Prishtina III	Miratim	Prishtinë	12,036
Drenica	Miratim	Skenderaj	37,484
Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetive të shqyrtuara për dhënie në menaxhim			75,616

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Përveç hartimit të politikave pyjore dhe themelimit të legjislacionit, një ndër aktivitetet më të rëndësishme të Departamentit të Pyjeve në kuadër të MBPZhR-së, është miratimi i Planeve Menaxhuese Afatgjata (PMA), përmes të cilave menaxhuesit e vend gjuetive marrin angazhime për menaxhimin e mirëfilltë të kultivimit, mbrojtjes, zhvillimit të fondit dhe gjuetisë me kafshë të egra. Mbi këtë bazë janë shqyrtuar 7 kërkesa të komunave për miratimin e PMA-ve, me një sipërfaqe prej 148,302 ha.

Tabela 57: Planet menaxhuese afatgjata për periudhën 2024-2034

Vend-gjuetia	Statusi	Komuna	Sipërfaqja në ha
Mokna	Miratuar	Istog	40,323
Prishtina I	Miratuar	Prishtinë	18,853
Prishtina II	Miratuar	Prishtinë	7,243
Prishtina III	Miratuar	Prishtinë	12,036
Drenica	Miratuar	Skenderaj	37,484
Çyçavica	Miratuar	Vushtrri	12,878
Shala	Miratuar	Vushtrri	19,485
Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetive të mbuluar me PMA			148,302

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Të dhënat raportojnë për planet vjetore të gjuetisë për 17 komuna, ku të gjitha vend gjuetisë kanë statusin e "Miratuar", që do të thotë se janë të legalizuara dhe të rregulluara për aktivitetet e gjuetisë në kuadër të legjislacionit dhe politikave të menaxhimit të gjuetisë. Vend gjuetisë janë të shpërndara gjerësisht nëpër komunat e Kosovës, duke mbuluar një gamë të gjerë rajonale, përfshirë shumë zona të thella malore.

Këto sipërfaqe të mëdha përfshijnë habitate të pasura me kafshë të egra, si ujku, arinjtë, derrat e egër, dhe shumë lloje të shpendëve. Menaxhimi i këtyre sipërfaqeve është i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit të këtyre llojeve dhe mbrojtjen e ekosistemeve dhe habitateve. Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Vendeve të Gjuetisë është kyç për ruajtjen e këtyre faunave dhe mundësinë e riprodhimit të tyre në kushte të sigurta.

Menaxhimi i këtyre sipërfaqeve kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve shtetërore që të sigurohet që aktivitetet e gjuetisë të jenë të kontrolluara. Sfidat kryesore të evidentuara që ndërlidhen me menaxhimin e këtyre vend gjuetive janë: gjuetia ilegale dhe shkatërrimi i ekosistemeve natyrore nga ndërtimi i infrastrukturës, ndotja dhe shfrytëzimi i tepruar i resurseve. Planet për vend gjueti në komuna të ndryshme japin mundësi shumë të mira të zhvillimit të turizmit dhe gjuetisë, ku përfshirja e banorëve lokalë në aktivitete mund të sjellë dobi ekonomike, rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

Të dhënat e paraqitura japin një pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e gjuetisë, me një total prej 337,054 ha për vend gjuetisë, Kosova ka krijuar një rrjet të menaxhuar të gjerë të habitateve natyrore që janë thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e ekosistemeve të pasura. Është e rëndësishme që të vazhdohet me monitorimin dhe menaxhimin e këtyre sipërfaqeve për të siguruar që aktivitetet e gjuetisë të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me ligjet e ruajtjes së natyrës.

Tabela 58: Planet vjetore për vitin e gjuetisë, 2024-2025

Vend-gjuetia	Statusi	Komuna	Sipërfaqja në ha
Shala	Miratuar	Mitrovicë	26,208
Lipjani lindje	Miratuar	Lipjan	11,677
Karadaku	Miratuar	Gjilan	8,904
Maja e gjelbër	Miratuar	Gjilan	16,680
Zhegoci	Miratuar	Gjilan	15,324
Sharri	Miratuar	Dragash	8,188
Galluasha	Miratuar	Therandë	36,099
Lipjani perëndim	Miratuar	Lipjan	12,146
Kroni i ftohtë	Miratuar	Hani i Elezit	5,821
Qyqavica	Miratuar	Obiliq	10,482
Bjeshka	Miratuar	F. Kosovë	8,438
Lojza	Miratuar	Deçan	8,157
Podguri	Miratuar	Pejë	13,673
Dubocaku	Miratuar	Pejë	13,617
Gračanica	Miratuar	Gračanicë	9,627
Çyçavica	Miratuar	Vushtrri	12,878
Shala	Miratuar	Vushtrri	19,485
Ferizaji	Miratuar	Ferizaj	27,865
Mokna	Miratuar	Istog	40,323
Lypetenei	Miratuar	Kaçanik	18,409
Canis Lupus	Miratuar	Shtërpçë	13,053
Sipërfaqet e vend-gjuetive që menaxhohen me PVM			337,054

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Menaxhimi i pyjeve

Menaxhimi i pyjeve në Kosovë mbështetet te Ligji mbi Pyjet Nr. 08/L-137, ku menaxhimi i pyjeve ushtrohet në mënyrë të qëndrueshme, në përputhje me kriteret ndërkombëtare për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe me udhëzimet operacionale kombëtare. MBPZHR ka kompetenca për rregulloret dhe strategjitë për pyjet. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, menaxhon me parqet kombëtare, por pyjet brenda këtyre parqeve bien edhe nën kompetencat e Agjencisë Pyjore, sipas planeve të menaxhimit.

Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), menaxhon me pyjet publike dhe me marrëveshje edhe ato private. APK bën plane vjetore të menaxhimit të pyjeve, ku hartohen për të gjitha pyjet dhe tokat pyjore, duke u bazuar në programet dhe planet e menaxhimit të pyjeve. Planifikimi i menaxhimit të pyjeve nga APK, është mjaftë mirë i koordinuar dhe ekzekutohet duke përdorur metodologji të caktuar për grumbullimin, analizimin dhe përpunimin e të dhënave dhe informatave për menaxhimin e pyjeve.

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve nga APK-ja, ka për qëllim përcaktimin e balancit në mes të shfrytëzimit ekonomik dhe kapaciteteve rigjeneruese, përdorimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të tyre, komfor nevojës për ruajtjen e potencialit të tyre për të ardhmen.

Planifikimi afatgjatë

Bazuar në Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030, plani i menaxhimit të pyjeve është jetik për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke balancuar dhe ruajtur funksionet ekonomike, ekologjike dhe shoqërore. Sipas Ligjit për Pyje, plani i menaxhimit të pyjeve është dokument afatgjatë planifikues i cili hartohet për dhjetë (10) vite, për njësinë menaxhuese sipas metodologjisë unike, në bazë të inventarizimit në terren të grumbujve pyjor dhe sipërfaqeve të tjera të përfshira në njësinë menaxhuese.

Gjatë vitit 2024, Planet Menaxhuese Afatgjate për Njësitë Menaxhuese janë planifikuar për sipërfaqe prej 133,724.45 ha, të financuar nga buxheti i APK-së. Mirëpo, mjetet financiare në dispozicion sipas buxhetit të këtij viti, dhe bazuar në çmimet e viteve paraprake, nuk kanë qenë të mjaftueshme për realizimin e gjithë sipërfaqes. Prandaj, në vitin 2024, duke parë mundësinë eventuale të ndryshimit të metodologjisë për hartimin e Planeve Menaxhuese Pyjore, përkatësisht në fillim me plane menaxhuese shumëqëllimore pyjore, financiarisht janë realizuar vetëm 20,323.50 ha të sipërfaqes së planifikuar.

Gjithashtu, sipas nenit 27, të Ligjit për Pyje, pika 4, Plan i Menaxhimit me Parqet Kombëtare hartohet nga APK-ja dhe miratohet nga Ministria, me pëlqim të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis. Në bashkëpunim dhe me implementim nga FAO, projekti "Mbështetje në fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor për të përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe për të adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë" janë hartuar tri draft plane për tri Njësi Menaxhuese si pilot njësi për hartimin e Planeve Menaxhuese Shumëqëllimore. Këto Njësi Menaxhuese janë: Novobërda (Novobërdë), Kovaqica (Mitrovicë) dhe Biraqa (Suharekë).

Tabela 59: Planifikimi për hartimin e PM

Njësia menaxhuese	Komuna	Sipërfaqja në ha	Realizimi
Turiqicë	Podujevë	7,835	
Prishtina II	Prishtinë	2,079	
Prishtina III	Prishtinë	1,558	
Pyjet e Lipjanit	Lipjan	7,170	√
Denkovac II	Leposaviq	4,181	
Qiqavica	Vushtri	2,816	
Kopaunik	Mitrovicë	5,445	
Jarik-Belo Brdo	Leposaviq	6,321	
Mala reka	Leposaviq	1,786	
Stolovi	Zveçan	3,443	
Koxha Ballkan	Prizren	4,665	
Malet e Sharrit	Prizren	1,420	√
Koretniku II	Dragash	1,873	
Koretniku I	Prizren	599	
Bredhiku	Dragash	793	
Koka e ahut	Suharekë	3,346	
Zhegoc	Ferizaj	1,341	√
Dermjak-Mollopolc	Shtime	1,495	√
Topillë-Devetak	Shtime	2,744	
Verbeshticë-Kashtanjevë	Shtërpçë	5,514	
Zhegoc	Gjilan	5,329	
Ranillug	Ranillug	4,258	√
V.Vrh-K.reka	Kamenicë	4,158	
Shavarinka	Kamenicë	4,703	√
Ruselija	Pejë	3,625	
Zhlep	Pejë	5,250	
Kopranik	Pejë	6,252	
Hajla	Pejë	7,263	
Pleqe - Qeli	Pejë	1,835	
Pyjet e Strellcit	Deçan	1,023	
Kozhnjer - Roshkodol	Deçan	4,129	
Lloqan - Deçan	Deçan	2,934	
Maja - Gllava	Gjakovë	827	
Pashtriku II	Gjakovë	5,042	
Pyjet e Junikut	Junik	3,444	
Lugu i Butë	Istog	5,058	
Blinaja	VGJRV-DMKE	2,172	
Gjithsej		133,725	20,324

Burimi: APK

Planifikimi vjetor

Menaxhimi i qëndrueshëm me pyjet është një nga komponentët më të rëndësishëm të ruajtjes së ambientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore. Parë nga ky këndvështrim planifikimi vjetor i menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore, Agjencia e Pyjeve të Kosovës harton një dokument “Plani vjetor i menaxhimit me pyje”, me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e resurseve pyjore. Planifikimi vjetor përmbledh të gjitha aktivitetet dhe masat e trajtimit të pyjeve si: sasinë, vendin, dinamikën e prerjeve, punimet mbi mbrojtjen e pyjeve, pyllëzimet, silvikulturën, prodhimtarinë e materialit riprodhues pyjor, shfrytëzimin e pyllit, duke përfshirë ndërtimin e infrastrukturës pyjore si dhe mjetet financiare të nevojshme për realizimin e punëve.

Në bazë të ligjit për pyje, pjesë përbërëse e planit vjetor për menaxhim të pyjeve janë: planet operacionale për menaxhim të pyjeve, planet për pyllëzim dhe projektet për shfrytëzimin e produkteve jo drunore. Plani vjetor i menaxhimit të pyjeve është në harmoni me planin menaxhues të pyjeve dhe me programin për menaxhimin e pyjeve private. Plani vjetor i menaxhimit të pyjeve mund të ndryshojë në rast të fatkeqësive natyrore apo në ndonjë rrethanë tjetër të pafavorshme, duke përcjellë rekomandimet e inspektoratit pyjor.

Pyjet shtetërore

Vëllimi i prerjeve në nivel vendi planifikohet në bazë të inventarizimit të pyjeve, planeve menaxhuese pyjore afatgjata dhe gjendjes faktike në terren, bazuar në strategjinë e zhvillimit të pyjeve. Në këtë vit, APK-ja ka hartuar bazë të ngastrave dhe nën-ngastrave për njësit menaxhuese pyjore të cilat janë në fuqi, ndërsa për pyjet tjera që janë në mungesë të Planeve Menaxhuese Pyjore afatgjata janë bazuar në gjendjen faktike në terren ku është bërë zgjedhje dhe damkimi i drurëve për prerje.

Plani vjetor parasheh realizimin e aktiviteteve të ndryshme silvikulturore si: sasinë, vendin, dinamikën e prerjeve, punimet mbi mbrojtjen e pyjeve, pyllëzimet, prodhimtarinë e materialit riprodhues pyjor dhe shfrytëzimin e pyllit të rreth 62,909 m³ masë drunore bruto.

Tabela 60: Plan i prerjeve në pyjet shtetërore

Asortimentet	Vëllimi m ³
Dru teknik	10,096
Dru zjarri	47,304
Vëllimi neto¹¹	59,493
Mbetje pyjore	3,416
Vëllimi bruto	62,909

Burimi: APK

¹¹ Vëllimi neto - përfaqëson vëllimin dru teknik dhe dru zjarri, duke hequr 3,416 m³ nga vëllimi total prej 62,909 m³.

Të dhënat tregojnë një realizim të ulët të planit të prerjeve në pyjet shtetërore për të gjitha kategoritë e asortimenteve. Realizimi i prerjeve për dru teknik ka arritur 42% të planit të parashikuar, ndërsa kategoria dru zjarri, që përbën pjesën më të madhe të volumit të planifikuar, është realizuar vetëm 31% e planifikimit, duke treguar vështirësi të mëdha në shfrytëzim ose menaxhim operacional. Mbetjet pyjore kanë realizimin më të ulët me vetëm 0.1%, me gjasë janë mbledhur shumë pak ose nuk janë mbledhur fare.

Realizimi i përgjithshëm prej vetëm 31% e planit tregon një mospërputhje të theksuar midis objektivave të vendosura dhe kapaciteteve reale të zbatimit, sfidat janë të shumta dhe ndikimi i tyre është rrënjësor në përmbushjen e planit. Këto mos përmbushje të planeve vijnë nga prerjet e parregullta, mungesa e stafit profesional dhe teknik, buxheti i pamjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, mungesa e investimeve në infrastrukturë dhe zhvillim të kapaciteteve logjistike.

Tabela 61: Realizimi i planit të prerjeve në pyjet shtetërore

Asortimentet	Plani m ³	Realizimi m ³	Realizimi i planit %
Dru teknik	10,096	4,149	42
Dru zjarri	47,304	14,446	31
Mbetje pyjore	3,417	4	0.1
Gjithsej	60,817	18,599	31

Burimi: APK

Pyjet private

Ligji për pyjet Nr. 08/L-137, i konsideron resurse kombëtare edhe pyjet dhe tokat pyjore në pronësi të personit fizik apo juridik, ku edhe pyjet private menaxhohen në harmoni me programin për menaxhimin e pyjeve. Programin për menaxhimin e pyjeve e harton subjekti i licencuar ose Agjencia në emër të pronarit ose Asociacionit të Pyjeve Private. Programin për menaxhimin e pyjeve e miraton Agjencia për periudhën pesë (5) deri në dhjetë (10) vjeçare.

Agjencia e Pyjeve në mbështetje të Planit Vjetor të Menaxhimit të Pyjeve për vitin 2024, bën rregullimin e pyjeve edhe në pronësi private, ku plani i punëve teknike profesionale, zbatohet me kujdes duke pasur parasysh se edhe këto resurse janë pjesë e resurseve kombëtare pyjore. Agjencia dhe pronarët e pyjeve private janë të obliguar që të monitorojnë gjendjen e shëndetit të pyjeve dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve që rrezikojnë pyjet.

Tabela 62: Plani i kultivimit dhe shfrytëzimi i pyjeve private

	Njësia	Gjithsej
Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	ha	105
Përtëritja e pyjeve - meliorim	ha	107
Kultivimi i pyjeve	ha	1,410
Shfrytëzimi i pyjeve	ha	5,409
Punët tekniko-profesionale		
Kërkesa të parashtruara	copë	4,700
Planifikimi i prerjeve në pyjet private	m ³	168,130
Dru zjarri	m ³	147,340
Dru teknik	m ³	20,790

Burimi: APK

APK-ja në planin për pyjet private parasheh aktivitete në ngritje të pyjeve të reja me pyllëzime 105 ha, kultivimin e pyjeve në rreth 1,409 ha, shfrytëzimin pyjeve prej 5,409 ha, pranim të kërkesave për trajtim të pyjeve të rreth 4,700 copë të parashtruara nga pronarët e pyjeve dhe prerjen e një vëllimi drunor rreth 168,130 m³, ku dru zjarri janë 147,340 m³, kurse ato teknike 20,790 m³, me qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre për dru për djegie dhe industri. Planifikimi i aktiviteteve në pyjet private është bërë në kuadër të kërkesave të parashtruara nga pronarët e pyjeve lidhur me koordinimin e tyre për kryerje të shërbimeve nga Agjencia.

Tabela 63: Të dhënat e aktiviteteve në pyje private

Realizimi në kultivimin e pyjeve	Njësia	Plani	Realizimi	Realizimi %
Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	ha	60	-	-
Përtëritja e pyjeve - meliorim	ha	-	-	-
Kultivimi i pyjeve	ha	1,410	-	-
Shfrytëzimi i pyjeve	ha	2,783	1,086	39

Burimi: APK

Sipas të dhënave të planit vjetor për vitin 2024 dhe raportit të përmbushjes së aktiviteteve në pyjet private, rrjedh se kemi realizim të pjesshëm të aktiviteteve në pyjet private, ku pyllëzime të reja dhe meliorime nuk kishte fare, ndërsa kultivimi i pyjeve, megjithëse i planifikuar në një sipërfaqe të konsiderueshme, nuk ka të dhëna të realizimit. Shfrytëzimi i pyjeve paraqitet me 1,086 ha të realizuara, nga 2,783 ha të planifikuara, që përbën vetëm 39% të planifikimit. Aktivitetet e menaxhimit të pyjeve private janë larg objektivave të planifikimit, duke paraqitur nevojën për përmirësime duke filluar nga organizimi i aktiviteteve deri te zbatimi i tyre.

Tabela 64: Punët tekniko-profesionale

	Njësia	Plani	Realizimi	Realizimi %
Kërkesa të parashtruara	copë	4,700	1,677	36
Dru Zjarri	m ³	147,340	100,108	68
Dru Teknik	m ³	20,790	9,653	46
Realizim i prerjeve në pyjet private	m ³	168,130	73,160	44

Burimi: APK

Sipas të dhënave të APK-së për punët tekniko-profesionale, janë realizuar rreth 36% apo 1,677 kërkesa të parashtruara nga pronarët apo ekonomitë familjare. Të dhënat paraqesin se kemi planifikim të rreth 168,130 m³ lëndë të prerjeve drunore dhe realizim prej 73,160 m³, e që përfaqëson 44% të vëllimit të planifikuar të prerjeve në pyjet private.

Tabela 65: Shërbimet mbështetëse teknike

	Njësia	Plani	Realizimi	Realizimi në %
Fletë dërgesa e dhëna	copë	-	13,016	-
Kontrolle profesionale	raste	270	161	60
Dru jashtë pyllit	m ³	5,360	2,792.4	52

Burimi: APK

Nga APK-ja janë lëshuar 13,016 fletë dërgesa apo fletë përcjellëse për transportin e prerjeve nga pyjet private. Ku kontrollet profesionale janë realizuar në masë prej 60% të planifikimit, një angazhim i ulët nga planet fillestare dhe ku nevojiten kontrolle më të shpeshta në terren. Menaxhimi me shërbimet mbështetëse teknike i druve jashtë pyllit ka arritur realizimin në nivelin 52% të planit të punës.

Mbrojtja e pyjeve

Ligji për pyjet Nr. 08/L-137, kapitulli i V, rregullon mbrojtjen e pyjeve me nenet për: aktivitetet e ndaluara, mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit, mbrojtjen e pyjeve nga zjarri dhe zbatimin e sistemeve për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, mbrojtjen e pyjeve nga ndotja, sanimi i pyjeve të dëmtuara, ruajtja e pyjeve, të drejtat dhe kufizimet për qasje të publikut në pyje, kullotja në pyje, baraspesha biologjike e pyllit dhe kafshëve të egra, mbrojtja e llojeve pyjore të rralla dhe të rrezikuara, menaxhimi i pyjeve brenda zonave të mbrojtura dhe atyre të konservuara si dhe rrjedhat e ujërave në pyje.

Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030, ka si objektiv strategjik mbrojtjen e resurseve pyjore nga faktorët biotikë dhe abiotikë, ku do të mbrohet biodiversiteti dhe do të ruhen funksionet mbrojtëse të pyjeve. APK-ja dhe i gjithë sektori i pyjeve ballafaqohet me sfidën dhe problemin kryesor të prerjeve të drunjëve dhe aktivitetëve tjera ilegale në pyjet dhe tokat pyjore. APK ka ndërmarr një sërë aktivitetesh në mbrojtjen e pyjeve dhe tokave pyjore, prej bashkëpunimit dhe koordinimi me institucione brenda sektorit me qëllim të monitorimit dhe kontrollit të pyjeve, shfrytëzimit të tyre sipas destinimit, regjistrimin e terreneve pyjore për kontroll dhe regjistrimin e dëmeve, uzurpimet, aktivitete në mbrojtje të shëndetit të pyjeve dhe rreziqet potenciale nga sëmundjet, dëmtuesit, si dhe faktorët abiotikë.

Sipas të dhënave të APK-së, raportohet se janë ngritur rreth 893 kallëzime nga të cilat 177 penale dhe 716 kundërvajtje. Sasia e materialit drusor të raportuar si dëm pyjor është llogaritur të jetë rreth 16,792 m³, në vlerë rreth 265,598 €.

Tabela 66: Numri i kallëzimeve kundërvajtje dhe penale

Kallëzimet	Copë	m ³	Vlera në €
Kundërvajtje	716	11,632	150,393
Penale	177	5,160	115,206
Gjithsej	893	16,792	265,599

Burimi: APK

Gjatë vitit 2024, janë konfiskuar 1,194 m³ lëndë drusore nga e cila janë shitur 361 m³, ndërsa gjendja e tanishme e stoqeve të vitit 2024, arrijnë sasinë prej 1,898 m³.

Tabela 67: Lënda drunore

Lënda drunore	m ³
Stoqet nga viti 2023	1,065
Sasia e drunore e konfiskuar 2024	1,194
Sasia e shitur	361
Gjendja e tanishme e stoqeve	1,898
Shpërndarja/Memorandum bashkëpunimi	0

Burimi: APK

Zjarret në pyje

Me ligjin për pyje, mbrojtja dhe planet e mbrojtjes nga zjarri zbatohen nga APK-ja. APK në bashkëpunim me institucionet kompetente për mbrojtje nga zjarri, siguron parandalimin dhe monitorimin e zjarreve pyjore. Marrë parasysh shkallën e paraqitjes së zjarreve viteve të fundit, rreziqet dhe dëmet e shkaktuara nga to, APK-ja ka ndërmarr veprime të cilat ndikojnë në pengimin e paraqitjeve të zjarreve dhe në rast të paraqitjes së tyre merren veprime të menjëhershme për zvogëlimin e dëmeve. Një ndër shkaqet e paraqitjes së zjarreve është edhe efekti gjithnjë e më i theksuar i ndryshimeve klimatike.

Krahasuar me vitin 2023, vërehet se kemi një rritje shumë të lartë të numrit të zjarreve dhe sipërfaqeve të përfshirjes nga zjarri. Në vitin 2024, janë evidentuar 86 vatra zjarri nga të cilat 22 ishin në rajonin e Gjiçanit, 20 në atë të Prizrenit, 19 në rajonin e Prishtinës, 14 në atë të Ferizait, 8 në Mitrovicë dhe 3 raste ishin në rajonin e Pejës. Zjarret në pyje shtetërore janë në sipërfaqe gjithsej 770 ha, kurse në toka pyjore (shkurre, djerrina) janë gjithsej 2,704 ha. Ndërsa, zjarret në pyje private ishin: në pyje 119 ha, kurse në toka pyjore (shkurre, djerrina) 126 ha.

Tabela 68: Të dhënat për zjarret në pyje, 2024

Rajonet	Nr. rasteve	Sipërfaqja në ha		Gjithsej ha
		Publike	Private	
Prishtinë	19	2,528	7	2,535
Mitrovicë	8	96	71	166
Pejë	3	500	0	500
Prizren	20	250	43	293
Ferizaj	14	22	33	55
Gjilan	22	78	92	170
Gjithsej	86	3,474	245	3,719

Burimi: APK

Prodhimi i fidanëve

Nga institucionet përgjegjëse është bërë prodhimi i fidanëve pyjore të llojeve Halore dhe Fletore për pyllëzimet në kuadër të Programit për Pyllëzime dhe Ripyllëzime bioindikative. Gjatë vitit 2024, numri total i fidanëve të prodhuara klasike dhe atyre industriale arriti në gjithsej 1,002,000 copë.

Tabela 69: Prodhimi i fidanëve

Lloji	Kultivimi	Numri i fidaneve
Halorë	Klasik	348,500
Halorë	Industrial	553,500
Fletorë	Klasik	100,000
Fletorë	Industrial	-
Gjithsej		1,002,000

Burimi: APK

Pyllëzimet

Krijimi i pyjeve të reja është një nga aktivitetet më komplekse në pylltari. Faktorët siç janë zgjedhja e lokacionit, karakteristikat e tokës, klima, materiali për mbjellje, teknikat e mbjelljes dhe koha e përshtatshme, duhet të merren parasysh gjatë procesit të pyllëzimit. Ngritja e pyjeve të reja, përveç që lidhet me rritjen e fondit pyjor, gjithashtu kontribuon edhe në ekosistem.

Nga Programi Kombëtar për Pyllëzime dhe Ripyllëzime është bërë planifikimi vjetor për realizimin e pyllëzimeve për vitin 2024, ku parashihet realizimi i aktiviteteve të pyllëzimit në kuadër të buxhetit të APK-së. Sipas të dhënave me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të pyllëzimeve është planifikuar të realizohet pyllëzimi i tokave pyjore në sipërfaqe 100 ha, me gjithsej 250,075 fidanë, me shtrirje në të gjitha rajonet e Kosovës.

Tabela 70: Plani i pyllëzimeve

Fidanet	Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	DMKE	Gjithsej
Halor	25,000	37,500	50,000	11,850	50,000	37,500		211,850
Fletor	-	-	-	38,225	-	-	-	38,225
Gjithsej fidanë	25,000	37,500	50,000	50,075	50,000	37,500	-	250,075
Plani ha	10	15	20	20.03	20	15	-	100

Burimi: APK

Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve

APK-ja harton planin e të hyrave për financimin e aktiviteteve të planifikuara vjetore. Bazuar në planin e të hyrave për vitin 2024, kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyra në vlerë prej 3 mil. €, nga ku 66% kanë qenë të hyra të planifikuara nga aktivitete në pyje si: shitje nga shfrytëzimi i pyjeve me tender, shitje nga shfrytëzimi i pyjeve për ekonomi familjare dhe shërbimet në pyjet private, kurse 34% nga aktivitetet si: konfiskimet e drurit, dhënia e tokave me qira dhe aktivitetet tjera që ishin shuma simbolike.

Tabela 71: Plani i të hyrave

	Shuma në €	% e pjesëmarrjes
Shitje nga shfrytëzimi i pyjeve me tender	1,327,015	43.8
Shitje nga shfrytëzimi i pyjeve për ekonomi familjare	296,715	9.8
Shërbimet në pyjet private	366,850	12.1
Të hyra nga aktivitete në pyje	1,990,580	65.7
Konfiskimet e drurit	60,485	2.0
Dhënia e tokave me qira	970,784	32.3
Tjera	1,700	0.0
Të hyra nga aktivitete tjera	1,032,969	34.3
Plani i të hyrave të përgjithshme 2024	3,023,548	100

Burimi: APK

APK-ja në planin e shpenzimeve për vitin 2024, paraqet një ndarje buxhetore, ku ndër prioritetet kryesor mbetet mbrojtja e pyjeve me 38.9%, pasuar nga hartimi i planeve menaxhuese pyjore me 27.4%, ngritja e pyjeve të reja zë 12.7% të planit të shpenzimeve, duke mbështetur zgjerimin dhe përmirësimin e resurseve pyjore. Kurse trajtimi i pyjeve të reja/rrallimet para tregtare, përfaqësojnë 8.6% të shpenzimeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Shpenzimet për angazhimin e punëtorëve sipas nevojës përfaqësohen me 11% të planit të shpenzimeve, kurse blerja e pajisjeve të reja zë vetëm 1.4% të planifikimit të shpenzimeve. Shpenzimet e planifikuara konsiderohen shumë të vogla karshi nevojës dhe sipërfaqeve të pyjeve dhe tokave pyjore.

Tabela 72: Plani i shpenzimeve

	Kosto në €	%
Në mbrojtje të pyjeve	680,700	38.9
Trajtimi i pyjeve të reja/rrallime para tregtare	150,450	8.6
Hartimi i planet menaxhuese pyjore	479,684	27.4
Ngritja e pyjeve të reja	222,463	12.7
Blerja e pajisjeve	25,525	1.4
Angazhim i punëtorëve sipas nevojave	192,000	11.0
Gjithsej shpenzimet e planifikuara 2024	1,750,822	100

Burimi: APK

Të hyrat në buxhet për vitin 2024, ishin 1.73 mil. €, që përfaqëson 57.2% të të hyrave të planifikuar. Të hyrat dominohen nga kategoria e dhënies së tokave pyjore me qira me 52%, pasuar nga shfrytëzimi i pyjeve publike-shitjeve të drurit me 31%, kategoria pagesa nga shërbimet në pyje përfaqësohet me 12% të hyrave në buxhet, kurse 5% të tjera janë të hyra nga lëshimi i vërtetimeve dhe taksave tjera administrative, si dhe të hyrat tjera nga masa drunore e konfiskuar.

Tabela 73: Të hyrat në buxhet 2024

	Shuma në €	%
Shfrytëzimi i pyjeve publike-shitje druri	540,469	31
Pagesa nga shërbimet në pyje private	213,990	12
Pagesa nga lëshimi i vërtetimeve dhe taksave tjera administrative	34,450	2
Pagesa nga dhënia e tokave pyjore me qira	898,823	52
Të hyrat tjera - masa drusore e konfiskuar	43,808	3
Gjithsej të hyra	1,731,540	100

Burimi: APK

Gjatë vitit 2024, vetëm 5% e gjithsej buxhetit të shpenzuar të APK-së është shpenzuar për hartimin e planeve të menaxhimit, duke zënë peshë të vogël të investimeve në planifikim strategjik krahasuar me shpenzimet operative.

4 Tregtia

4.1 Tregtia e përgjithshme

Nga viti 2020 deri në vitin 2024, eksportet kanë treguar një rritje të vazhdueshme, pothuajse duke u dyfishuar nga 474 mil. € në 941 mil. € me përjashtim të vitit 2023. Rritja më e madhe u regjistrua midis viteve 2020 dhe 2021, me një rritje prej rreth 57.8%. Pas një rënie të lehtë prej 6.2% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, në vitin 2024 eksportet u rikthyen në një trend pozitiv, duke u rritur me 9.1% krahasuar me vitin e kaluar.

Importi gjithashtu paraqitet me rritje të vazhdueshme, nga 3,296.3 mil. €, në 6,370.3 mil. €. Rritja më e madhe vërehet në vitet 2021–2022 për 21.3%. Nëse krahasojmë importin e vitit 2024 me atë të vitit 2023 shfaqet dallimi prej 7.6%. Deficiti është në rritje të vazhdueshme, dhe është duke u thelluar nga viti në vit. Tabela paraqet të dhënat e eksportit dhe importit të përgjithshëm, për periudhën 2020–2024 (për kapitujt 1–98).

Tabela 74: Eksporti-Importi i përgjithshëm, në '000 €

Viti	Eksporti (1-98)	Importi (1-98)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2020	474,960	3,296,324	-2,821,364	14.4
2021	749,720	4,653,050	-3,903,330	16.1
2022	920,405	5,643,604	-4,723,200	16.3
2023	863,142	5,919,009	-5,055,867	14.6
2024	941,508	6,370,372	-5,428,864	14.8

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Tregtia e produkteve bujqësore


Eksporti i produkteve bujqësorë në vitin 2024 paraqitet në vlerë prej 170.8 mil. €, që paraqet rritje për 22.8 mil €, apo 15.4%, krahasuar me vitin 2023. Importi i produkteve bujqësore kishte vlerë 1.39 mld. €, që po ashtu tregon rritje në krahasim të vitit 2023 për 108.4 mil. €, apo rritje për 8.4%. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negative edhe në vitin 2024.

Tabela 75: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €

Viti	Eksporti (1-24)	Importi (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2020	78,076	765,357	-687,281	10.2
2021	92,642	965,569	-872,927	9.6
2022	118,949	1,197,126	-1,078,177	9.9
2023	147,993	1,284,966	-1,136,973	11.5
2024	170,793	1,393,369	-1,222,576	12.3

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Figura 23: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, '000 €




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Gjatë dy viteve të fundit, pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm ka shënuar një tendencë të rritjes. Në vitin 2023, eksportet e produkteve bujqësore (01-24) përbënin 17.1% të totalit të eksportit (01-98), duke regjistruar një rritje prej 1 pikë përqindjeje në vitin 2024.

Sa i përket importit në vitin 2024, rritja e pjesëmarrjes së importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm në krahasim me vitin 2023 ishte vetëm 0.2 pikë përqindje.

Figura 24: Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin dhe importin e përgjithshëm



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore gjatë vitit 2024 kishte vlerë prej 170.8 mil. €. Nga kjo vlerë 103.7 mil. € ishin nga vendet e CEFTA-s, 51.5 mil. € nga vendet e BE-së, dhe pjesa tjetër prej 15.6 mil. € nga vendet e tjera. Vlera e importit (1.39 mld. €) në vitin 2024 është dukshëm më e lartë se sa vlera e eksportit, nga e cila 808.1 mil. € ishte nga vendet e BE-së, nga vendet e CEFTA-s 241.2 mil. €, dhe nga vendet e tjera importi paraqitet në vlerë prej 344 mil. €.

Tabela 76: Eksporti, Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2024 në '000 €


	Vendet e BE-së	CEFTA	Vendet tjera	Gjithsej
Eksport (1-24)	51,530	103,657	15,606	170,793
Import (1-24)	808,144	241,178	344,048	1,393,369
Bilanci tregtar	-756,613	-137,520	-328,442	-1,222,576
Eksporti/Pjesëmarrja në %	30.2	60.7	9.1	100
Importi/Pjesëmarrja në %	58.0	17.3	24.7	100
Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)	6.5	43.0	4.5	12.3

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vlera më e lartë e eksportit sipas grupeve të shteteve në vitin 2024 ishte në vendet e CEFTA-s me 61%, pasuar nga vendet e BE-së me 30% dhe vendet e tjera me 9%. Ndërsa, vlera më e lartë e importit ishte nga grupi i vendeve të BE-së me 58%, pasuar nga vendet e CEFTA-s me 17% dhe vendet tjera me pjesëmarrje prej 25%.

4.2.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve

Figura 25: Eksporti dhe importi sipas grupeve të shteteve 2024



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tregtia me vendet e CEFTA-s

Eksporti në vendet e CEFTA-s në vitin 2024 ishte 103.7 mil. €, që shfaqet me vlerë më të lartë për 17.5% se sa në vitin 2023. Në periudhën 2020-2024, vlera e eksportit në vendet e CEFTA-s ka pasur rritje në vazhdimësi.

Edhe importi duke filluar nga viti 2020 ka pasur rritje deri në vitin 2022, ku shënohet një rritje në vazhdimësi e importit. Ndërsa, në vitin 2024 importi kishte vlerë 241.2 mil. €, që paraqet rënie në krahasim me vitin 2023 për 16.1%.

Tabela 77: Eksporti- Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s, në '000 €


Vitet	Eksporti (1-24)	Importi (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2020	41,135	183,381	-142,246	22.4
2021	51,594	266,571	-214,977	19.4
2022	65,546	314,208	-248,662	20.9
2023	88,213	287,523	-199,310	30.7
2024	103,657	241,178	-137,520	43.0

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja e eksportit në vendet e CEFTA-s për periudhën (2020-2024), ka pasur ulje dhe ngritje, duke filluar prej 52.7% sa ishte në vitin 2020 në 60.7% në vitin 2024.

Pjesëmarrja më e ulët e importit nga vendet e CEFTA-s ishte në vitin 2020 me 24%, duke vazhduar me rritje në vitin 2021, me pjesëmarrje prej 27.6%, që njëherësh paraqitet si pjesëmarrje më e madhe e importit për këto vite. Në vitin 2023 importi kishte pjesëmarrje prej 22.4%, duke vijuar me rënie të ndjeshme në vitin 2024 me pjesëmarrje prej 17.3%.

Figura 26: Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin dhe importin bujqësor



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2024 ka pasur rritje të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore në shtetet e CEFTA-s për 18%, krahasuar me vitin paraprak, rritje më të lartë ka pasur në këto shtete: Maqedoni të Veriut 25%, Shqipëri 22%, Bosnje dhe Hercegovinë 18% dhe Serbi 6%, ndërsa rënie të vlerës së eksportit kishte në Moldavi 23% dhe Mal të Zi 12%.

Importi nga vendet e CEFTA-s ka shënuar rënie për 16%. Në nivel të vendeve rritje për 14% ka pasur importi nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut për 3%. Rënia për 40% e importit ishte nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina me 21%, ndërsa importi nga Moldavia dhe Shqipëria shënuan rënie shumë të vogël.


Tabela 78: Eksporti - Importi i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, në '000 €

Vendet	Eksport			Import		
	2023	2024	Ndryshimi '24/'23, (%)	2023	2024	Ndryshimi '24/'23, (%)
Bosnja. Hercegovina	2,405	2,840	18.1	25,354	20,011	-21.1
Mali i Zi	8,307	7,273	-12.4	5,992	6,844	14.2
Maqedonia e Veriut	21,828	27,179	24.5	87,880	90,839	3.4
Moldavia	130	100	-22.8	984	966	-1.8
Serbia	9,844	10,428	5.9	112,919	68,083	-39.7
Shqipëria	45,699	55,836	22.2	54,393	54,435	0.1
Gjithsej	88,213	103,657	17.5	287,523	241,178	-16.1

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vlerën totale të eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s, pjesëmarrjen më të madhe e kishte Shqipëria me 54% pasuar nga Maqedonia e Veriut me 26%, Serbia me 10%, Mali i Zi me 7% dhe B. Hercegovina me 3%. Pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e importit e kishte Maqedonia e Veriut me 38%, vijuar nga Serbia me 28%, pasuar nga Shqipëria me 23%, B. Hercegovina me 8% dhe Mali i Zi me 3%.

Figura 27: Eksporti dhe importi sipas vendeve të CEFTA-s, 2024



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tregtia me vendet e BE-së

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore me vendet e BE-së gjatë periudhës (2020-2024), paraqitet me rritje të vazhdueshme, në vitin 2024 vlera e eksportit ishte 51.5 mil. €, 11% më e lartë se sa në vitin 2023.

Vlera e importit nga vendet e BE-së në vitin 2024 paraqitet në vlerë prej 808.1 mil. €, e që ishte niveli më i lartë i vlerës së importit për këtë periudhë kohore, me rritje prej 23% në krahasim me vitin paraprak.

Tabela 79: Eksporti - Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së, në '000 €


Viti	Eksport (1-24)	Import (1-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
2020	29,360	404,641	-375,282	7.3
2021	31,711	466,997	-435,286	6.8
2022	41,999	569,137	-527,139	7.4
2023	46,322	658,612	-612,290	7.0
2024	51,530	808,144	-756,613	6.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e BE-së, në eksportin e përgjithshëm për vitin 2024, ishte 30%, që shfaqet një rënie prej 1.1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2023.

Pjesëmarrja më e lartë e importit nga vendet e BE-së për periudhën 2020-2024, ishte në vitin 2024 me 58%, që paraqet rritje të ndjeshme për 7 pikë përqindje në krahasim me vitin 2023.

Figura 28: Pjesëmarrja e BE-së në eksportin dhe importin bujqësor




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së është rritur për 11.2%, në krahasim me vitin paraprak. Rritje më të madhe të eksportit ka pasur në Slloveni (89.8%), Kroaci 45%, Italia 32.5% dhe Bullgaria 21%, si dhe vendet e tjera që janë të prezantuara në tabelën në vijim.

Shtetet të cilat janë paraqitur më poshtë prezantojnë 87.6% të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore, ndërsa pjesën tjetër prej 12.4% është eksport i produkteve bujqësore në shtetet tjera të BE-së.

Tabela 80: Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 €

	2023	2024	Ndryshimi '24/'23, (%)	Pjesëmarrja 2024 në %
Gjermani	15,948	16,828	5.5	32.7
Holandë	6,387	4,770	-25.3	9.3
Itali	5,179	6,860	32.5	13.3
Bullgari	4,241	5,130	21.0	10.0
Suedi	2,804	3,210	14.5	6.2
Austri	2,220	2,487	12.0	4.8
Rumani	2,140	1,466	-31.5	2.8
Kroacia	1,748	2,535	45.0	4.9
Sllovenia	983	1,866	89.8	3.6
Të tjera	4,671	6,378	36.5	12.4
Gjithsej	46,322	51,530	11.2	100




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së në vitin 2024 është rritur për 22.7%, në krahasim me vitin paraprak. Vendet në të cilat rritja ka qenë më e theksuar janë prezantuar si në vijim: Polonia 75.3%, Bullgaria 46.3%, Rumania kishte rritje prej 38.7%, Hungaria 36%, Austria 26.7%, vijuar nga vendet tjera.

Tabela 81: Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 €

	2023	2024	Ndryshimi '24/'23, (%)	Pjesëmarrja 2024 në %
Gjermani	100,426	111,361	10.9	13.8
Holandë	76,544	87,770	14.7	10.9
Itali	75,649	79,617	5.2	9.9
Bullgari	66,754	117,033	75.3	14.5
Suedi	61,941	68,771	11.0	8.5
Austri	50,351	68,496	36.0	8.5
Rumani	39,233	57,390	46.3	7.1
Kroacia	33,444	42,364	26.7	5.2
Sllovenia	33,099	45,917	38.7	5.7
Të tjera	121,170	129,424	6.8	16.0
Gjithsej	658,612	808,144	22.7	100



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nëntë shtetet e paraqitura më lartë paraqesin 84% të vlerës së importit të produkteve bujqësore nga vendet e BE-së, ndërsa pjesa tjetër prej 16% e vlerës së importit është nga vendet e tjera të BE-së.

Tregtia me vendet e tjera

Gjatë periudhës 2020–2024, shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet e tjera ka shënuar një trend të qëndrueshëm të rritjes. Në vitin 2024, eksporti i produkteve bujqësore drejt këtyre vendeve arriti në 15.6 mil. €, që paraqet rritje prej 16%, krahasuar me vitin 2023. Ndërsa, importi i

produkteve bujqësore nga vendet e tjera në vitin 2024 ishte 344 mil. €, ose 1.5% më i lartë se një vit më parë. Pavarësisht rritjes së eksporteve, bilanci tregtar me vendet e tjera mbetet negativ edhe gjatë vitit 2024, duke pasqyruar varësinë e vazhdueshme nga importet në sektorin bujqësor.

Tabela 82: Eksporti dhe importi nga Vendet e tjera, në '000 €


Viti	Eksport (01-24)	Import (01-24)	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e importit me eksport (%)
2020	7,581	177,334	-169,753	4.3
2021	9,337	232,001	-222,663	4.0
2022	11,404	313,780	-302,376	3.6
2023	13,458	338,831	-325,373	4.0
2024	15,606	344,048	-328,442	4.5

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Shtetet me pjesëmarrjen më të madhe në eksport nga grupi i vendeve të tjera ishin: Zvicra me 33%, SHBA me 17%, Turqia 9% dhe Arabia Saudite 7%.

Shtetet me pjesëmarrjen më të madhe në import nga grupi i vendeve të tjera ishin: Turqia 33%, Sri Lanka 3% dhe SHBA me 3%.

Figura 29: Eksporti dhe importi me Vendet e tjera, 2024



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti total i produkteve bujqësore në vitin 2024 ishte 170.8 mil. €, që paraqet rritje prej 15.4%, në krahasim me vitin 2023. Rritje më të theksuar ka pasur në kapitujt: 08 (Pemët dhe aroret) me rritje prej 84%, 21 (Përgatitje të ndryshme të ngrënshme) me rritje prej 48%, 23 (Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë) 47% dhe 19 (Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej

brumërave) që kishte rritje prej 36% si dhe kapitulli 22 (Pijet, alkoolet dhe uthulla) me rritje prej 26%.

Tabela 83: Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24), 2020-2024

Kodi	Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
01	Kafshët e gjalla	0	0	856	3,105	7,133
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	337	654	7,828	8,362	6,578
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	111	216	530	542	390
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore,	841	1,211	2,118	2,728	2,931
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	4	118	228	207	134
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	1,641	1,468	2,143	1,250	305
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	8,869	6,415	9,817	11,423	13,399
8	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	9,681	11,391	9,132	5,343	9,842
9	Kafe, çaj, krem dhe erëza	5,890	6,147	7,063	9,818	9,591
10	Drithërat	513	505	300	321	336
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera;	1,133	1,872	1,305	1,927	2,009
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	4,064	3,648	3,536	4,017	4,473
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	0	0	1	0	2
14	Materialet vegjetale që përdoren përthurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	0	8	10	5	-
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	1,433	1,695	4,525	8,171	7,239
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	1,817	4,037	7,795	6,140	3,810
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	846	990	1,262	1,553	1,550
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakao	1,449	1,987	2,917	3,279	2,988
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastičerisë	1,667	2,130	3,447	5,463	7,419
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arrove apo pjesëve të tjera të bimëve	6,378	8,798	11,152	14,086	13,940
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	638	1,229	1,542	3,712	5,493
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	29,667	36,638	39,040	54,116	68,143
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	1,093	1,452	2,189	2,095	3,089
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	5	32	215	331	0
	Gjithsej (01-24)	78,076	92,642	118,949	147,993	170,793

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)

Importi total i produkteve bujqësore në vitin 2024 ishte rreth 1.4 mld. €, që paraqet rritje prej 8.4% në krahasim me vitin 2023. Kapitujt të cilët kanë shënuar më tepër rënie në vitin 2024, në krahasim me vitin 2023 janë: 10 (Drithërat) me 20%, 11 (Produktet e industrisë bluajtëse) me

3.3%, 17 (Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij) me 2.9% dhe 07 (Perimet) me 1.7%, ndërsa të gjithë kapitujt e tjerë kanë shënuar rritje të vlerës së importit.

Tabela 84: Importi i produkteve bujqësore 2020-2024, në '000 €

Kodi	Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
01	Kafshët e gjalla	30,236	49,285	69,972	86,501	97,011
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	60,824	82,618	125,315	106,197	127,575
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	4,236	5,227	6,353	7,347	7,902
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	50,800	58,504	77,136	80,325	90,040
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	1,098	1,745	1,467	2,026	2,391
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	5,926	6,757	7,828	8,800	9,689
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	24,957	31,150	33,906	50,282	49,441
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	39,185	43,365	44,889	60,901	64,087
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	27,839	32,053	38,207	39,684	51,842
10	Drithërat	41,893	38,645	54,548	52,536	41,954
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	13,689	10,588	12,044	13,599	13,154
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	9,852	11,195	10,614	13,715	15,198
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	386	405	411	570	580
14	Materialet vegjetale që përdoren përthurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	14	31	15	3	3
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	32,135	41,398	61,128	43,767	48,055
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	31,754	36,631	43,316	47,728	51,761
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	30,795	38,063	51,090	55,204	53,631
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	25,509	30,221	32,504	37,029	42,016
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastigerisë apo prej brumërave	69,975	88,803	105,421	119,485	126,624
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arnoreve apo pjesëve të tjera të bimëve	28,130	36,892	40,093	49,041	54,015
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	75,852	90,955	106,476	116,301	131,137
22	Pijet, alkoolët dhe uthulla	76,266	115,123	135,837	141,964	143,556
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	20,903	29,391	33,540	32,738	34,659
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	63,101	86,522	105,019	119,221	137,048
	Gjithsej (1-24)	765,357	965,569	1,197,126	1,284,966	1,393,369

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.3 Tregtia e plehrave dhe pesticideve

Importi i plehrave ka pësuar ndryshime të theksuara gjatë viteve. Fillimisht, sasia e importit ra për disa vite me radhë, ndërsa çmimet u rritën ndjeshëm për shkak të zhvillimeve të tregut global. Kjo arriti kulmin në vitin 2022, kur plehrat u bënë dukshëm më të shtrenjta në tregjet ndërkombëtare. Pas këtij viti, situata filloi të stabilizohej, çmimet nisën të bien gradualisht dhe sasia e importeve u rrit sërish.

Sa i përket vlerës së importit, nga viti 2020 në 2021 ka pasur një rritje të lehtë prej rreth 5.3%. Rritja më e madhe u shënua nga viti 2021 në 2022, me një rritje prej 65.4%, e cila lidhet me faktor global si: rritja e çmimeve të plehrave, kostot e energjisë dhe problemet në zinxhirët e furnizimit pas pandemisë. Ndërsa, nga viti 2023 deri në vitin 2024, vlera e importit pësoi një rënie të lehtë prej rreth 3.4%.

Sasia e importit ka ndjekur një dinamikë tjetër, në vitin 2020 ishte sasia më e madhe e importuar, pasuar me rënie në vitin 2022, me nivelet më të ulëta të importit. Pas këtij viti, sasia filloi të rritet ndjeshëm, nga 2022 deri në 2024, me një rritje të fortë prej rreth 17.6% në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak.

Çmimet e plehrave u dyfishuan në vitin 2022, e që rezultoi edhe me ulje të sasisë së importuar. Periudha 2023–2024 tregon rritje të dukshme në sasi, ndërkohë që çmimet vazhdojnë të mbeten të larta krahasuar me fillimin e periudhës së analizuar, por me tendencë stabilizimi. Në vitin 2024, sasia u rrit ndjeshëm, ndërsa vlera u ul lehtë, çka tregon ulje çmimesh dhe konsolidim të tregut.

Tabela 85: Importi i plehrave, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024
Vlera në 1000 €	17,821	18,761	31,030	27,139	26,218
Sasia në tonë	66,280	55,510	45,902	51,268	60,302
Vlera për njësi €/kg	0.27	0.34	0.68	0.53	0.43

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Gjatë periudhës 2020–2024, importi i pesticideve ka shfaqur një rritje të qëndrueshme në vlerë, ku në vitin 2024 është vlera më e lartë e importit. Nga viti 2020 në vitin 2021 vërehet një rritje e moderuar, ndërsa gjatë viteve në vazhdim vlera e importit vazhdon të rritet, pavarësisht luhatjeve në sasi.

Sasia e importuar ka pasur një trajektore të ndryshme, ajo ka rënë deri në vitin 2022, vit në të cilin shënohet niveli më i ulët i sasisë së importit. Megjithatë, vlera mbetet e lartë, çka tregon rritje të çmimit për njësi, e lidhur me faktorë si rritja e çmimeve ndërkombëtare, vështirësitë në furnizim dhe kërkesa e qëndrueshme. Pas vitit 2022, sasia ka nisur të rritet gradualisht me rritje të lehtë edhe në vitin 2023, ndërsa vlera qëndron pothuajse e pandryshuar. Në vitin 2024, si sasia ashtu edhe vlera e importit rriten ndjeshëm.

Çmimi mesatar i pesticideve ka shënuar një rritje të vazhdueshme nga viti 2020 deri në vitin 2022, duke arritur kulmin në vitin 2022, kur kostoja për kilogram ishte dukshëm më e lartë. Kjo rritje lidhet me faktorë global, si rritja e çmimeve të lëndëve të para dhe vështirësitë në furnizim. Nga viti 2023, çmimi fillon të bie ndjeshëm krahasuar me 2022, duke treguar një stabilizim të tregut. Në vitin 2024 çmimi mbetet i qëndrueshëm, me një rritje shumë të lehtë në krahasim me vitin 2023, por ende nën nivelet e vitit 2022.

Tabela 86: Importi i pesticideve, 2020-2024

	2020	2021	2022	2023	2024
Vlera në 1000 €	4,935	5,284	5,538	5,489	6,614
Sasia në tonë	1,142	1,079	804	989	1,174
Vlera për njësi €/kg	4.32	4.90	6.89	5.55	5.63

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është autoriteti kompetent në Kosovë për sigurinë e ushqimit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe shëndetit të bimëve. Të dhënat e prezantuara në vijim pasqyrojnë aktivitetet kryesore të kësaj agjencie, përfshirë inspektimet, monitorimet, mostrat dhe mbikëqyrjen, në përputhje me detyrimet ligjore dhe Planin e Kontrollit Zyrtar. AUV-i, si pjesë e MBPZhR-ës, ka zbatuar kontrolle zyrtare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret e Bashkimit Evropian, në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA).

AUV, fokus kryesor ka qytetarët dhe sigurinë ushqimore, duke ofruar kanale të shumta komunikimi për të lehtësuar raportimin dhe marrjen e informacioneve me ç'rast është funksionalizuar: Linja e gjelbër pa pagesë; Zyra në Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK) si dhe Web faqja zyrtare dhe Rrjetet sociale.

AUV, ka bashkëpunime të ngushta edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, Zyrën e Kryeministrit dhe mekanizmat e sigurisë për menaxhimin e situatave të rrezikut si dhe angazhimin e organeve si policia, pushteti lokal dhe shoqatat e fermerëve për menaxhimin e shpërthimeve të sëmundjeve infektive.

Sa i përket bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare, janë organizuar takime virtuale dhe aktivitete me organizata si: EFSA, OIE, FAO, OBSH. Ka pasur Kontakt të vazhdueshëm me Autoritetin Evropian të Sigurisë Ushqimore, përmes rrjetit të komunikimit dhe pikës kontaktuese. Po ashtu ka pasur edhe marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Kroacisë për Bujqësi dhe Ushqim dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, me qëllim përmirësimin e sigurisë ushqimore.

Agjencia përdor aktualisht sistemet softuerike të paraqitura si në vijim: Sistemi i Pagesave dhe Certifikatave Elektronike (SCPE); Sistemi i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve; Sistemi i Kontrollit dhe Gjurmëshmërisë së Ushqimit (FCMS), si dhe Sistemi Informativ i Menaxhimit të Laboratorit (LIMS). Vlen të ceket se SCPE edhe këtë vit shkëmben certifikatat fitosanitare përmes sistemit SEED+, sistem i cili ka funksionuar online edhe gjatë festave dhe vikendeve.

Drejtoria e Inspektoratit, që vepron në kuadër të AUV-së është angazhuar në garantimin e sigurisë ushqimore, ruajtjen e shëndetit publik, mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, përmes zbatimit të detyrave dhe përgjegjësisë të saj ligjore. Në kuadër të planeve vjetore për kontrollet zyrtare, gjatë vitit 2024 janë realizuar një numër i konsiderueshëm inspektimesh dhe marrje e mostrave, si për produktet vendore ashtu edhe për ato të importit. Nga gjithsej 70,950 inspektime, 10,647 ishin për produkte vendore dhe 60,303 për ato të importit. Numri i mostrave vendore ishte 42,522, nga të cilat 1,722 për produkte vendore dhe 40,800 për ato të importit.

Tabela 87: Numri përgjithshëm vjetor i inspektimeve dhe mostrave, 2024

	Vendore	Importi	Gjithsej
Inspektime	10,647	60,303	70,950
Mostra	1,722	40,800	42,522
Gjithsej	12,369	101,103	113,472

Burimi: Drejtoria e Inspektoratit, AUV

Sektori i Inspektoratit Veterinar, ka realizuar aktivitete sipas Planeve të Kontrolleve Zyrtare dhe monitorimit, me fokus në garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Kontrollat janë përqendruar të operatorët e biznesit me ushqim të miratuar nga AUV, duke përfshirë: Objekte për therje kafshësh, Përpunues të produkteve shtazore (mish, qumësht, peshk, vezë), dhe Objekte për ruajtjen e ushqimit.

Gjithashtu, janë kryer kontrolle zyrtare në: Fermat e përzgjedhura për monitorimin e Identifikimit dhe Regjistrimit, Programet e vaksinimit dhe hulumtimet diagnostike, Subjektet që ofrojnë shërbime veterinarë dhe Grumbullues dhe tregtues të lëkurave. Janë kryer gjithsej 336 kontrolle zyrtare dhe 3,742 inspektime ku përfshihen markete, mishtore dhe thertore që njëherit kishin edhe numrin më të madh të inspektimeve (3,328) apo 89%, duke ditur rëndësinë e tyre në zinxhirin e sigurisë ushqimore.

Tabela 88: Numri i planifikuar i kontrolleve zyrtare, 2024

Kontrolle zyrtare		Inspektime	
Fabrika të përpunimit të mishit	143	Markete	324
Fabrika të përpunimit të qumështit	106	Mishtore	90
Depo ftohëse për ruajtjen e produkteve me origjinë shtazore	87	Thertore	3,328
Gjithsej	336		3,742

Burimi: Inspektorati veterinar i brendshëm

Për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore, është bërë kontrolli i gjendjes shëndetësore të kafshëve para therjes, monitorimi i procesit të therjes si dhe kontrolli dhe vulosja e mishit për lejimin e tij për konsum publik.

Janë dorëzuar gjithsej 741 mostra në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë, prej të cilave numri më i madh ka qenë mostra për detektim të mbetjeve në ushqim (340), për parametra mikrobiologjik (312) si dhe 89 parametra fiziko-kimik.

Tabela 89: Numri i mostrave të dërguara në LUV

Mostrat e dorëzuara në LUV	
Parametra mikrobiologjik	312
Parametra fizo-kimik	89
Mostra për detektim të mbetjeve në ushqim	340
Gjithsej	741

Burimi: Inspektorati veterinar i brendshëm

Po ashtu, me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies së njeriut, nga ky Inspektorat janë asgjësuar gjithsej 790,916 kg produkte, prej të cilave 522,955 kg mish, 226,981 kg produkte qumështi, 474 kg mjaltë dhe 40,506 peshk.

Tabela 90: Asgjësimi i produkteve nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm

	Sasia në kg
Produkte mishi	522,955
Produkte qumështi	226,981
Mjaltë	474
Peshk	40,506
Gjithsej	790,916

Burimi: Inspektorati veterinar i brendshëm

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë, vërehet se më së shumti inspektime janë kryer në periudhën e tremujorit të katërt (Tetor-Dhjetor), me 2,195 inspektime. Sa i përket mostrave, numër më i madh i mostrave ka qenë po ashtu në periudhën e tremujorit të katërt, me 259 mostra.

Tabela 91: Numri vjetor i inspektimeve dhe mostrave të marra nga IVB, sipas tremujorëve

T1		T2		T3		T4	
Janar-Mars		Prill-Qershor		Korrik-Shtator		Tetor-Dhjetor	
Inspektime	Mostra	Inspektime	Mostra	Inspektime	Mostra	Inspektime	Mostra
2,118	143	1,858	156	2,117	183	2,195	259
Gjithsej		8,288 inspektime / 741 mostra					

Burimi: Inspektorati Veterinar i Brendshëm

Nga AUV, gjegjësisht nga IVB, në vitin 2024, janë zhvilluar aktivitete inspektuese, duke filluar nga prodhues dhe përpunues të mishit ku janë bërë 143 inspektime, prodhues dhe përpunues të qumështit 106, depo ftohëse 87, thertoret për kontroll të kafshëve para therjes 3,328, monitorimi i fermave blegtorale për karantinim 1,645, marketet, mishtoret dhe shitja me pakicë 414, certifikata të kontrollit të mishit 37,584, si dhe inspektime të tjera që janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 92: Numri dhe aktivitetet inspektuese nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm

Nr.	Aktivitetet të cilat i nënshtrohen kontrollit zyrtar veterinar	Numri i Inspektimeve
1	Përpunuesit dhe prodhuesit e mishit	143
2	Përpunuesit dhe prodhuesit e qumështit dhe produkteve të tij	106
3	Subjektet e ri paketimit të produkteve ushqimore për konsum publik	6
4	Depo ftohëse ushqimore, ripaketuesit	87
5	Thertoret për kontroll të kafshëve para therjes dhe marrjen e mostrave sipas planit nacional	3,328
6	Monitorimi i fermave blegtorale për karantinimin, menaxhimin e sëmundjeve infektive dhe shërbimet veterinare sipas kontratës me AUV	1,645
7	Inicim të procedurave për kundërvajtje	107
8	Praktikat veterinare private	127
9	Marketet, mishtoret dhe shitja me pakicë	414
10	Restorante	93
11	Tregje të kafshëve	12
12	Inspektime sipas kërkesave (policisë, doganës)	82
13	Ankesat e konsumatorit	75
14	Certifikata eksportuese të produkteve ushqimore	1,919
15	Certifikata të brendshme të produkteve ushqimore	251
16	Certifikata të kontrollit të mishit	37,584

Burimi: Inspektorati Veterinar i Brendshëm

Përveç aktiviteteve që janë zhvilluar nga IVB, gjatë vitit 2024 gjithashtu Kontrolli i Brendshëm Fitosanitar ka kryer aktivitete të rëndësishëm në detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit Fitosanitar, veçanërisht në kontrollet zyrtare dhe mostrimin. Aktivitetet më të rëndësishme po i paraqesim si në vijim:

- Monitorimi i dëmtuesve me prioritet të lartë, duke parandaluar pasoja serioze mjedisore, ekonomike dhe për biodiversitetin;
- Përmirësimi i kontrollit mbi tregtimin, ruajtjen dhe përdorimin e pesticideve dhe plehrave artificiale, duke rezultuar në rritje të masave fitosanitare;
- Monitorimi i pesticideve, metaleve të rënda dhe kontaminantëve në pemë e perime;
- Konstatimi i moszbatimit të Ligjit për pasurimin e miellit dhe marrja e masave për përmirësimin e situatës.

Për të mos i listuar të gjitha aktivitetet e zhvilluara, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur llojet dhe numri i inspektimeve të kryera nga Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm.

Tabela 93: Numri dhe lloji i inspektimeve të kryera nga Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm

Nr	Lloji i aktiviteteve	Gjithsej
1	Monitorimi i organizmave karantinorë	98
2	Prodhuesit dhe Importuesit e Verërave dhe Pijeve alkoolike	48
3	Prodhuesit, Importuesit dhe Tregtuesit e Miellit	182
4	Përpunuesit e Pemëve dhe Perimeve	182
5	Importuesit, Ri-paketuesit dhe tregtuesit e PMB-ve	226
6	Prodhuesit, Importuesit dhe Tregtuesit e materialit Fidanor	205
7	Importuesit, Ri-paketuesit dhe tregtuesit e Plehrave Artificiale	113
8	Prodhuesit, Importuesit, Ri-paketuesit dhe Tregtuesit e Farërave	342
9	Pëlqimet për licencime	526
10	Inspektime të pa planifikuara	437
11	Inspektimi i farës së grurit për certifikim	208 ha
12	Nr. Procesverbaleve të Inspektimit	2,359
13	Nr. Mostrave për Analiza	981
14	Nr. Procesverbaleve të Mostrimit	981
15	Vendimet e lëshuara	25
16	Nr. Fletëparaqitjeve të lëshuara	71
17	Lëshimi i Certifikatave Fitosanitare për Eksport	1,722
18	Lëshimi i Certifikatave Fitosanitare për Re - Eksport	504
19	Lëshimi i Certifikatave Fitosanitare të Brendshme	26
20	Certifikatat (Certifikatë Shëndetësore)	7,519

Burimi: Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm

Nga laboratorit i analizave të qumështit u pranuan gjithsej 2,827 kërkesa, ku janë marrë 18,202 mostra, në të cilat janë kryer 37,188 testime duke përdorur dy aparatura BactoScan dhe MilkoScan. Është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, ku gjithashtu janë përgatitur tabelat e klasifikimit të cilësisë së qumështit.

Nga të dhënat në tabelën e më poshtme, del se numri i përgjithshëm i mostrave në të gjitha klasat është 17,961: Klasa e qumështit Extra $\leq 80,000$ përfaqëson grupin më të madh me 9,899 mostra, që përbëjnë 55% të totalit, Klasa e I $\leq 100,000$ përbëhet nga 567 mostra apo 3% të totalit, Klasa e II $\leq 300,000$ ky grup përfshin 2,330 mostra, që përbëjnë 13% të totalit dhe për Klasën e III $\leq 500,000$ ka 5,165 mostra, që përbëjnë 29% të totalit.

Tabela 94: Tabela e kalsifikimit të qumështit sipas ngarkesës mikrobiale, 2024

	Extra ≤80.000		Klasa e I ≤100.000		Klasa e II ≤300.000		Klasa e III ≤500.000		Gjithsej
	Mostra	%	Mostra	%	Mostra	%	Mostra	%	
Janar	833	56	33	2	190	13	419	28	1,475
Shkurt	917	59	54	3	192	12	392	25	1,555
Mars	913	58	49	3	198	13	412	26	1,572
Prill	956	59	51	3	198	12	415	26	1,620
Maj	916	53	58	3	235	14	508	30	1,717
Qershor	862	53	54	3	207	13	499	31	1,622
Korrik	836	50	62	4	242	14	535	32	1,675
Gusht	860	52	50	3	240	14	511	31	1,661
Shtator	829	50	37	2	185	11	596	36	1,647
Tetor	976	55	67	4	229	13	495	28	1,767
Nëntor	1,001	61	52	3	214	13	383	23	1,650
Dhjetor									
Gjithsej	9,899	55	567	3	2,330	13	5,165	29	17,961

Burimi: Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm

5.1 Emetimi i gazrave serrë

Zbutja e ndryshimeve klimatike do të thotë zvogëlimi i rrjedhës së gazrave serrë që bllokojnë nxehtësinë në atmosferë. Kjo përfshinë uljen e gazrave serrë nga burimet kryesore si termocentralet, fabrikat, makinat dhe fermat. Pyjet, oqeanet dhe toka gjithashtu thithin dhe ruajnë këto gazra dhe janë një pjesë e rëndësishme e zgjidhjes. Zvogëlimi dhe shmangia e emetimeve tona kërkon që ne të riformësojmë gjithçka që bëjmë, nga mënyra se si e fuqizojmë ekonominë tonë deri te mënyra se si udhëtojmë dhe jetojmë, si dhe produktet që konsumojmë.

Evropa, kontinenti ku ne jetojmë, viteve të fundit po përballet gjithashtu me rreziqe më të shumta dhe më të forta klimatike, duke përfshirë valë të nxehta dhe thatësira të zgjatura, reshje të dendura që çojnë në përmbytje pluviale dhe lumore, dhe rritje të nivelit të detit që çon në përmbytje bregdetare.¹² Të dy llojet e përmbytjeve janë gjithashtu të lidhura ngushtë me ndryshimet klimatike, të cilat sjellin reshje më intensive dhe rrisin mundësinë e shkrirjes së borës në lartësi më të mëdha. Për më tepër, ndërhyrjet njerëzore, siç janë urbanizimi i shpejtë dhe menaxhimi joefikas i burimeve natyrore, rrisin rrezikun e këtyre përmbytjeve.

Të nxehtit dhe thatësirat e zgjatura po shtohen me ndryshimet klimatike, duke ndikuar në kriza akute, të tilla si zjarre të përhapura në shkallë të gjerë, dështime në infrastrukturë, ndërprerje të energjisë elektrike dhe ndikime të mëdha shëndetësore dhe ekonomike. Evropa përballet me një rrezik në rritje të mega-thatësirave që përfshijnë rajone të mëdha dhe zgjasin për disa vite. Thatësirat e zgjatura shkaktojnë dëme të mëdha ekonomike në shumë sektorë, duke degraduar rëndë burimet ujore nga të cilat varen njerëzit, bujqësia, industria, termocentralet, transporti lumor dhe ekosistemet.

¹² European Environment Agency-European Climate Risk Assessment.

Në dekadat e fundit, vendet e BE-së kanë ulur emetimet me mbi 37% që nga viti 1990, kryesisht falë rritjes së energjisë së ripërtëritshme dhe zvogëlimit të përdorimit të karburanteve fosile me karbon të lartë. Përmirësimet në efikasitet dhe ndryshimet strukturore në ekonomi gjithashtu kanë ndihmuar në uljen e emetimeve. Objektivat e reja synojnë një ulje neto prej 55% deri në 2030 dhe neutralitet klimatik deri në 2050, duke kërkuar kalimin në energji të pastër, ndalimin e shpyllëzimit dhe ruajtjen e natyrës për balancimin e gazrave serrë.

BE-ja kontribuon me 6% të emetimeve globale dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, përmes UNFCCC dhe Marrëveshjes së Parisit, është thelbësor për të gjitha zbutjet e ndryshimeve klimatike. Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)¹³ dhe Marrëveshja e Parisit sigurojnë bashkëpunim përtej kufijve për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme.

Përkundër veprimeve të ndërmarra për uljen e emetimeve të gazrave serrë, gjatë periudhës 12 mujore midis shkurtit 2023 dhe janarit 2024, temperatura mesatare globale kaloi nivelet para-industriale me 1.5°C. Viti 2023 ka shënuar rekordin e vitit më të ngrohtë në nivel global, me një rritje prej 1.5°C mbi nivelet para-industriale, ndërsa temperaturat e oqeanit botëror arritën gjithashtu nivele rekorde. Evropa është kontinenti që po përjeton ngrohjen më të shpejt, që nga vitet 1980, ngrohja në kontinent ishte rreth dyfishi i normës globale.¹⁴

Kosova po ashtu ka zhvilluar strategji dhe plane kombëtare për klimën, të tilla si Strategjia për ndryshimet klimatike 2019-2028, Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019-2021. Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028 përcakton politikat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë (GS) dhe për përshtatje me ndryshimet klimatike. Po ashtu, ajo paraqet një mundësi që të gjenden dhe përcaktohen masat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike, të cilat do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm.

Në këtë aspekt janë bërë investime në mbledhjen e të dhënave klimatike dhe monitorimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në sektorë të tillë si bujqësia dhe pylltaria, përmes zbatimit të projekteve për menaxhimin e burimeve natyrore, për të forcuar kapacitetet e komuniteteve lokale dhe për të zhvilluar praktika të qëndrueshme. Po ashtu, janë zhvilluar fushata për të edukuar dhe angazhuar qytetarët në mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kosova bashkëpunon me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë për marrjen e mbështetjes teknike dhe financiare në fushën e klimës.

Në përgjithësi, është duke punuar për të forcuar kapacitetet dhe për të integruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në politika dhe praktika të qëndrueshme.

¹³ UNFCCC - Konventë Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, një traktat ndërkombëtar nga viti 1992 që formon bazën për bashkëpunim global për të luftuar ndryshimet klimatike, me qëllim stabilizimin e niveleve të gazrave serrë dhe udhëzimin e marrëveshjeve pasuese si Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit, me sekretariatin e tij që mbështet veprimet globale për klimën.


¹⁴ European Environment Agency-European Climate Risk Assessment.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në baza vjetore bënë vlerësimin e emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Inventari i emisioneve jep vlerësim të sasisë së ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme. Ky inventar është një nga mjetet kryesore për menaxhimin e cilësisë së ajrit, pasi që ofron informacione të detajuara për kontribuesit e ndotjes nga aktivitete dhe burime të ndryshme, dhe bënë të mundur që të kuptojmë shkaktarët kryesorë të ndotjes dhe ndërmarrjen e masave efektive në reduktimin e emetimit dhe në të njëjtën kohë për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe ambientit.

Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë në vendin tonë është sektori i energjisë, sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës, sektori i mbeturinave dhe sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve. Burimet kryesore të informatave për kalkulimin e emisioneve nga sektori i bujqësisë, janë të dhënat për numrin e bagëtive sipas kategorisë, të dhënat për format e menaxhimit të plehut të stallës, të dhënat për sasinë vjetore të UREA-s dhe plehrave të përdorura, për prodhimin bujqësor, për sipërfaqet e djegura sipas kategorive të tokave si dhe disa të dhëna për klimën dhe temperaturën mesatare vjetore.

Në figurën në vijim vërehet se, nga viti 2007 (553 Gg) deri në 2021 (956 Gg), emetimet kanë shënuar një rritje të përgjithshme, me një rritje më të theksuar gjatë periudhës 2013–2021, pas disa viteve me progres më të ngadaltë. Tendencat e përgjithshme të emetimeve totale të gazrave serrë tregojnë një rënie graduale pas vitit 2021, nga 956 Gg CO₂ eq. në vitin me nivelin më të lartë të emetimit, në 750 Gg CO₂ eq. në vitin 2023. Kjo reflekton një përmirësim në menaxhimin e emetimeve gjatë tre viteve të fundit. Në vitet 2022 (825 Gg) dhe 2023 (750 Gg), emetimet kanë rënë nga niveli më i lartë i vitit 2021, por mbeten ende më të larta krahasuar me disa nga vitet paraprake.

Figura 30: Emetimet e GHG nga Sekt. i Bujqësisë dhe Përdorimit të Tokës Gg CO₂ eq. 2021-2023



Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural

6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve

Sektori i bujqësisë në vitin 2024 ka vazhduar të mbështetet përmes dy programeve të hartuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e të cilat janë: Programi për Zhvillim Rural dhe Programi i Pagesave Direkte.

Objektivat afatmesme në të cilat bazohet Programi për Zhvillim Rural, janë si në vijim:

- Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor, duke përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, duke tërhequr fermerët e rinj, duke orientuar prodhimin sipas kërkesave të tregut, duke përmirësuar zinxhirin e vlerës, dhe duke u fokusuar në kërkimin, inovacionin, teknologjinë e re dhe digjitalizimin;
- Të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar me një pjesë më të madhe të prodhimit vendas;
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisore, të cilat adresojnë sfidat e ndryshimeve klimatike duke arritur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, zhvillimi i komunitetit dhe përfshirja sociale në zonat rurale dhe ndërtimi i administratave publike moderne, duke respektuar parimet e qeverisjes së mire.

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2024 kanë qenë të përfshira masat në vijim:

- Masa 1: Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore;
- Masa 3: Investime në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;
- Masa 5: Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal –“Qasja Leader”;
- Mbështetja për masat e menaxhimit të rrezikut në bujqësi (sigurimet bujqësore).

Gjithsej buxheti i planifikuar për implementimin e Programit për Zhvillimit Rural 2024 ka qenë 19,627,000.00 €.

Objektivat kryesore të përcaktuara në Programin e Pagesave Direkte 2024 janë:

- Rritja e konkurrencës së prodhimit primar bujqësor;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Rritja e rendimentit;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe zbatimi i standardeve të sigurisë ushqimore;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritje e kapaciteteve përpunuese;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

Mbështetja përmes pagesave direkte është bërë bazuar në Programin e Pagesave Direkte 2024 dhe mbështetja është bërë për:

- Kultura bujqësore (mbështetja bëhet për hektarë, me përjashtim të mjedrës që është bërë në bazë të sasisë (kg), si dhe për grurin dhe grurin për farë që përveç hektarëve mbështetja është bërë edhe për sasinë e grurit/grurit për farë në kg). Gjithashtu prodhimi i verës është subvencionuar për litër;
- Blegtori (mbështetja bëhet: për krerë tek lopët qumështore, buallicat, delet dhe dhitë, dosat, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri, mëshqerra për riprodhim; për copë tek pulat vojse, zogjtë për majmëri (brojler) dhe kosheret; ndërsa subvencionimi për sasi bëhet tek qumështi në bazë të kategorisë së cilësisë (për litër) dhe akuakultura (për kg));
- Inpute (mbështetja për fidanet e pemët drufrutore dhe fidanet e hardhisë së rrushit, subvencionimi i pjesshëm i çmimit të naftës për kulturat bujqësore (150 litra për ha me çmim 0.36 €/litër) si dhe subvencionimi i plehut artificial të përdorur për grurë, farë gruri, elb, thekër, tërshërë, misër, luledielli, patate dhe fasule monokulturë me nga 100 €/ha).

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detajet lidhur me sektorët e subvencionuar përmes programit të pagesave direkte si dhe detajet e pagesave për njësi të subvencionuar.

Tabela 95: Pagesat direkte për njësi, PPD 2024


Kultura	Subvencionimi për njësi	Subvencionimi për naftë
Grurë	150 €/ha	0.36 €/litër
	0.04 €/kg	
	100 €/ha pleh	
Farë gruri	250 €/ha	
	0.04 €/kg	
	100 €/ha pleh	
Elb	150 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Thekër	150 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Tërshërë	150 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Misër	175 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Luledielli	300 €/ha	
	100 €/ha pleh	
Vreshta ekzistuese	1,050 €/ha dhe 700 €/ha	
Pemishte ekzistuese	450 €/ha	
Mjedër	0.20 €/kg	
Perime	Perimet në fushë të hapur:	
	Spec ("Kurtovka", "Somborka"), Domate, Tranguj (kornishon), Qepë, Hudhër, Fasule monokulturë 600 €/ha	
	Perimet e tjera në fushë të hapur 500 €/ha	
	Perimet në serra 850 €/ha	
	Kunguj dhe kunguj misiri 150 €/ha	
	100 €/ha pleh (patate dhe fasule monokulturë)	
Bimë mjekësore dhe aromatike	450 €/ha	
Bujqësi organike	plus 100 €/ha (sip. në konvertim)	
	plus 250 €/ha (sip. e certifikuar)	
Fidanë	0.25 €/copë (pemë drufrutore)	
	0.15 €/copë (hardhi rrushi)	
Verë	0.08 €/litër	
Lopë qumështore	90 €/krerë	
Buallica qumështore	180 €/krerë	
Dele	25 €/krerë	
Dhi	30 €/krerë	
Bletë	20 € - (25 € organike)/koshere	
Qumësht	0.07 €/litër - Klasa ekstra	
	0.04 €/litër - Klasa I	
	0.02 €/litër - Klasa II	
Pula vojse	0.50 €/pulë vojse	
Dosa	25 €/krerë	
Therje të raportuara të gjedhit	50 €/krerë të therur	
Akuakulturë	0.20 €/kg	
Viça për majmëri	25 €/krerë	
Zogj për majmëri (brojler)	0.20 €/zog	
Mëshqerra për riprodhim	50 €/krerë	

Burimi: Programi për Pagesa Direkte 2024

6.2 Pagesat direkte/subvencionet

Në vitin 2024, për mbështetje përmes Programit të Pagesave Direkte aplikuan gjithsej 32,561 fermerë. Nga gjithsej numri i aplikuesve, përfitues nga ky program u shpallën 31,190 fermerë (96%), ndërsa u refuzuan për mosplotësim kriteresh apo mungesë dokumentacioni 1,371 fermerë (4%). Në raport me vitin 2023 numri i të refuzuarve është për 1 pikë % më i ulët.


Figura 31: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2024, gjithsej 66.5 mil. € ishte buxheti total i shpenzuar për Programin e Pagesave Direkte, që në raport me vitin 2023 gjithsej buxheti i shpenzuar është rritur për 5.4%. Viti 2024 shënoi edhe vlerën më të lartë të buxhetit të shpenzuar për pagesa direkte, përjashtuar vitin 2020 ku është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Figura 32: Pagesat direkte 2020-2024, në 1000 €



Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Tabela 96: Pagesat direkte 2020-2024, në €


	2020	2021	2022	2023	2024
Grurë	14,079,396	3,287,048	19,586,752	16,226,349	16,113,221
Farë gruri	434,540	131,913	48,895	101,454	112,884
Misër	8,547,885	2,840,082	11,803,368	9,037,918	10,873,164
Elb	132,645	308,040	153,708	131,919	174,402
Thekër	58,623	79,845	84,152	48,073	40,051
Tërshërë	396,261	249,689	345,727	328,497	393,403
Luledielli	12,036	2,946	10,192	100,288	365,863
Vreshta ekzistuese	6,160,400	2,520,246	2,870,896	3,036,542	2,865,802
Perime	5,525,712	2,764,378	3,620,710	3,208,347	5,311,572
Pemishte ekzistuese	3,805,736	1,814,448	2,526,360	2,784,293	2,825,646
Mjedra	168,854	103,766	172,987	141,420	339,831
Verë	228,452	731,900	308,089	303,025	185,651
Bimë mjekësore dhe aromatike	111,479	26,933	19,601	60,913	97,716
Bujqësi organike (certifikuar)	1,672,210	81,150	89,469	94,058	163,140
Bujqësi organike (në konvertim)	-	-	-	5,136	5,502
Lopë qumështore	9,421,300	4,893,535	4,727,430	4,651,560	4,649,890
Buallica	48,580	2,635	2,340	3,780	17,820
Dele dhe dhi	5,129,550	2,995,680	3,544,800	3,787,150	3,622,325
Bletë	6,996,810	2,888,265	3,811,735	3,757,770	4,172,576
Pula Vojse	1,165,861	500,676	399,161	525,490	560,560
Thëllëza	23,678	8,123	-	-	-
Dosa	75,080	20,840	22,375	18,975	15,525
Qumësht	4,906,204	2,358,351	2,840,801	2,777,848	3,225,073
Therje të raportuara të gjedhit	70,600	35,050	56,100	86,000	108,100
Akuakulturë	154,010	110,314	152,602	130,757	119,255
Viça për majmëri	-	79,380	193,300	348,275	463,500
Fidane	155,495	92,477	133,464	169,020	181,424
Primi i sigurimit bujqësor	1,769	170	1,775	71,922	-
Zogj për majmëri (brojler)	-	-	-	2,783	3,265
Përkrahje për pleh	-	-	-	11,123,184	9,324,617
Mëshqerra për riprodhim	-	-	-	-	141,200
Gjithsej	69,483,164	28,927,879	57,526,788	63,062,744	66,472,978

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR.¹⁵

Sektorët për të cilët është shpenzuar pjesa më e madhe e buxhetit në vitin 2024 (75.9% e buxhetit total) janë: gruri, misri, perimet, lopët qumështore, bletët si dhe përkrahja për pleh, ndërsa pjesa tjetër prej 24.1% është shpenzuar në sektorët e tjerë të paraqitur në figurën e mëposhtme.

¹⁵ *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike. **Sqarim: në vitin 2022 ka pasur mbështetje direkte për pleh mirëpo në tabelë ajo është e prezantuar në kuadër të shumës për kultura tek gruri, misri, patatja dhe fasulja monokulturë sepse është implementuar së bashku me pagesën bazë si një pagesë e vetme. ***Sqarim: Tek shuma e subvencioneve për grurë dhe farë gruri në vitin 2023 mund të ketë ndryshime me publikime paraprake duke qenë se shuma e paguar për sasinë e farës së grurit është e përfshirë tek shuma për grurë për shkak të krahasueshmërisë sepse në vitin 2024 pagesa ka qenë e njëjtë 0.04 €/kg për të dy kategoritë dhe është raportuar si një kategori subvencioni.

Figura 33: Pagesat direkte sipas sektorëve 2024, në mil. €



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në tabelën më poshtë është paraqitur numri i njësive të subvencionuara, ku ka pasur ngritje dhe rënie në numër të njësive, krahasuar me vitin paraprak varësisht llojit të njësisë së subvencionuar. Ngritje më të lartë kishte tek: sasia e subvencionuar e kilogramëve të mjedrës (80%), sasia e subvencionuar e kilogramëve të grurit (30%) dhe sasia e litrave të qumështit (14%), ndërsa rënie të theksuar kishte tek sasia e subvencionuar e litrave të verës (69%). Policat e sigurimit nuk janë subvencionuar përmes PPD-së në vitin 2024, sepse sigurimet bujqësore janë përfshirë në PZhR 2024.

Tabela 97: Numri i njësive të subvencionuara, 2020-2024


	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i hektarëve të subvencionuar	97,259	66,294	103,824	121,757	123,160
Sasia e subvencionuar e kilogramëve të grurit*	-	63,028,896	64,179,802	102,654,383	133,604,985
Sasia e subvencionuar e kilogramëve të mjedrës	1,055,337	864,717	1,153,245	942,798	1,699,158
Sasia e subvencionuar e litrave të verës	5,711,290	9,148,751	7,702,215	7,575,635	2,320,641
Numri i krrerëve të subvencionuar	241,210	217,067	204,094	219,622	218,236
Numri i koshereve të subvencionuara	233,227	192,551	190,579	187,876	208,633
Sasia e subvencionuar e litrave të qumështit	47,515,642	44,835,136	46,183,417	45,102,003	51,431,406
Numri i subvencionuar i pulave vojse, thëllëzave dhe zogjve për majmëri	1,333,913	1,136,594	871,909	1,064,893	1,137,445
Sasia e subvencionuar e kilogramëve të peshkut	385,024	551,571	763,008	653,787	596,273
Numri i fidanëve të subvencionuar	469,194	607,348	592,448	725,679	775,845
Numri i policave të sigurimit të subvencionuara	5	4	9	86	-
Numri i hektarëve të subvencionuar për pleh	-	-	87,777	84,195	93,246

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR.¹⁶

¹⁶ *Sqarim: Tek sasia e subvencionuar e kilogramëve të grurit është e përfshirë edhe sasia e subvencionuar e kilogramëve të farës së grurit për vitin 2023 dhe 2024 për shkak se në vitin 2024 pagesa ka qenë e njëjtë 0.04 €/kg dhe është raportuar si një kategori, andaj sasia e kilogramëve të grurit mund të paraqitet e ndryshme nga publikime paraprake ku në vitin 2023 kanë qenë të paraqitura si dy kategori.

Nga gjithsej numri i aplikuesve prej 32,561 fermerë, në vitin 2024, 95% (30,840) ishin aplikues meshkuj dhe 5% (1,721) aplikues femra. Përqindje e njëjtë është edhe tek përfituesit.


Figura 34: Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i aplikuesve femra, 95% përfituan nga PPD 2024 dhe vetëm 5% u refuzuan. Situatë e ngjashme ishte edhe me aplikuesit meshkuj me ndryshim të vogël prej 1 pikë % në krahasim me femrat, pra 96% përfituan dhe 4% u refuzuan.


Figura 35: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i aplikuesve, 97% kanë aplikuar si persona fizik dhe vetëm 3% si persona juridik. Përqindja e refuzimit ka qenë më e lartë tek aplikuesit si persona fizik (4%), në krahasim me aplikuesit si persona juridik, tek të cilët përqindja e refuzimit ishte 3%.

Figura 36: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sikurse përqindja e pjesëmarrjes, ashtu edhe përqindja e shumës së pagesave të realizuara në vitin 2024, për femra ishte shumë e ulët në krahasim me pagesat e realizuara për meshkuj. Nga gjithsej buxheti i shpenzuar prej 66.5 mil. €, 6% (3.9 mil. €) u paguan për përfituesit e gjinisë femërore dhe 94% (62.6 mil. €) për përfituesit e gjinisë mashkullore. Përqindja ishte e ndryshme varësisht nga sektori dhe detajet mund të shihen në tabelën e mëposhtme.

Përqindje e pjesëmarrjes së femrave prej 10% e më shumë është tek: pemishtet, bimët mjekësore aromatike, buallicat, bletët, pulat vojse, qumështi dhe fidanet.

Tabela 98: Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2024, në €

	Femër	Mashkull	% e pjesëmarrjes së femrave	% e pjesëmarrjes së meshkujve
Grurë	576,189	15,537,032	4	96
Farë gruri	-	112,884	-	100
Misër	518,304	10,354,860	5	95
Elb	6,193	168,208	4	96
Thekër	508	39,543	1	99
Tërshërë	16,419	376,984	4	96
Luledielli	1,929	363,933	1	99
Vreshta ekzistuese	56,337	2,809,465	2	98
Perime	271,516	5,040,057	5	95
Pemishte ekzistuese	347,710	2,477,936	12	88
Mjedra	20,944	318,888	6	94
Verë	800	184,851	0	100
Bimë mjekësore dhe aromatike	9,843	87,872	10	90
Bujqësi organike (certifikuar)	11,061	152,079	7	93
Bujqësi organike (në konvertim)	278	5,225	5	95
Lopë qumështore	350,190	4,299,700	8	92
Buallica	2,160	15,660	12	88
Dele dhe dhi	273,690	3,348,635	8	92
Bletë	469,195	3,703,381	11	89
Pula Vojse	80,700	479,860	14	86
Dosa	500	15,025	3	97
Qumësht	402,684	2,822,389	12	88
Therje të raportuara të gjedhit	650	107,450	1	99
Akuakulturë	10,816	108,439	9	91
Viça për majmëri	43,125	420,375	9	91
Fidane	19,175	162,249	11	89
Zogj për majmëri (brojler)	-	3,265	-	100
Përkrahje për pleh	380,682	8,943,935	4	96
Mëshqerra për riprodhim	8,650	132,550	6	94
Gjithsej	3,880,248	62,592,730	6	94

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej 66.5 mil. €, sa është buxheti total i shpenzuar për Pagesa Direkte në vitin 2024, 86% (57.03 mil. €) janë bërë pagesa tek personat fizik, dhe vetëm 14% (9.44 mil. €) tek personat juridik. Përqindja e pjesëmarrjes është e ndryshme varësisht kulturave/sektorëve, ku për dallim nga e përgjithshmja që pjesëmarrja e personave fizik është shumë më e madhe, tek kulturat/sektorët në vijim dominojnë përfituesit si persona juridik: farë gruri, verë, bujqësi organike, pula vojse, therje të raportuara të gjedhit, fidanë dhe zogj për majmëri.

Tabela 99: Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2024, në €

	Fizik	Juridik	% e pjesëmarrjes së personave fizik	% e pjesëmarrjes së personave juridik
Grurë	14,578,928	1,534,293	90	10
Farë gruri	40,706	72,179	36	64
Misër	9,832,499	1,040,665	90	10
Elb	161,909	12,493	93	7
Thekër	24,364	15,688	61	39
Tërshërë	332,564	60,839	85	15
Luledielli	209,203	156,659	57	43
Vreshta ekzistuese	2,126,308	739,495	74	26
Perime	4,760,670	550,902	90	10
Pemishte ekzistuese	2,202,480	623,166	78	22
Mjedra	331,863	7,968	98	2
Verë	-	185,651	-	100
Bimë mjekësore dhe aromatike	81,225	16,491	83	17
Bujqësi organike (certifikuar)	39,993	123,147	25	75
Bujqësi organike (në konvertim)	-	5,502	-	100
Lopë qumështore	4,059,040	590,850	87	13
Buallica	16,560	1,260	93	7
Dele dhe dhi	3,430,965	191,360	95	5
Bletë	3,830,521	342,055	92	8
Pula Vojse	-	560,560	-	100
Dosa	15,150	375	98	2
Qumësht	2,068,456	1,156,617	64	36
Therje të raportuara të gjedhit	-	108,100	-	100
Akuakulturë	-	119,255	-	100
Viça për majmëri	386,075	77,425	83	17
Fidane	-	181,424	-	100
Zogj për majmëri (brojler)	-	3,265	-	100
Përkrahje për pleh	8,384,897	939,720	90	10
Mëshqerra për riprodhim	117,050	24,150	83	17
Gjithsej	57,031,425	9,441,553	86	14

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i përfituesve, 42% janë nga: Rahoveci, Podujeva, Skenderaji, Peja, Lipjani, Vushtrria dhe Gjakova, ndërsa pjesa tjetër prej 58% janë nga 30 komunat e tjera. Sa i përket shumës së paguar, 57% e saj është e shpërndarë në: Rahovec, Podujevë, Vushtrri, Lipjan, Pejë,


Gjakovë, Ferizaj, Skenderaj, Istog dhe Klinë dhe pjesa tjetër prej 43% në 27 komunat e tjera. Komunitat në të cilat shumica mesatare e pagesave direkte për një përfitues është më e lartë (mbi 2.5 mijë €/përfitues) janë: Ferizaji, Fushë Kosova, Klina, Gjakova, dhe Istogu.

Tabela 100: Numri i aplikuesve, përfituesve dhe të refuzuarve si dhe shumica e pagesave direkte sipas komunave, në 2024

Komuna	Numri i aplikuesve	Numri i përfituesve	Numri i të refuzuarve	Shuma e paguar (€)
Deçan	891	861	30	1,588,934
Dragash	297	286	11	592,263
Ferizaj	1,170	1,144	26	3,255,073
Fushë Kosovë	468	449	19	1,247,212
Gjakovë	1,376	1,302	74	3,484,379
Gjilan	846	802	44	1,762,803
Drenas	1,136	1,091	45	2,194,819
Graçanicë	791	768	23	1,890,474
Hani i Elezit	98	88	10	159,170
Istog	1,230	1,184	46	3,050,129
Junik	95	88	7	133,772
Kaçanik	422	407	15	685,088
Kamenicë	716	687	29	1,378,168
Klinë	1,137	1,067	70	2,950,588
Klllokot	197	185	12	270,851
Leposaviq	344	327	17	403,130
Lipjan	1,665	1,616	49	3,973,294
Malishevë	977	937	40	1,844,397
Mamushë	242	227	15	248,322
Mitrovicë	588	561	27	920,713
Novobërd	453	437	16	607,750
Obiliq	634	595	39	1,256,888
Partesh	204	199	5	296,036
Pejë	1,835	1,712	123	3,947,061
Podujevë	2,107	2,037	70	4,110,485
Prishtinë	1,295	1,227	68	2,219,097
Prizren	1,180	1,103	77	2,185,488
Rahovec	3,115	3,029	86	5,977,573
Ranillukë	142	142	-	168,875
Shtërpce	317	283	34	276,133
Shtime	570	555	15	1,181,089
Skenderaj	1,778	1,735	43	3,224,844
Suharekë	1,241	1,173	68	2,216,935
Viti	1,096	1,060	36	2,481,159
Vushtrri	1,687	1,610	77	4,023,040
Zubin Potok	136	134	2	185,733
Zveçan	85	82	3	81,214
Gjithsej	32,561	31,190	1,371	66,472,977.76

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Figura 37: Numri i përfituesve, shuma e paguar dhe shuma mesatare për përfitues sipas komunave, në 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.2.1 Pagesat direkte për kulturat bujqësore dhe verë

Në vitin 2024, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore ishte 39.9 mil. €. Pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pagesat direkte për kultura bujqësore kishin: gruri (40%), misri (27%), perimet (13%), vreshtat (7%) dhe pemishtet ekzistuese (7%), ndërsa kategoritë e tjera marrin pjesë me 6% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore.

Në përgjithësi, është vazhduar të mbështeten sektorët e njëjtë sikur edhe në vitin paraprak, me disa ndryshime tek pagesat për njësi të subvencionuar. Rritje të pagesës për njësi të subvencionuar ka pasur tek mbështetja e farës së grurit për kg nga 0.03 €/kg sa ishte në vitin 2023, në 0.04 €/kg në vitin 2024. Gjithashtu, rritje kishte edhe tek mbështetja për hektar tek bujqësia organike e certifikuar dhe në konvertim, tek sasia e mjedrës dhe tek sasia e prodhuar e verës. Ndërsa tek vreshtat, në vitin 2024 u bë një përshkallëzim i pagesës për hektar në bazë të numrit të hektarëve.

Nga gjithsej mbështetja për perime prej 5.3 mil. €, 231 mijë € apo 4% janë për perime në serra, ndërsa pjesa tjetër për perime në fushë të hapur. Sa i përket kulturave perimore në fushë të hapur, ato që përbëjnë 96% të gjithsej shumës së pagesave direkte për perime janë: patatja (27%), fasulja monokulturë (18%), speci (17%), qepa (11%), shalqiri (10%), lakra (5%), ndërsa të gjitha perimet e tjera në fushë të hapur kanë pjesëmarrje prej 12%.

Tek mbështetja e vreshtave në vitin 2024 është bërë një përshkallëzim në pagesë varësisht numrit të hektarëve, pagesa për përfituesit që kishin deri në 100 ha ka qenë 1,050 €/ha, ndërsa për çdo hektarë mbi 100 ha, pagesa ishte 700 €/ha. Paralelisht me ndryshimin që është bërë tek pagesa për sipërfaqe të vreshtave, pagesa për litër të verës së prodhuar është rritur nga 0.04 €/litër në 0.08 €/litër.

Për të dytin vit me radhë, subvencionimi për bujqësi organike është bërë edhe për sipërfaqet e certifikuara si organike, por edhe për ato sipërfaqe që janë në periudhën e konvertimit në organike. Sipërfaqet organike janë mbështetur me nga 250 €/ha shtesë mbi subvencionimin bazë, me 163 mijë € në total, prej të cilave, 76% kanë qenë për bimë mjekësore aromatike organike, 15% për pemishte organike dhe 9% për grurë organik. Për dallim nga sipërfaqet e certifikuara si organike, shuma e paguar për sipërfaqe në konvertim ka qenë shumë më e vogël, ato janë mbështetur me nga 100 €/ha shtesë mbi subvencionimin bazë, dhe shuma totale e paguar ka qenë vetëm 5.5 mijë €, prej të cilave 68% kanë qenë për sipërfaqet me aroni në periudhë të konvertimit dhe 32% për bimë mjekësore dhe aromatike në periudhë të konvertimit.

Nga gjithsej shuma prej 2.8 mil. € që u pagua për pemishte, kulturat pemëtare që kanë pjesëmarrje më të madhe në këtë total janë: arra (32%), molla (26%), kumbulla (20%), lajthia (8%), dardha (4%) dhe vishnja (3%). Të gjitha këto kultura të cekura përbëjnë 93% të gjithsej mbështetjes për pemishte, ndërsa pjesa tjetër prej 7% është e shpërndarë tek kulturat tjera pemëtare.

Tabela 101: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2020-2024

		2020	2021	2022	2023	2024
Grurë (ha)	Numri i aplikuesve	11,044	6,862	11,331	17,250	14,796
	Numri i përfituesve	10,729	6,553	11,130	16,525	14,292
	Numri i ha të paguar	46,931	27,860	49,893	64,395	52,811
	Pagesa për ha	300	75	354	204	204
	Shuma totale e paguar	14,079,396	2,089,499	17,661,357	13,136,627	10,769,022
Grurë (kg)	Numri i aplikuesve	-	3,801	3,555	8,470	8,896
	Numri i përfituesve	-	3,550	3,555	8,043	8,685
	Numri i kg të paguar	-	63,028,896	64,179,802	102,654,383	133,604,985
	Pagesa për kg	-	0.019	0.03	0.03/0.04	0.04
	Shuma totale e paguar	-	1,197,549	1,925,395	3,089,722	5,344,199
Farë gruri (ha)	Numri i aplikuesve	25	16	3	6	15
	Numri i përfituesve	24	14	3	6	13
	Numri i ha të paguar	869	528	161	334	371
	Pagesa për ha	500	250	304	304	304
	Shuma totale e paguar	434,540	131,913	48,895	101,454	112,884
Misër	Numri i aplikuesve	10,020	7,510	11,331	13,312	14,495
	Numri i përfituesve	9,808	7,224	11,651	12,482	13,908
	Numri i ha të paguar	28,493	18,934	35,876	39,467	47,483
	Pagesa për ha	300	150	329	229	229
	Shuma totale e paguar	8,547,885	2,840,082	11,803,368	9,037,918	10,873,164
Elb	Numri i aplikuesve	242	856	455	400	510
	Numri i përfituesve	233	820	437	387	490
	Numri i ha të paguar	442	2,054	753	647	854
	Pagesa për ha	300	150	204	204	204
	Shuma totale e paguar	132,645	308,040	153,708	131,919	174,402
Thekër	Numri i aplikuesve	59	182	131	101	79
	Numri i përfituesve	56	173	124	99	75
	Numri i ha të paguar	195	532	413	236	196
	Pagesa për ha	300	150	204	204	204
	Shuma totale e paguar	58,623	79,845	84,152	48,073	40,051
Tërshërë	Numri i aplikuesve	569	746	876	786	907
	Numri i përfituesve	538	706	829	725	851
	Numri i ha të paguar	1,321	1,665	1,695	1,610	1,928
	Pagesa për ha	300	150	204	204	204
	Shuma totale e paguar	396,261	249,689	345,727	328,497	393,403
Vreshta	Numri i aplikuesve	2,919	2,848	2,722	2,730	2,623
	Numri i përfituesve	2,880	2,826	2,694	2,698	2,529
	Numri i ha të paguar	3,080	3,039	2,724	2,881	2,782
	Pagesa për ha	2,000	1,000/700/ 500/400	1,054	1,054	1,104/754
	Shuma totale e paguar	6,160,400	2,520,246	2,870,896	3,036,542	2,865,802
Luledielli	Numri i aplikuesve	5	6	7	23	70
	Numri i përfituesve	3	6	4	18	65
	Numri i ha të paguar	40	20	46	283	1,034
	Pagesa për ha	300	150	224	354	354
	Shuma totale e paguar	12,036	2,946	10,192	100,288	365,863

Perime	Numri i aplikuesve	4,676	3,917	4,333	3,972	5,679
	Numri i përfituesve	4,481	3,802	4,155	3,684	5,367
	Numri i ha të paguar	9,210	6,870	7,014	6,047	9,659
	Pagesa për ha	600	400/500	204/554/ 654/904	204/554/ 654/904	204/554/ 654/904
	Shuma totale e paguar	5,525,712	2,764,378	3,620,710	3,208,347	5,311,572
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	3,166	2,929	3,396	3,776	3,938
	Numri i përfituesve	3,034	2,774	3,251	3,506	3,626
	Numri i ha të paguar	4,757	4,536	5,013	5,524	5,605
	Pagesa për ha	800	400	504	504	504
	Shuma totale e paguar	3,805,736	1,814,448	2,526,360	2,784,293	2,825,646
Bujqësi organike (certifikuar)	Numri i aplikuesve	48	35	20	14	20
	Numri i përfituesve	38	11	9	8	10
	Numri i ha të paguar	1,672	197	198	202	232
	Pagesa për ha	1,000	125/200/ 450/500	+50*	+100*	+250*
	Shuma totale e paguar	1,672,210	81,150	89,469	94,058	163,140
Bujqësi organike (në konvertim)	Numri i aplikuesve	-	-	-	5	11
	Numri i përfituesve	-	-	-	2	3
	Numri i ha të paguar	-	-	-	9	9
	Pagesa për ha	-	-	-	+50*	+100*
	Shuma totale e paguar	-	-	-	5,136	5,502
Bimë mjekësore dhe aromatike	Numri i aplikuesve	84	62	78	94	143
	Numri i përfituesve	70	56	54	85	127
	Numri i ha të paguar	248	60	39	121	194
	Pagesa për ha	450	450	504	504	504
	Shuma totale e paguar	111,479	26,933	19,601	60,913	97,716
Verë	Numri i aplikuesve	18	17	18	21	20
	Numri i përfituesve	17	17	17	21	20
	Numri i litrave të paguara	5,711,290	9,148,751	7,702,215	7,575,635	2,320,641
	Pagesa për litër	0.04	0.08	0.04	0.04	0.08
	Shuma totale e paguar	228,452	731,900	308,089	303,025	185,651
Mjedër	Numri i aplikuesve	525	376	557	660	555
	Numri i përfituesve	386	320	365	364	404
	Numri i kg të paguara	1,055,337	864,717	1,153,245	942,798	1,699,158
	Pagesa për kg	0.16	0.12	0.15	0.15	0.20
	Shuma totale e paguar	168,854	103,766	172,987	141,420	339,831


Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR.¹⁷

Me shumën mesatare më të lartë të subvencionit për përfitues, kanë qenë përfituesit për bujqësi organike të certifikuar me 16.3 mijë €, pasuar nga përfituesit për verë me një mesatare rreth 9.3

¹⁷ *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; **Pagesa për njësi për verë në vitin 2021 ka qenë e planifikuar 0.04 €/litër ndërsa pagesa është realizuar 0.08 €/litër sepse dyfishimi i pagesës për njësi në kuadër të PRE-së nuk është aplikuar për verë në vitin 2020; ***Subvencionimi për bujqësi organike të certifikuar apo në konvertim bëhet si shtesë mbi pagesën bazë për njësi të kulturave jo organike. ****Sqarim: Tek gruri për kg është e përfshirë edhe fara e grurit për kg në vitin 2023 dhe 2024, viti 2023 mund të ketë ndryshime me publikime paraprake duke qenë se fara e grurit për kg është përfshirë tek gruri për kg për shkak të krahasueshmërisë sepse në vitin 2024 pagesa ka qenë e njëjtë 0.04 €/kg për të dy kategoritë dhe është raportuar si një kategori subvencioni.

mijë €, për farë gruri me rreth 8.7 mijë €, për luledielli me 5.6 mijë €, për bujqësi organike në konvertim me rreth 1.8 mijë €, për vreshta me rreth 1.1 mijë €, dhe kulturat e tjera të paraqitura në figurën e mëposhtme ku mesatarja për përfitues ishte nën 1 mijë €.


Figura 38: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në shumicën e rasteve ishte nën 5 ha, më përjashtim të farës së grurit, bujqësisë organike të certifikuar dhe lulediellit, ku sipërfaqja mesatare e subvencionuar ishte e lartë sepse numri i përfituesve ishte i vogël.

Figura 39: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.2.2 Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht

Shuma e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë, në vitin 2024 ishte 17.1 mil. €, 6% më e lartë sesa në vitin 2023. Nga gjithsej pagesat direkte për blegtori, 27.2% ishin për lopë qumështore, 24.4% për bletari, 21.2% për delet dhe dhitë, 18.9% për qumësht sipas cilësisë dhe 8.3% për kategoritë tjera të subvencionimit. Në vitin 2024 pjesëmarrja e pagesave direkte për blegtori në totalin e pagesave direkte është 25.7%.

Rritje të vlerës së subvencionit për njësi, në vitin 2024 kishte tek buallicat (nga 90 në 180 €/krerë) dhe dhitë (nga 25 në 30 €/krerë).

Përveç rritjes së pagesës për krerë të buallicave, në vitin 2024 edhe numri i buallicave të subvencionuara u rrit më shumë se dyfish, dhe kjo bëri që vlera totale e mjeteve të paguara për subvencionim të buallicave pothuajse u pesëfishua.

Nga gjithsej shuma prej rreth 3.6 mil. € për dele dhe dhi, pjesëmarrja e subvencionimit për dele është 89%, ndërsa për dhi vetëm 11%. Në vitin 2024, për herë të parë u bë diferencimi i pagesës për krerë, ku delet u subvencionuan me nga 25 €/krerë dhe dhitë me nga 30 €/krerë.

Zogjtë për majmëri (brojlerët), filluan të subvencionohen për herë të parë në vitin 2023, me nga 0.20 € për brojler. Duke qenë se ishte subvencionim për herë të parë i aplikueshëm, kishte pak aplikues (6) dhe 2/3 e tyre u refuzuan. Ndërsa në vitin 2024, numri i aplikuesve ishte 8, numri i përfituesve u rrit në 3, dhe gjithsej numri i zogjve të subvencionuar u rrit për 17%.

Subvencionimi për mëshqerra për riprodhim u bë për herë të parë në vitin 2024. Nga gjithsej 1,300 aplikues, 1,053 përfituan, ndërsa 19% u refuzuan. Pagesa për krerë ishte 50 €, dhe u subvencionuan 2,824 krerë, në vlerë totale prej 141 mijë €.

Tabela 102: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2020-2024

		2020	2021	2022	2023	2024
Lopë qumështore	Numri i aplikuesve	7,027	6,210	5,773	5,517	5,413
	Numri i përfituesve	6,905	6,105	5,589	5,263	5,138
	Numri i krerëve të paguar	67,295	57,571	52,527	51,684	51,652
	Pagesa për krerë	140	85	90	90	90
	Shuma totale e paguar	9,421,300	4,893,535	4,727,430	4,651,560	4,649,890
Buallica	Numri i aplikuesve	5	5	4	7	17
	Numri i përfituesve	4	4	4	7	17
	Numri i krerëve të paguar	347	31	26	42	99
	Pagesa për krerë	140	85	90	90	180
	Shuma totale e paguar	48,580	2,635	2,340	3,780	17,820
Dele dhe dhi	Numri i aplikuesve	1,515	1,379	1,334	1,340	1,302
	Numri i përfituesve	1,469	1,329	1,296	1,287	1,214
	Numri i krerëve të paguar	170,985	149,784	141,792	151,486	142,338
	Pagesa për krerë	30	20	25	25	25/30
	Shuma totale e paguar	5,129,550	2,995,680	3,544,800	3,787,150	3,622,325


Dosa	Numri i aplikuesve	251	158	140	110	77
	Numri i përfituesve	235	133	116	103	70
	Numri i krerëve të paguar	1,877	1,042	895	759	621
	Pagesa për krerë	40	20	25	25	25
	Shuma totale e paguar	75,080	20,840	22,375	18,975	15,525
Bletë	Numri i aplikuesve	3,941	3,373	3,098	3,079	3,221
	Numri i përfituesve	3,634	3,133	3,016	3,001	3,112
	Numri i koshereve të paguara	233,227	192,551	190,579	187,876	208,633
	Pagesa për koshere	30	15	20/25	20/25	20/25
	Shuma totale e paguar	6,996,810	2,888,265	3,811,735	3,757,770	4,172,576
Pula vojse	Numri i aplikuesve	84	94	80	79	79
	Numri i përfituesve	84	77	73	75	74
	Numri i pulave vojse të paguar	1,310,235	1,120,349	871,909	1,050,980	1,121,120
	Pagesa për pulë vojse	1.00/ 0.80	0.50/ 0.40	0.50/ 0.40	0.50	0.50
	Shuma totale e paguar	1,165,861	500,676	399,161	525,490	560,560
Thëllëza	Numri i aplikuesve	11	12	-	-	-
	Numri i përfituesve	10	11	-	-	-
	Numri i thëllëzave të paguar	23,678	16,245	-	-	-
	Pagesa për thëllëzë	1.00	0.50	-	-	-
	Shuma totale e paguar	23,678	8,123	-	-	-
Qumësht	Numri i aplikuesve	1,282	1,197	1,314	1,286	1,378
	Numri i përfituesve	1,245	1,149	1,286	1,268	1,333
	Numri i litrave të paguara	47,515,642	44,835,136	46,183,417	45,102,003	51,431,406
	Pagesa për litër	0.12/ 0.08/ 0.04	0.06/ 0.04/ 0.02	0.07/0.04/ 0.02	0.07/0.04/ 0.02	0.07/0.04/ 0.02
	Shuma totale e paguar	4,906,204	2,358,351	2,840,801	2,777,848	3,225,073
Therje të raportuar të gjedhit	Numri i aplikuesve	12	8	11	11	16
	Numri i përfituesve	9	7	11	11	15
	Numri i krerëve të paguar	706	701	1,122	1,720	2,162
	Pagesa për krerë	100	50	50	50	50
	Shuma totale e paguar	70,600	35,050	56,100	86,000	108,100
Akuakulturë	Numri i aplikuesve	4	4	5	5	6
	Numri i përfituesve	4	4	5	5	6
	Numri i kg të paguar	385,024	551,571	763,008	653,787	596,273
	Pagesa për kg	0.40	0.20	0.20	0.20	0.20
	Shuma totale e paguar	154,010	110,314	152,602	130,757	119,255
Viça për majmëri	Numri i aplikuesve	-	744	460	699	944
	Numri i përfituesve	-	462	395	680	897
	Numri i krerëve të paguar	-	7,938	7,732	13,931	18,540
	Pagesa për krerë	-	10	25	25	25
	Shuma totale e paguar	-	79,380	193,300	348,275	463,500
Zogj për majmëri (brojler)	Numri i aplikuesve	-	-	-	6	8
	Numri i përfituesve	-	-	-	2	3
	Numri i brojlerëve të paguar	-	-	-	13,913	16,325

	Pagesa për brojler	-	-	-	0.20	0.20
	Shuma totale e paguar	-	-	-	2,783	3,265
Mëshqerra për riprodhim	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	1,300
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	1,053
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	-	2,824
	Pagesa për krerë	-	-	-	-	50
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	141,200

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR.¹⁸

Në figurën e mëposhtme është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit për akuakulturë me 19.9 mijë €, pasuar nga përfituesit për pula vojse me 7.6 mijë €, për therje të raportuara të gjedhit 7.2 mijë €. Ndërsa, mesatare më të ulët për përfitues, përkatësish nën 5,000 € kishin përfituesit e deleve dhe dhive, qumështit, bletëve, zogjve për majmëri, buallicave, lopëve qumështore, viçave për majmëri, dosave dhe mëshqerrave për riprodhim.

Figura 40: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2024




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues, e paraqitur në figurën më poshtë tregon se sa i përket krerëve, mesatare më të lartë është tek therjet e raportuara të gjedhit, delet dhe dhive, viçat për majmëri, lopët qumështore, dosat, buallicat dhe mëshqerrat për riprodhim.

¹⁸ *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Të dhënat e paraqitura për vitin 2020 për Qumësht, Therje të raportuara të gjedhit dhe Akuakulturë ndryshojnë nga RGJ 2021 sepse janë përfshirë edhe pagesat e realizuara për gjashtë mujorin e dytë 2020.

Figura 41: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2024



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.2.3 Mbështetja e inputeve në bujqësi

Mbështetja e fidanëve

Gjithsej, shuma e pagesave direkte për fidanë në vitin 2024 ishte rreth 181 mijë €. Krahasuar me vitin 2023, është rritur për 7%, kjo për shkak të rritjes së numrit të përfituesve dhe rritjes së numrit të fidanëve të subvencionuara. Numri më i madh i fidanëve të subvencionuar është në regjionet: Ferizaj (49%), Gjakovë (20%), Gjilan (16%) dhe Pejë (15%), ndërsa në regjionet e tjera nuk ka pasur fare aplikues.

Janë subvencionuar prodhuesit e fidanëve të pemëve drufrutore me nga 0.25 €/fidan dhe prodhuesit e fidanëve të hardhisë së rrushit me nga 0.15 €/fidan, duke filluar nga minimum prej 3,000 copë. Mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar ishte rreth 39 mijë fidanë, më e ulëta ishte në regjionin e Gjilanit (25 mijë fidanë), ndërsa më e larta në regjion të Gjakovës (53 mijë fidanë).

Tabela 103: Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2024

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr. i fidaneve të subvencionuara	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	-	-	-	-
2	Prizren	-	-	-	-
3	Pejë	3	3	116,797	29,199
4	Mitrovicë	0	0	-	-
5	Gjakovë	3	3	158,500	26,925
6	Ferizaj	9	9	376,350	94,088
7	Gjilan	5	5	124,198	31,212
	Gjithsej	20	20	775,845	181,424

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mbështetja për naftë

Në vitin 2024, përmes Programit të Pagesave Direkte çdo aplikues i cili përfitoi subvencion për sipërfaqe të tokës së mbjellur/kultivuar me kultura bujqësore, u subvencionua edhe për naftë, me nga 0.36 €/litër për sasinë maksimale prej 150 litrave për hektar. Në total, në vitin 2024 u paguan 6.7 mil. € për subvencionim të naftës, për një sipërfaqe prej 123,158 ha.

Mbështetja për pleh

Në vitin 2024, subvencionim për pleh të përdorur gjatë kultivimit të kulturave bujqësore përfituan të gjithë fermerët të cilët përfituan subvencione për sipërfaqe të mbjellura/kultivuara me grurë, farë gruri, misër, elb, thekër, tërshërë, luledielli, patate dhe fasule monokulturë. Vlera e subvencioneve për pleh ishte 100 €/ha.

Numri fermerëve që aplikuan për subvencionim të plehut ishte 16,054 fermerë, prej të cilëve 3% u refuzuan dhe 97%, apo 15,576 fermerë përfituan. Gjithsej për pleh u subvencionuan 93,246 ha dhe gjithsej shuma e paguar ishte 9.3 mil. €.

6.3 Agro kreditë dhe fondi garantues

6.3.1 Agro Kreditë

Kreditimi në bujqësi është element kyç për zhvillimin e sektorit bujqësor në Kosovë, pasi ofron mundësinë për të lehtësuar financimin e aktiviteteve të fermerëve dhe përpunuesve të prodhimeve bujqësore. Edhe pse MBPZHR ofron vazhdimisht grante dhe subvencione për mbështetje, zhvillimi i këtij sektori kërkon edhe financim alternativ, që mund të sigurohet përmes kredive. Shumë fermerë, nuk kanë burime të mjaftueshme për të investuar në teknologji moderne, përmirësim infrastrukture apo për zgjerim të aktiviteteve të tyre, për këtë arsye kredia bujqësore bëhet një mundësi e domosdoshme për ata që dëshirojnë të vazhdojnë dhe zhvillojnë biznesin e tyre. Krediti mundëson investime në perspektiva të reja, për rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë, për të arritur nivele konkurruese në treg, etj. Pa një mbështetje të tillë financiare, është e vështirë që fermerët të përballojnë kostot e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

Qasja e ulët në financimin e përgjithshëm bankar në bujqësi, sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë, me vetëm 1.1% për vitin 2024 (ose 1 pikë përqindje më e ulët se viti paraprak), ndërsa te Institucionet Mikrofinanciare (IMF), gjendja është shumë më e favorshme, ku pjesëmarrja e agrokredive është 15.2% për vitin 2024.

Agro-kreditë njihen si kredi jo-performuese, me ç'rast kreditimi ka një kosto të lartë për bankat dhe institucionet mikrofinanciare. Niveli i ulët i kreditimit tregon për qasjen konservatore të sistemit bankar ndaj sektorit të bujqësisë. Në mungesë të një sistemi të përgjithshëm të sigurimit në bujqësi, fermerëve ju vështirësohet të kenë qasje në kredi, përkatësisht në kredi të përballueshme. Mbështetje të konsiderueshme financiare për garancitë e kredive në bujqësi

kanë dhënë USAID-MBPZhR vite më parë, ndërsa tani mbështetje kemi nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK. Fondi i Garancisë synon që fermerët, nëpërmjet kredive të ofruara me kritere më të favorshme, të mbulojnë një pjesë të rrezikut të financimit të mbetur (rreth 50%), i cili nuk mbulohet me grantet e marra. Pra, me më pak kolateral dhe një normë interesi më të ulët për sektorët e bujqësisë, blegtorisë, agrobiznesit dhe agro-përpunimit.

Kredia bujqësore, përveç se mundëson zhvillimin e sektorit, ka edhe ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies në zonat rurale. Ajo ofron mundësi për rritjen e prodhimit vendor, duke kontribuar në zvogëlimin e varësisë nga importet dhe duke stimuluar krijimin e mundësive për eksport. Me ndihmën e financimit, fermerët mund të investojnë në teknologji më të avancuar, praktika më efikase dhe prodhim më të qëndrueshëm, gjë që mund të përmirësojë cilësinë e produkteve dhe të rrisë konkurrencën e produkteve të vendit në tregjet ndërkombëtare.

Investimet në bujqësi dhe agrobiznes mund të krijojnë vende pune për të rinjtë, duke i stimuluar ata që të qëndrojnë në vendlindje dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit të tyre. Kredia bujqësore ndihmon në krijimin dhe mbajtjen e fuqisë punëtore të re, duke ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive të reja dhe ndihmon në uljen e papunësisë në zonat rurale. Në këtë mënyrë, kredia bujqësore luan një rol kyç në forcimin e ekonomisë rurale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në këto zona.

Bankat që mbështesin financiarisht sektorin e bujqësisë në Kosovë me kredi janë: TEB Bank, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Procredit Bank (PCB), Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank (RBKO) dhe NLB Prishtina. Ndërsa, Institucionet Mikrofinanciare janë: Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), Finca, KEP Trust, Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK), KosInvest World Vision (WVI), KGMAMF dhe Qelim Kosovë. Lider në shumën e Agrokredive të disbursuara është TEB, BKT, PCB dhe BPB, e ndjekur nga IMF-të: KRK, Finca, KEP dhe AFK. Nga tabela shihet se kredi në vlerë më të madhe janë disbursuar në vitin 2024, me një shumë totale mbi 130.1 mil. €. Numri i kredive të dhëna që nga viti 2020 deri në vitin 2024 është rreth 99 mijë, me një shumë totale prej 537.5 mil. €. Pra, për këto 5 vite, janë disbursuar mesatarisht rreth 1,646 kredi çdo muaj, përkatësisht me një shumë mesatare mujore prej 8.96 mil. €.


Tabela 104: Agro kreditë 2020 – 2024

Agro Kredi 2020 - 2024	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mn €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në krahasim me kreditë tjera (%)
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
2021	18,477	98.9	18 - 41.5	5.2 - 24	0.4 - 33
2022	19,980	108.3	18 - 41.9	5.2 - 28.6	0.4 - 38
2023	19,147	117.1	18 - 40.1	5.9 - 28.4	0.3 - 33.5
2024	18,188	130.1	18 - 43.5	5.8 - 28.6	0.3 - 38.5
Gjithsej	98,750	537.5			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga të dhënat në tabelë dhe figurë, shihet qartë se vitet 2024 dhe 2023 dallojnë për një rënie të numrit të kredive (për 5.0%). Nëse krahasojmë vitin 2024 me vitin 2020, vihet re një rënie e konsideruar për 20.8%.

Figura 42: Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000)



Burimi: Bankat komerciale & IMF në Kosovë, BQK

Për vitin e fundit, afati i dhënies së kredisë bujqësore varion nga 18 deri 43.5 muaj, në varësi të qëllimit të kredisë, ndërsa normat e interesit ndryshojnë nga 5.8% deri në 28.6%, në bazë të shumës së kredisë dhe afatit të kthimit. Paknaqësitë e prodhuesve bujqësor vazhdojnë të jenë me normat e interesit, të cilat nuk ndikojnë në stimulimin e zhvillimit të këtij sektori.


Zakonisht, nuk kërkohet kolateral për shuma të vogla kredie. Për shuma të mesme dhe të mëdha, bankat dhe IMF-të kërkojnë garanci prej 0% deri në 150% të shumës së kredisë. Grejs periodha, apo periodha e shtyrjes së pagesës, varion nga 3 deri në 12 muaj, megjithëse në disa publikime figuron 18 muaj, varësisht nga rastet ku grejs periodha është fleksibile. Vlen të

theksohet se përqindja më e madhe e kredive shlyhet pas sezonit të korrijes. Ndër vite, kemi parë që grejs periudha ishte më e ulët, kurse në vitet e fundit ka ngritje të saj.

Pjesa e kredive bujqësore krahasuar me kreditë tjera në banka dhe IMF dallon. Në banka, deklarimi i pjesëmarrjes është nga 0.3% deri në 10.3%, që është deri diku shembull i mirë. Në IMF, deklarimi i pjesëmarrjes varion nga 12.8% në 38.5% që si mesatare është mbi 22.4%.


Nga figurat e mëposhtme shihen dallimet në shifra mes bankave komerciale dhe IMF-ve:

Figura 43: Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €



Burimi: Banka dhe IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Figura 44: Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €




Burimi: Banka dhe IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZhR;

Bankat karakterizohen nga një numër më i vogël kredish, por me shuma më të mëdha, që do të thotë se mesatarja e kredisë për vitin 2024 ishte 28,639 €. Te IMF-të, mesatarja për kredi është

4,650 €, pra një numër i madh kredish, por me shuma më të vogla, që arrin një balancë të interesave pothuajse për çdo fermer.

Në varësi të shumës së kredisë nga bankat dhe IMF-të, norma e interesit dhe maturiteti i saj ndryshojnë. Sa më e madhe është shuma dhe sa më e shkurtër është kohëzgjatja e kredisë, aq më e ulët është norma (kamata) e interesit si dhe e kundërta.

Figura 45: Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %



Burimi: BQK

Kamatat në kredi-dhënie për sektorin bujqësor janë të larta, në krahasim me kreditë e sektorëve tjerë dhe me vendet e regjionit, megjithëse viti 2024 të bankat u karakterizua me një rënie të normës së interesit për 0.4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023, ndërsa të MFI-të rënie prej 0.4 pikë përqindje. Hendeku me kredi biznesi ende është i lartë për 2.6 pikë përqindje, ky dallim i normës së interesit nuk ndikon si stimulim për fermerët.

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së kredive të këqija tek agrokreditë, mund të thuhet se ato janë në nivel të pranueshëm brenda kufijve të përcaktuar nga shumica e bankave dhe institucioneve financiare. Krahasuar me vendet e rajonit, jemi në një nivel më të kënaqshëm.

Gjatë viteve të Bankat, norma maksimale e kredive të këqija ishte rreth 5%, ndërsa të IMF-të është dukshëm më e lartë.

6.3.2 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FKGGK

FKGGK vazhdon ta konsiderojë financimin dhe garantimin e agro sektorit si një mundësi e mirë e krijimit të vendeve të reja të punës, zhvillimit ekonomik dhe zëvendësimit të produkteve ushqimore të importuara.

FKGK ka nënshkruar marrëveshje për Dritaren Agro me 11 Institucione të Regjistruara Financiare (IRF), respektivisht me 7 banka dhe 4 Institucione Mikrofinanciare (IMF) që janë aktive në agro kredi dhënie.

Gjatë tri viteve të fundit është mundësuar edhe garantimi i vazhdueshëm i fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF) deri në 60% të kredisë së tyre bujqësore.

Gjatë vitit 2024 janë miratuar gjithsej 24.1 mil. € kredi të reja nga bankat dhe IMF që janë aktive në sektorin e bujqësisë, të cilat janë vënë nën garancionin e FKGK-së dhe janë gjithsej 650 kredi të garantuara në Dritaren Agro. Shuma mesatare e kredive të garantuara në sektorin e bujqësisë gjatë 2024, ishte rreth 37K € me maturitet mesatar rreth 38 muaj.

Një rëndësi e veçantë është treguar për agrobizneset vendore të cilat kanë eksportuar jashtë vendit, për të cilët klientë janë ofruar kushte preferenciale të garantimit nga ana e FKGK për bankat partnere.

Deri në fund të vitit 2024, vetëm në Dritaren Agro, në total janë garantuar rreth 77.5 mil. € dhe mbi 2,090 agro kredi, përderisa nëse shtohet garantimi i agro sektorit edhe gjatë Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, ky volum shkon në mbi 84.4 mil. € tek 2,251 kredi në total.


Shpërndarja rajonale e këtyre kredive të lëshuara nga IFP-të dhe të garantuara nga FKGK, në rajone të ndryshme për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2024 është si në vijim:

Tabela 105: Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2024

Shpërndarja rajonale	Kreditë e miratuara, €	Pjesëmarrja, %
Prishtinë	6,877,200	35.6%
Prizren	2,927,000	15.2%
Pejë	3,005,900	15.6%
Mitrovicë	1,488,200	7.7%
Gjakovë	1,492,100	7.7%
Gjilan	2,344,150	12.1%
Ferizaj	1,163,600	6.0%
Gjithsej	19,298,150	

Burimi: FKGK

Figura 46: Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara nga FK GK, %



Burimi: FK GK

Gjatë vitit 2024, nga 650 agro kredi të garantuara nga ana e FK GK-së në Dritaren Agro, IRF-të parashihnin mbi 11.8 mil. € rritje të qarkullimit të klientëve të tyre nga investimet e bëra si dhe 766 vende të reja pune të deklaruara mbi bazën e tanishme.

DAESB, në baza të rregullta dy herë në vit mbledh të dhënat nga gjitha bankat dhe Institucionet mikro-financiare në Kosovë për shpërndarjen e kredive dhe normat e interesit për sektorin e bujqësisë, ndërsa, raportimi nga FK GK bëhet në baza vjetore.

6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë

Sigurimi i kulturave bujqësore paraqet një mekanizëm të rëndësishëm mbrojtës për fermerët, duke u mundësuar atyre të ruajnë qëndrueshmërinë e aktivitetit të tyre edhe në raste kur kushtet e pafavorshme atmosferike rrezikojnë prodhimin. Përveç mbrojtjes nga humbjet e mundshme, sigurimi bujqësor funksionon edhe si një mjet plotësues që u lehtëson fermerëve qasje në financa. Kjo masë për herë të parë është përfshirë në PZhR në vitin 2024, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, neni 21 (Masat e menaxhimit të rrezikut në bujqësi dhe restaurimit të potencialit të prodhimit bujqësor), ku përfshihet sigurimi i kulturave bujqësore, kafshëve, pylltarisë dhe kulturave ujore, dhe restaurimi i potencialit të prodhimit bujqësor të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet katastrofale.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj mase, është sigurimi i prodhimit bujqësor nga fatkeqësitë natyrore, siç janë reshjet e tepërta, temperaturat e ulëta apo të larta. Objektivat e veçanta të kësaj mase janë:

- Zvogëlimi i humbjeve të fermerëve si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, faktorët klimatik;
- Qëndrueshmëria ekonomike e fermës;
- Kompensimi i kostos së prodhimit;
- Siguria e vazhdimësisë së aktiviteteve bujqësore edhe pas humbjeve të shkaktuara nga moti i keq.

Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor

Në vitin 2024, në dispozicion për shitje ishin 10 produkte indeks dhe 3 produkte tradicionale të sigurimit, duke mbuluar 12 kultura bujqësore.

Në kuadër të kësaj mase mbështetëse, vetëm shpenzimet e ndërlidhura me sigurimin bujqësor janë të pranueshme, respektivisht vetëm shpenzimet që krijohen me rastin e blerjes së policës së sigurimit bujqësor indeks apo tradicional dhe mbështetja është 75%.

6.5 Projektet e zhvillimit rural – grantet investive

Programi i Zhvillimit Rural (PZhR) për vitin 2024, është i bazuar në Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023 -2027, dhe Ligjin Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural, bazuar në mandatin që ka, në bashkëpunim me palët e interesit ka përgatitur, Programin e Zhvillimit Rural 2024. Pjesë përbërëse e Programit janë masat dhe nënmasat, të cilat planifikohen të zbatohen bazuar në kriteret dhe procedurat e detajuara në program.

Buxheti total për mbështetjen e këtyre masave dhe nënmasave ishte 19.6 mil. €, i ndarë për Masën 1 (15.6 mil. €), Masën 3 (3.5 mil. €), Masën 5 (300,000 €) dhe Masën - Sigurimet Bujqësore (200,000 €).

Gjithashtu në Programin e Zhvillimit Rural (PZhR) është edhe Masa 7 - Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve, me gjithsej buxhet prej 5 mil. €, masë e cila ka mbetur të zbatohet përmes GIZ-it.

Tabela 106: Buxheti i paraparë i PZhR, 2024

Nr.	Përshkrimi i masave	Buxheti në €	Pjesëmarrja në %
Masa 1	Investimet në asete fizike në ekonomitë familjare	15,627,000	79.6
Masa 3	Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	3,500,000	17.8
Masa 5	Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal -'Qasja Leader'	300,000	1.5
Masa	Sigurimet Bujqësore	200,000	1.0
Gjithsej		19,627,000	100

Burimi: Programi për Zhvillim Rural 2024

Referuar projekteve të miratuara nga PZhR për vitin 2024, deri në periudhën 25.11.2025 janë raportuar gjithsej 464 përfitues nga 1,072 aplikues, sa ishin gjithsej për vitin 2024, me gjithsej shumë të kontraktuar në vlerë prej 22.7 mil. €, ndërsa shuma për pagesë nga përkrahja publike për projektet e kontraktuara ishte në vlerë prej 14.4 mil. €.

Sipas të dhënave nga tabela e projekteve të miratuara, shuma e paguar dhe numri i përfituesve për secilën masë është si në vijim: Masa 1, ishin gjithsej 444 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 12.6 mil. €, Masa 3, kishte gjithsej 8 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 1.5 mil. € dhe Masa 5, që kishte 12 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 305,485 €.

Kurse të dhënat e detajuara për numrin e përfituesve dhe vlerën e pagesës për projektet e miratuar për secilën nënmasë janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 107: Projektet e miratuara PZhR, 2024

Masat dhe nënmasat	Nr. i aplikuesve	Nr. i përfituesve	Shuma e aprovuar (€) ¹⁹	Shuma për pagesë (p.publike), €
Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	1,023	444	19,389,282	12,591,055
1.1 Pemë drufrutore	45	24	1,005,408	657,000
1.2 Arra, lajthia dhe gështenja	100	20	1,038,168	687,449
1.3 Pemë manore	29	17	578,540	378,150
1.4 Sektori i perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për fidane	230	59	4,181,016	2,747,347
1.5 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, përfshirë patatet	70	29	1,877,014	1,168,582
1.6 Prodhimi i mishit / rritja e viçave	118	33	1,985,805	1,336,366
1.7 Prodhimi i mishit / rritja e derrave	3	3	126,664	79,824
1.8 Prodhimi i qumështit / lopë	333	214	6,029,180	3,904,342
1.9 Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	26	8	487,219	314,667
1.10 Pikat grumbulluese të qumështit	3	1	22,196	13,317
1.11 Prodhimi i rrushit	35	20	636,763	400,556
1.12 Prodhimi i vezëve	13	8	693,859	454,631
1.13 Drithëra	18	8	727,450	448,824
Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	37	8	3,004,363	1,502,180
3.1 Përpunimi i qumështit	7	2	758,900	379,450
3.2 Përpunimi i mishit	16	3	1,136,387	568,193
3.3 Investime në përpunimi të mishit dhe thertore	2	-	-	-
3.4 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	6	1	399,997	199,998
3.5 Përpunimi i verës	2	1	384,700	192,350
3.6 Pika grumbulluese / depot pemë perime	4	1	324,379	162,189
Masa 5: Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - qasja Leader	12	12	300,485	305,485
Përgatitja zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja Leader	12	12	305,485	305,485
Gjithsej	1,072	464	22,699,130	14,398,720

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; *projektet e miratuara deri më datë 25.11.2025

Në vitin 2024, në kuadër të Programit të Zhvillimit Rural u paraqitën gjithsej 1,072 aplikime nga fermerët. Nga ky numër, 464 aplikime u aprovuan, që përbëjnë rreth 43% të përfituesve, ndërsa 608 aplikime, përkatësisht 57% nuk janë përfitues. Në vitin 2024, nga gjithsej 464 përfitues, 87% apo 404 ishin përfitues meshkuj dhe 13% apo 60 ishin përfituese femra.

¹⁹ Shuma e aprovuar për masën 5 – Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – qasja Leader tejkalon buxhetin e planifikuar sepse është vetëm si shumë e aprovuar dhe gjatë implementimit njëri ndër aktivitetet e përkrahura përkatësisht aktiviteti 2b-“Përkrahja për zbatimin e SZhL të GLV-ve” përkrahet vetëm 80% për dallim nga pjesa tjetër që përkrahet 100% (për detaje: PZhR 2024).

Figura 47: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve si dhe përfituesit sipas gjinisë, 2024



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bazuar në Programin e Zhvillimit Rural dhe projekteve të miratuara sipas komunave në kuadër të këtij programi, në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat për numrin e përfituesve, shumën e aprovuar dhe shumën për pagesë si përkrahje publike në formë të detajuar për secilën komunë të Republikës së Kosovës.

Tabela 108: PZhR i miratuar sipas komunave për vitin 2024

Komuna	Numri i përfituesve	Shuma e aprovuar (€)	Shuma për pagesë (p. publike) (€)
Deçan	13	333,389	213,764
Dragash	11	323,181	222,181
Drenas	11	469,140	304,681
Ferizaj	15	1,125,524	691,651
Fushe Kosovë	5	972,256	514,611
Gjakovë	18	728,659	466,272
Gjilan	13	562,976	369,461
Hani i Elezit	1	50,000	32,500
Istog	30	1,233,795	799,435
Junik	1	25,000	16,250
Kaçanik	7	261,502	175,101
Kamenicë	8	230,965	154,252
Klinë	23	942,368	602,784
Lipjan	16	568,205	386,002
Malishevë	9	419,961	279,488
Mamushë	20	1,838,874	1,086,612
Mitrovicë	14	740,243	499,153
Novobërdë	4	209,729	152,608
Obiliq	4	100,000	64,375
Pejë	25	1,469,680	907,238
Podujevë	43	2,031,557	1,331,452
Prishtinë	48	2,443,431	1,548,552
Prizren	7	327,137	220,859
Rahovec	32	1,461,612	864,645
Shtërpce	1	38,265	26,786
Shtime	9	530,963	353,952
Skenderaj	22	825,724	545,556
Suharekë	11	377,288	250,347
Viti	6	343,932	226,897
Vushtri	37	1,713,778	1,091,263
Gjithsej	464	22,699,133	14,398,727

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë – AZhB, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; *projektet e miratuara deri më datë 25.11.2025

6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor

Në organogramin e MBPZhR-së, Shërbimi Këshillues është një njësi që mbulon të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, duke ofruar mbështetje dhe këshillim për sektorin publik dhe privat. Ky shërbim synon të sigurojë koordinim dhe asistencë në nivel lokal dhe qendror për të përmirësuar funksionimin e institucioneve.

Në përputhje me Ligjin për Shërbime Këshilluese Nr. 04/L-074 dhe UA të nxjerra nga ky ligj, DShKT organizon dhe menaxhon të gjitha aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, certifikimin, trajnimet për fermerë, ofrimin e këshillave profesionale dhe publikimet përkatëse. Këto

aktivitete realizohen në mënyrë të vazhdueshme në nivelin qendror dhe lokal, duke siguruar zbatimin efektiv të politikave për vitin 2024.

Sistemi Këshillimor i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, përdoret në vazhdimësi për të arritur objektivat e vendosura në Planin Strategjik të Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028 dhe Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZhR).

Objektivat fokusohen në ngritjen e të ardhurave bujqësore nga fermat përmes konkurrencës së përmirësuar të tregut, prodhimtarisë dhe zhvillimit rural, ndërsa fokus të veçantë duhet kushtuar: njohurive bujqësore dhe aftësive për menaxhimin e fermerëve, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e tyre dhe të inkurajohet inovacioni, menaxhimi i qëndrueshëm i pronave bujqësore, përfshirë përdorimin e përmirësuar të teknologjisë dhe metodave të prodhimtarisë bujqësore, ruajtjes së ambientit (ujit, tokës dhe ajrit), sigurisë së ushqimit dhe cilësisë, veterinarisë, fito-sanitarisë, mirëqenies së kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, cilësisë dhe standardeve të higjienës dhe zhvillimit të grupeve të fermerëve, raporteve mes prodhuesve, tregtarëve dhe inputeve nga furnitorët, si dhe cilësisë dhe vazhdimit të furnizimit me ushqim.

Plani Strategjik i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, ka për mision të mbështesë dhe promovojë transferimin e njohurive dhe teknologjive për të rritur produktivitetin, cilësinë, standardet e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me objektivat e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe përafrimin me Politikën Bujqësore të BE-së. Bazuar në këtë plan strategjik, synohet ofrimi i shërbimeve këshillimore profesionale për fermerë në bazë të partneritetit publiko/privat.

Shërbimi Këshillimor, në funksion të realizimit të objektivave që burojnë nga dokumentet strategjike, bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me donatorë të ndryshëm. Këto bashkëpunime realizohen përmes projekteve dhe ofrimit të ekspertizës profesionale, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ofrimit të ndihmës teknike. Për vitin 2024, dallohet bashkëpunimi me Caritasin Zviceran për mbështetje të objektivave strategjike të SHK dhe ligjit për kooperativa, Swisscontact – vizita studimore në Kroaci, Shqipëri për këshilltarët publikë dhe privat për shkëmbim përvojash, mbështetje me ekspertë për hartimin e TeR për digjitalizimin e SKKBZHR; trajnime në fidanishte profesionale, GIZ – mbështetje me ekspertë për hartimin e planit operacional për zbatimin e PSSKKBZHR, organizim punëtorish për formate raportimi dhe monitorimi, FAO – bashkëpunim për projektin “Bujqësia Digjitale” dhe pjesëmarrje në aktivitete për fuqizimin e grave rurale, projekti i financuar nga BE – pjesëmarrje në punëtori për Action fiche mbi rritjen e kapaciteteve të MBPZhR-së.

Janë zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve publik dhe privat në fidanishte profesionale të perimeve, me mbështetje të Swisscontact, është organizuar trajnim për trajner në prodhimtarinë organike për BMA, me mbështetje të GIZ dhe Organika. Për ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve, është mbajtur punëtorja “Bashkëpunimi në Shërbimet Këshillimore mes akterëve të interesuar”, në bashkëpunim me GIZ, është zhvilluar trajnim për

ngritjen e kapaciteteve në fushën e sigurimeve bujqësore, në bashkëpunim me Bankën Botërore/IFC.

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në Qendrën e Informimit dhe Konsultimit për Komunitetin (QIKK), janë organizuar rregullisht takime dhe trajnime me qëllim ofrimin e mbështetjes teknike për fermerët në sektorë të ndryshëm bujqësorë. Po ashtu, është siguruar përkrahje në procesin e aplikimit dhe përgatitjes së dokumentacionit për PPD, si dhe për PZhR. Më poshtë paraqiten aktivitetet e realizuara në QIKK gjatë periudhës së raportuar.

Tabela 109: Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative (QIKK)

Nr. i aplikacioneve për subvencione të pranuar nga këshilltarët	14,963
Nr. i fermerëve të informuar për grante dhe subvencione	7,598
Nr. i fermerëve të përkrahur në aplikim për grante dhe subvencione	4,881
Nr. i fermerëve të përkrahur në përgatitjen e projekteve	282
Materialet e dhëna në formë të broshurave dhe fletëpalosjeve	4,891
Nr. i fermerëve të përkrahur me këshilla teknike në zyre	6,535
Nr. i përfituesve me trajnime dhe këshilla në terren	2,175

Burimi: DShKT; Sqarim: janë të paraqitura vetëm aplikacionet e pranuar nga këshilltarët komunal dhe për këtë dallon nga gjithsej numri i aplikacioneve për subvencione sepse gjatë procesit të aplikimit angazhohen edhe staf plotësues për pranim të aplikacioneve.

Projekti “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të shërbimit këshillues”, i financuar nga buxheti i Departamentit të Shërbimeve Këshilluese dhe i implementuar nga kompania KDC, ka zhvilluar aktivitetet si këshilla dhe trajnime.

Në kuadër të këtij projekti janë botuar 8 tituj broshurash me gjithsej 24,000 ekzemplarë, është zhvilluar dhe dizajnuar faqja e internetit e Shërbimeve Këshilluese, është realizuar vizita studimore për këshilltarët publikë në Shqipëri, ku morën pjesë 16 këshilltarë bujqësorë publikë, për një periudhë 5 ditore.

Tabela 110: Aktivitetet nga Projekti “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të SHK

Nr. i këshillimeve të pranuar	119
Nr. i fermerëve që kanë përfituar këshilla	1,020
Meshkuj	888
Femra	132
Nr. i fermerëve që kanë përfituar këshilla nga komuniteti serb	109
Meshkuj	77
Femra	32
Nr. i këshilltarëve të trajnuar publik	75
Nr. i këshilltarëve të trajnuar privat	49

Burimi: DShKT

Numri i kompanive të licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural, është gjithsej 4 për vitin 2024.

Tabela 111: Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural

Kompania	Komuna
IADK	Vushtri
ESG	Prishtinë
KDC	Gjakovë
Organika	Prishtinë

Burimi: DShKT

Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor

Pas miratimit të Planit Strategjik të Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Shërbimi Këshillimor është duke zhvilluar strukturat për të rritur efikasitetin në mbështetje të fermerëve. Përmes web faqes zyrtare, ofrohen informacione statistikore, këshilla praktike dhe njoftime të rregullta për aktivitetet bujqësore në periudha të ndryshme.

Në kuadër të Shërbimit Këshillimor, janë një mori aktivitete lidhur me promovimin e sektorit, janë mbështetur fermerët me aplikacione për subvencione, fermerë të informuar për grante/subvencione, fermerë të përkrahur për aplikime, fermerë të përkrahur në përgatitjen e projekteve, janë shpërndarë materiale (broshura, fletëpalosje), fermerët kanë përfituar këshilla teknike në zyre, janë këshilluar drejtpërdrejt në terren, janë përgatitur raporte mujore nga QIKK gjatë vitit 2024, si dhe janë publikuar mesazhe për fermer dhe broshura teknike ("Kultivimi i specit" dhe "Kultivimi i domates"). Janë vazhduar vizitat në Qendrat Informative Komunale në të gjitha komunat, me qëllim përmirësimin e organizimit dhe koordinimit ndërmjet komunave dhe Ministrisë.

7 Shtojcat

7.1 Të dhënat të tjera

Tabela 112: Eksporti i bimëve mjekuese aromatike dhe produkteve pyjore jo drusore, vlera në €

CN8	Përshkrimi i kodeve	2020	2021	2022	2023	2024
7095100	Kërpudha të freskëta apo të ftohta të llojit "Agaricus"	319,602	48,733	1,091,708	2,133,187	3,470,390
7095200	Kërpudha të gjinisë Boletus	-	-	628,065	174,536	447,804
7095300	Kërpudha të freskëta ose të ftohta të gjinisë Cantharellus	-	-	87,870	894,646	301,961
7095910	Kërpudha Kanterela të freskëta ose të ftohta	-	33,661	-	-	-
7095900	Kërpudha dhe tartufë			1,055,934	1,044,661	439,030
7095990	Kërpudha të ngrënshme të freskëta ose të ftohta (përveç kantereleve, kërpudhave me lak, kërpudhave të gjinisë "Agaricus" dhe tartufëve)	1,778,289	602,883	-	-	-
7108069	Kërpudha të ngrira, të pagatuara ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë (përveç llojit Agaricus)	753,449	839,202	1,318,593	824,460	595,293
7115900	Kërpudha dhe tartufë, të ruajtura përkohësisht	545,640	544,712	309,178	211,442	24,265
7123900	Kërpudha dhe zhardhokë kërpudhash (Tartufi) të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri	957,049	502,713	1,058,093	812,304	745,578
8024100	Arra të tjera, të freskëta ose të thata, pavarësisht nëse janë të qëruara ose jo - gështenja (castanea spp.)	3,115	150	5,590	124	3,028
8084000	Ftua të freskët	223	-	15	339	-
8094090	Kulumbri të freskëta	-	-	5,292	-	-
8102090	Manaferra, mana (dudë) dhe rrush i egër, të freskëta	1,150,946	2,046,906	623,210	643,362	399,097
8104030	Fruta të freskëta të llojit Vaccinium myrtillus	-	4,370	92,384	-	-
8112019	Mjedra, manaferra, mana, rrush i egër, ribizla e zezë, e bardhë apo e kuqe dhe rrushi i Serezit, të paziera apo të ziera	778,831	1,046,527	1,260,961	569,877	960,440
8112059	Manaferra dhe mana, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues	213,227	235,646	61,152	98,607	30,244
8119050	Fruta të llojit vaccinium myrtillus, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues	228,480	384,061	330,822	104,290	209,867
8119070	Fruta të llojit vaccinium myrtilloides dhe vaccinium angustifolium, të paziera apo të ziera	57,101	121,879	117,732	46,105	85,846
8134095	Boronice e thatë, dredhëza të thara, mjedra të thara, manaferra të thara, qersh të thara	274,595	380,087	181,380	75,186	12,880
102090	Xhenxhefilin, shafranin, shafranin e Indisë (kurkumën), trumzën, gjethet e dafinës: të tjera.	-	-	-	-	600
12099910	Fara pemësh pyjore, konkretisht fara pemësh pyjore për mbjellje ose mbjellje	5,555	9,618	-	3,372	-
12115000	Bimët e efedrës dhe pjesët e tyre, përfshirë farat dhe frutat, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të thara.	3,879,564	3,327,791	3,242,256	3,717,416	4,124,910
12119086	Bimë dhe pjesë bimësh, përfshirë farat dhe frutat, të përdorura kryesisht në parfumeri, në farmaci etj.	35,150	31,662	52,034	13,720	146
Gjithsej		10,980,815	10,160,597	11,522,268	11,367,632	11,851,382

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela 113: Eksporti i bimëve mjekuese aromatike dhe produkteve pyjore jo drusore, Sasia në kg

CN8	Përshkrimi i kodeve	2020	2021	2022	2023	2024
7095100	Kërpudha të freskëta apo të ftohta të llojit "Agaricus"	58,007	12,113	271,436	585,815	676,436
7095200	Kërpudha të gjinisë Boletus	-	-	127,209	6,866	50,618
7095300	Kërpudha të freskëta ose të ftohta të gjinisë Cantharellus	-	-	6,621	175,004	35,933
7095910	Kërpudha Kanterela të freskëta ose të ftohta	-	5,450	-	-	-
7095900	Kërpudha dhe tartufë			131,171	291,082	52,993
7095990	Kërpudha të ngrënshme të freskëta ose të ftohta	378,046	85,039	-	-	-
7108069	Kërpudha të ngrira, të pagatuara ose të gatuar me avull apo të ziera në ujë (përveç llojit Agaricus)	170,721	192,981	244,719	153,752	107,288
7115900	Kërpudha dhe tartufë, të ruajtura përkohësisht	42,986	18,978	9,774	22,768	5,286
7123900	Kërpudha dhe zhardhokë kërpudhash (Tartufi) të thara, të plota, të prera, në feta, të shtypura ose në formë pluhuri	47,083	30,109	42,410	57,210	34,398
8024100	Arra të tjera, të freskëta ose të thata, pavarësisht nëse janë të qëruara ose jo - gështenja (castanea spp.)	1,923	68	2,088	76	5,046
8094090	Kulumbri të freskëta	-	-	4,410	-	-
8102090	Manaferra, mana (dudë) dhe rrush i egër, të freskëta	521,704	569,742	163,756	338,282	158,917
8104030	Fruta të freskëta të llojit Vaccinium myrtillus	-	971	32,210	-	-
8112019	Mjedra, manaferra, mana, rrush i egër, ribizla e zezë, e bardhë apo e kuqe dhe rrushi i Serezit, të paziera apo të ziera.	331,922	252,185	266,462	272,521	326,358
8112059	Manaferra dhe mana, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues	117,467	66,211	20,384	35,627	9,756
8119050	Fruta të llojit vaccinium myrtillus, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues	84,000	115,978	112,240	39,900	71,127
8119070	Fruta të llojit vaccinium myrtilloides dhe vaccinium angustifolium, të paziera apo të ziera	23,368	32,885	39,739	16,466	30,122
8134095	Boronicë e thatë, dredhëza të thara, mjedra të thara, manaferra të thara, qersh të thara	36,790	71,853	45,919	34,853	644
9102090	Xhenxhefilin, shafranin, shafranin e Indisë (kurkumën), trumzën, gjeteth e dafinës, kerri dhe erëza të tjera shafran: të tjera.	-	-	-	-	0
12099910	Fara pemësh pyjore, konkretisht fara pemësh pyjore për mbjellje ose mbjellje	74	197	-	33	-
12115000	Bimët e efedrës dhe pjesët e tyre, përfshirë farat dhe frutat, të freskëta.	346,024	411,108	396,495	405,175	450,149
12119086	Bimë dhe pjesë bimësh, përfshirë farat dhe frutat, të përdorura kryesisht në parfumeri, në farmaci.	3,508	2,556	7,606	2,140	1
Gjithsej		2,163,623	1,868,422	1,924,648	2,437,570	2,015,072

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela 114: Përdorimi i plehrave minerale sipas grupit të kulturave bujqësore

Vitet	Kulturat	(NPK, NAG, URE, të tjerë), kg
2024	Drithërat	59,532,699
	Kultura farogjere	4,782,626
	Perime	6,821,500
	Pemë	2,358,634
	Livadhe dhe kullosa	5,732,067
	Te tjera	2,889,337
	Gjithsej	82,116,863
2023	Drithërat	57,799,088
	Kultura farogjere	5,095,599
	Perime	6,872,009
	Pemë	2,315,244
	Livadhe dhe kullosa	5,580,493
	Të tjera	3,219,848
	Gjithsej	80,882,281

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 115: Përdorimi i plehrave organike sipas grupit të kulturave bujqësore

Viti	Kulturat	Sipërfaqja e tokës së plehruar (ha)	Ton/ha
2024	Drithëra	37,182	13.9
	Kultura farogjere	4,525	11.6
	Perime	6,006	18.9
	Pemë	5,691	14.0
	Livadhe dhe kullosa	9,442	11.4
	Te tjera	1,124	14.8
	Gjithsej	63,970	
2023	Drithëra	36,225	14.1
	Kultura farogjere	5,037	11.8
	Perime	6,125	19.4
	Pemë	6,262	14.1
	Livadhe dhe kullosa	9,267	11.5
	Të tjera	1,024	15.1
	Gjithsej	63,940	

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 116: Numri i vizitorëve (vendor dhe të jashtëm) sipas regjioneve, 2015 – 2024

Vitet/Regjionet	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Prishtinë	Ferizaj	Gjithsej
2024	12,844	43,609	36,847	203,074	146,174	205,405	50,115	698,068
2023	13,021	40,471	39,099	153,803	149,312	175,604	50,177	621,486
2022	5,270	15,531	31,317	74,022	103,246	190,947	40,135	460,467
2021	4,751	11,698	30,593	72,581	77,150	134,362	24,007	355,141
2020	1,603	2,742	13,644	41,519	29,318	55,783	3,935	148,543
2019	7,995	8,507	15,765	65,099	55,107	122,541	12,069	287,083
2018	14,521	8,604	14,159	75,151	52,465	114,071	12,445	300,803
2017	13,560	5,929	9,609	57,312	45,097	107,691	12,092	251,290
2016	16,167	6,600	7,185	61,031	47,821	109,400	9,220	257,422
2015	2,269	1,635	2,247	21,707	16,316	89,050	6,214	139,438

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

7.2 Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural

Ligji Nr. 08/L-218 për Organizimin e Tregut të Produkteve Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/09 Janar 2024).

Ligji Nr. 08/L-211 për Verëra (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 12/19 Qershor 2024).

7.2.1 Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2024

1. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 01/2024 për Përcaktimin e Rregullave të Identifikimit Regjistrimit të Kafshëve dhe Objekteve për Mbarështimin dhe Mbajtjen e tyre, të datës 15.03.2024.
2. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 04/2024 për Sistemin Informativ për Çmimet e Tregut, të datës 22.11.2024.
3. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 05/2024 për Regjistrimin, Licencimin dhe Caktimin e Taksës për Importuesit, Eksportuesit dhe Tregtuesit e Materialit Fidanor, të datës 15.03.2024.
4. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 06/2024 për Procedurat e Kontrollit Inspektues, të datës 11.11.2024.
5. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 07/2024 për Sistemin Informativ për Pyjet e Kosovës, të datës 18.03.2024.
6. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 08/2024 për Ruajtjen e Pyjeve, Përgjegjësitë dhe Obligimet e Rojës së Pyllit, të datës 08.04.2024.
7. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 09/2024 për Organizimin dhe Menaxhimin e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë, të datës 22.11.2024.
8. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 11/2024 për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2024, të datës 04.03.2024.
9. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr.12/2024 për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe delegimin e detyrave specifike, të datës 22.11.2024.
10. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) -Nr. 13/2024 për Vlerësimin dhe Kompensimin e Kafshëve të Asgjësuar për shkak të Sëmundjeve Infektive, të datës 26.08.2024.
11. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 14/2024 për Përcaktimin e Rregullave të Kontrollit Zyrtar për Kafshët e Gjalla që hyjnë në Territorin e Republikës së Kosovës, të datës 22.08.2024.
12. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 15/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 09/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës.
13. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 16/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 3/2015 për përcaktimin e

formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin dhe përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij.

14. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 17/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 04/2016 për licencimin e prodhuesve dhe ri paketuesve të plehrave artificiale.
15. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 18/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 05/2021 të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave.
16. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 19/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 03/2023 për regjistrimin licencimin dhe caktimin e taksës për prodhuesit e materialit fidanor.
17. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 20/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. MA 14/2004 për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ MA Nr. 04/2007 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2011.
18. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 21/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 09/2009 autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve.
19. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 22/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 05/2017 për ripaketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.
20. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 23/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 02/2004 për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve, për tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale.
21. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 24/2024 të datës 13.08.2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) Nr. 16/2013 për riprodhimin e kafshëve të fermës.
22. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 25/2024 për Kadastrin e Pyjeve dhe Tokës Pyjore, të datës 13.08.2024.
23. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 27/2024 për kushtet teknike që duhet ti plotësojnë mbarështuesit e kafshëve shoqëruese për mbajtje, dhurim dhe shitje, të datës 04.09.2024.
24. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 32/2024 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2024, të datës 17.12.2024.

7.3 Personat përgjegjës për Raportin e Gjelbër, 2025

Tabela e përmbajtjes		Personi përgjegjës
1	Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	
1	Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	H. Xhaferi
1.1	Niveli i zhvillimit socio-ekonomik	H. Xhaferi
1.2	Popullsia në zonat rurale	H. Xhaferi
1.3	Punësimi	H. Xhaferi
1.4	Niveli i pagave	A. Maksuti
1.5	Llogaritë ekonomike në bujqësi	D. Hana
1.5.1	Prodhimet bujqësore	D. Hana
1.5.2	Të ardhurat sipërmarrëse	D. Hana
1.5.3	Inputet në bujqësi	D. Hana
1.5.4	Përdorimi i plehrave dhe pesticieve	A. Maksuti
1.6	Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore	A. Maksuti
1.6.1	Çmimet e inputeve bujqësore	A. Maksuti
1.6.2	Çmimet e prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet në fermë të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e Regjionit dhe BE-së	Sh. Duraku
1.7	Privatizimi i tokave bujqësore	H. Xhaferi
2	Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij	
2.1	Përdorimi i tokës bujqësore	G. Zymeri
2.2	Prodhimtaria bimore	G. Zymeri
2.2.1	Drithërat	A. Maksuti/G. Zymeri
2.2.2	Perimet	D. Hana/A. Zeqiri
2.2.3	Pemët	D. Hana/A. Zeqiri
2.2.4	Vreshtat dhe verërat	A. Zeqiri
	Vreshtat	A. Zeqiri
	Verërat	A. Zeqiri
	Analizat fiziko-kimike të verës	A. Zeqiri
2.2.5	Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbër	G. Zymeri
2.2.6	Kulturat industriale	G. Zymeri
2.2.7	Livadhe dhe kullosa	G. Zymeri
2.2.8	Bujqësia organike	Sh. Duraku
2.3	Ujitja e tokës bujqësore	A. Zeqiri
2.4	Blegtoria	G. Zymeri
2.4.1	Gjedhët	A. Maksuti/G. Zymeri
2.4.2	Dhentë dhe dhitë	G. Zymeri
2.4.3	Derrat dhe kafshët tjera të fermës	G. Zymeri
2.4.4	Shpezëtaria	G. Zymeri
2.4.5	Bletaria	G. Zymeri
2.4.6	Peshkataria dhe Akuakultura	G. Zymeri
3	Pylltaria	G. Zymeri
4	Tregtia	
4.1	Tregtia e përgjithshme	H. Xhaferi
4.2	Tregtia e produkteve bujqësore	H. Xhaferi
4.2.1	Tregtia sipas grupeve të shteteve	H. Xhaferi
	Tregtia me vendet e CEFTA-s	H. Xhaferi

	Tregtia me vendet e BE-së	H. Xhaferi
	Tregtia me vendet e tjera	H. Xhaferi
4.2.2	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	H. Xhaferi
	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	H. Xhaferi
	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)	H. Xhaferi
4.2.3	Tregtia e plehrave dhe pesticideve	H. Xhaferi
5	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	
	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	H. Xhaferi
5.1	Emetimi i gazrave serrë në Kosovë	H. Xhaferi
6	Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	
6.1	Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve	A. Maksuti
6.2	Pagesat direkte/subvencionet	A. Maksuti
6.2.1	Pagesat direkte për kulturat bujqësore dhe verë	A. Maksuti
6.2.2	Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht	A. Maksuti
6.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi	A. Maksuti
	Mbështetja e fidanëve	A. Maksuti
	Mbështetja për naftë	A. Maksuti
	Mbështetja për pleh	A. Maksuti
6.3	Agro kreditë dhe fondi garantues	Sh. Duraku
6.3.1	Agro Kreditë	Sh. Duraku
6.3.2	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FK GK	Sh. Duraku
6.4	Sigurimet në fushën e bujqësisë	A. Zeqiri
	Shitja e Produkteve Indeks të Sigurimit Bujqësor	A. Zeqiri
6.5	Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive	A. Zeqiri
6.6	Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve	A. Zeqiri
	Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor	A. Zeqiri
	Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	A. Zeqiri
7	Shtojcat	
7.1	Të dhënat të tjera	H. Xhaferi
7.2	Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural	D. Hana
7.1.2	Udhëzimet Administrative të miratuara në vitin 2024	D. Hana

e-mailat kontaktues:

delvina.hana@rks-gov.net

hakile.xhaferi@rks-gov.net

adelina.maksuti@rks-gov.net

shkelqim.duraku@rks-gov.net

granit.zymeri@rks-gov.net

albana.zeqiri@rks-gov.net